

**“ALEKSANDËR MOISIU” UNIVERSITY  
DURRËS, ALBANIA**

**Interdisciplinary Journal  
of Research and Development**

**VOLUME 5, Number 2, 2018**

ISSN: 2410-3411  
ISSN-L: 2313-058X

Published by  
“Aleksandër Moisiu” University, Durrës, Albania

## **EDITORIAL STAFF OF INTERDISCIPLINARY JOURNAL OF RESEARCH AND DEVELOPMENT**

### **President of Editorial Board**

**Prof. Dr. Kseanela Sotirofski,**  
*“Aleksandër Moisiu” University, Durrës, Albania*

### **EDITORIAL BOARD**

<b>Kseanela Sotirofski,</b>	“Aleksandër Moisiu” University, Durrës, Albania
<b>Leke Sokoli,</b>	“Aleksandër Moisiu” University, Durrës, Albania
<b>Lavdosh Ahmetaj,</b>	“Aleksandër Moisiu” University, Durrës, Albania
<b>Mithat Mema,</b>	“Aleksandër Moisiu” University, Durrës, Albania
<b>Andon Kume,</b>	“Aleksandër Moisiu” University, Durrës, Albania
<b>Azeta Tartari,</b>	“Aleksandër Moisiu” University, Durrës, Albania
<b>Lindita Mukli,</b>	“Aleksandër Moisiu” University, Durrës, Albania
<b>Jani Sota,</b>	“Aleksandër Moisiu” University, Durrës, Albania
<b>Osman Metalla,</b>	“Aleksandër Moisiu” University, Durrës, Albania
<b>Deak Csaba,</b>	National Innovation Office, Hungary
<b>Ensar Nisanci,</b>	“Namik Kemal” University, Tekirdag, Turkey
<b>Ihsan Soysal,</b>	“Namik Kemal” University, Tekirdag, Turkey
<b>Jose Albiac,</b>	Saragossa University. Saragossa Spain
<b>Szilagyi Roland,</b>	University of Miskolc, Hungary
<b>Athanasios Natsis,</b>	Agricultural University of Athens, Greece
<b>Michel Bonneau,</b>	University of Angers, France
<b>Francesco Scalera,</b>	University of Bari, Italy

### **Editor in chief**

**Prof. Dr. Mit’hat Mema,** *“Aleksandër Moisiu” University, Durrës, Albania*

### **Associate editors**

**Dr. Daniela Meçe,** “Aleksandër Moisiu” University, Durrës, Albania  
**Dr. Majlinda Sana,** “Aleksandër Moisiu” University, Durrës, Albania  
**Dr. Albana Halili,** “Aleksandër Moisiu” University, Durrës, Albania  
**Dr. Ela Golemi,** “Aleksandër Moisiu” University, Durrës, Albania  
**Prof. Ass. Dr. Enver Bytyçi,** “Aleksandër Moisiu” University, Durrës, Albania

**TABLE OF CONTENTS**

*Dr. Manjola XHAFERRI*

*Dr. Mirela TASE*

VLERA SHKENCORE NË BIBLIOGRAFINË  
KUSHTUAR GJERGJ KASTRIOTIT - SKËNDERBEUT  
NË VITET 1454-1835, ANALIZË, FAKTE

5

*Prof. Asoc. Dr. Enver BYTYÇI*

DIPLOMACIA E SKËNDERBEUT DHE MARRËDHËNIET  
E TIJ ME VENDET E KRISHTERA!

22

*Prof. As. Dr. Edmond MALAJ*

MONOGRAFIA “SKANDERBEG” E JULIUS PISKOS,  
NJË STUDIM I VJETËR, POR I PANJOHUR MIRË  
PËR HISTORIOGRAFINË SHQIPTARE

30

*Prof.as. Dr. Lavdosh AHMETAJ*

TRAKTATI I GAETËS DHE VASALITETI I SKËNDERBEUT

43

*Prof.Asoc.Dr. Mois KAMBERI*

ILJAZ PASHË DIBRA, KRYETAR I PARË I LIDHJES  
SHQIPTARE TË PRIZRENI

57

*Prof.as.dr Eva Hyskaj TAFILI*

GJERGJ KASTRIOTI-SKËNDERBEU NË  
HISTORIOGRAFINË E SHEKULLIT XIX

70

*Prof. As. Dr. Esilda LUKU*

KËNDVËSHTRIME MBI FIGURËN  
E GJERGJ KASTRIOTIT – SKËNDERBEUT  
NË MONOGRAFINË E HISTORIANIT OLIVER JENS SCHMITT

82

*Prof. asoc. Dr. Fadil GRAJÇEVCI*

RADIKALITETI POLITIK I LIDHJES SË PRIZËRENIT  
NXIT INSTIKTIN USHTARAK TË PORTËS SË LARTË

98

*Prof. Dr. Lekë SOKOLI*

HISTORIOGRAFIA SKËNDERBEJANE  
NË NJË SHQYRTIM METODOLOGJIK

109

**Dr. Manjola XHAFERRI<sup>1</sup>**  
**Dr. Mirela TASE<sup>2</sup>**

## **VLERA SHKENCORE NË BIBLIOGRAFINË KUSHTUAR GJERGJ KASTRIOTIT - SKËNDERBEUT NË VITET 1454-1835, ANALIZË, FAKTE**

### **Abstrakt**

Qëllimi i këtij punimi është të sjellë në vëmendje bibliografinë e autorëve historikë, letrarë, dramaturgë gjatë viteve 1454-1835 që i kanë kushtuar figurës së heroit tonë kombëtar Gjergj Kastrioti Skënderbeut. Figura e Skënderbeut është trajtuar në veprat e autorëve të ndryshëm Evropianë dhe Shqiptarë të cilët s'kanë reshtur së shkruari për shekuj me radhë, ku në fokusin e studimit të tyre kanë shprehur konsideratat dhe vlerësimet më të larta jo vetëm si strateg i madh, por dhe si nje drejtues shteti dhe diplomat me influencë ndërkombëtare. Në këtë punim do sjellim një analizë mbi qasjet e studiuesve të ndryshëm për figurën e Skënderbeut, duke marrë në konsideratë rolin dhe peshën e këtij figure, jo vetëm brënda vëndit por dhe jashtë saj. Në fokusin e këtij studimi do të jepen vepra të cilat i kanë kushtuar në të tërën e tyre bëmave të Skënderbeut, kryesisht strategjinë e tij ushtarake dhe sukseset që ai ka korrur kundër një perandorie të madhe, siç ishte ajo Osmane. Njëkohësisht në këtë punim janë përmendur edhe vepra që e kanë trajtuar figurën e Skënderbeut me skepticizëm dhe rezerva. Siç do trajtohet edhe në vazhdimin e punimit, gjatë viteve 1454-1835 që është marrë si bibliografi bazë e këtij punimi, vetëm për Skënderbeun janë botuar në gjuhë të ndryshme botërore 365 vepra me një ndërthure sa historike, letrare dhe dramaturgjike. Në këto vepra trajtohet figura e Skënderbeut diku me dimension të gjerë, diku në disa faqe dhe diku tjetër me disa rreshta. Pamvarësisht kësaj ajo çfarë i bashkon këto vepra është një e vërtetë e madhe historike që ngre lart figurën e Skënderbeut dhe veprat e tij, duke e marrë si shëmbull dhe burim frymëzimi nga shumë vënde të cilat i japin zemër luftës për liri, të kombeve dhe

<sup>1</sup> Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës, **Email:** [mxhaferrri@yahoo.com](mailto:mxhaferrri@yahoo.com)

<sup>2</sup> Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës, **Email:** [mirelatase@hotmail.com](mailto:mirelatase@hotmail.com)

shteteve të tyre.

**Fjalë Kyçe:** Analizë, Fakte, Shkencore, Bibliografi, Gjergj Kastrioti, Skënderbeu

## **Scientific Value in the Bibliography For Gjergj Kastrioti - Scanderbeg in 1454-1835, Analysis, Facts**

The purpose of this paper is to bring to the attention of the biographies of historical authors, literary and dramaturgists from 1454 to 1835 who have dedicated to the figure of our national hero Gjergj Kastrioti Scanderbeg. Scanderbeg's figure is dealt with in the works of various European and Albanian authors who have not been writing for centuries, where in the focus of their study they have expressed the highest considerations and ratings not only as a great strategist but also and as a state leader and diplomat with international influence. In this paper we will bring an analysis of the different scholars' approaches to the Skanderbeg figure, taking into account the role and weight of this figure, not only within and outside the country. In the focus of this study, works will be devoted to Skanderbeg's deeds, largely his military strategy and the successes he has reaped against a great empire, such as the Ottoman Empire. At the same time in this paper are mentioned works that have treated the figure of Skanderbeg with skepticism and reservations. As will be discussed in the continuation of the work, during the years 1454-1835, which was taken as the basic bibliography of this paper, only 365 works with a historical, literary and dramaturgy interplay have been published in Skanderbeg. In these works, the figure of Skanderbeg is handled somewhere in a wide dimension, somewhere on some pages and somewhere else in a few lines. Nevertheless, what unites these works is a great historical truth that raises the image of Skanderbeg and his works, taking it as an example and source of inspiration from many countries that encourage the struggle for freedom, of nations and states of them.

**Key words:** Analysis, Facts, Science, Bibliography, Gjergj Kastrioti, Skanderbeg

## **Vlera Shkencore në Bibliografinë Kushtuar Gjergj Kastriotit - Skënderbeut në Vitet 1454-1835, Analizë, Fakte**

Është njohur rëndësia e punimeve bibliografike në të gjitha fushat e shkencave. Repertori bibliografik është shpesh kaq i madh, sa për studiuesit e një fushe apo të një teme bëhet e domosdoshme një punë speciale për sigurimin e

bibliografisë. Po s'është vetëm kjo. Punimet bibliografike na japin një pasqyrë të historikut të studimeve mbi një fushë a temë të veçantë të interesit që mund të ketë ngjallur gjatë viteve ajo fushë apo një temë për studiuesit.

Heroi kombëtar i shqiptarëve, Gjergj Kastrioti-Skënderbeu, është një figurë e tillë, që gjatë pesë shekujve ka tërhequr vëmendjen e historianëve dhe letrarëve, në përgjithësi, të njerëzve të penës. Repertori i shkrimeve për të, pa harruar veprat në fushën e arteve, si pikturës, muzikës etj., është i madh gjatë shekujve dhe vazhdon të rritet edhe në ditët tona. Kuptohet sa i rëndësishëm është një punim bibliografik, që na jep të dhënat të nevojshme mbi çka u shkrua për luftëtarin e madh e për burrin e shtetit në gjuhët e shumta të Evropës e të vëndeve të tjera. Numri i veprave është gati i pashterueshëm.

Figura e Skënderbeut përfaqëson e sintetizon momentin më të madh të luftës çlirimtare të popullit shqiptar të shek. XV, prandaj këtu janë përfshirë edhe vepra që nuk flasin veçanërisht për luftën e heroit, por për luftën antiosmane të popullit shqiptar gjatë shek. XV, edhe para periudhës së organizuar e të drejtuar nga Skënderbeu dhe pas vdekjes së tij, si vijim i po kësaj periudhe. Bibliografia ka si temë, pra, jo vetëm figurën e Skënderbeut dhe luftën e udhëhequr prej tij, por tërë periudhën e luftës shqiptaro-osmane, që nis nga fundi i shek. XIV dhe vazhdon gjer në fund të shek. XV, periudhë e së njëjtës qëndresë e që pati si figurë qëndrore Skënderbeun.

Janë shkruar dhe vepra, ku heroit i kushtohen vështrime të shpejta, prej një apo disa faqesh, në ndonjë rast edhe paragrafe, me çka është thënë nga personalitete të shquara të kohëve të ndryshme për Skënderbeun e luftën e drejtuar prej tij, gjer e ndonjë vepër që vetëm në titull e përmënd emrin e Skënderbeut, nëse aty gjejmë jehonën e kësaj figure në botë dhe në shekujt e ndryshëm.

Kjo është një bibliografi shkencore, në përmbajtjen e saj dhe në kriteret e ndërtimit dhe përpilimit, me kompetencën e nivelin e kërkuar, është një bibliografi e arsyetuar, kritike, sa dhe informative. Në këtë repertor, përveç veprave të botuara (365), përfshihen edhe vepra të pabotuara (10), dhe botimet e dyshimta (37)<sup>3</sup>. Në ndarjen e fundit, lexuesi ka informacion mbi qënien e mosqënien e disa botimeve. Do ndalemi fillimisht tek veprat e botuara, ku në pamundësi për t'i përmendur të gjitha, do ndalem tek disa që i kanë kushtuar një pjesë të mire të veprës së tyre Gjergj Kastrioti Skënderbeut.

---

<sup>3</sup> K. Biçoku, J. Kastrati: Gjergj Kastrioti Skënderbeu Bibliografi, 1454-1835, Vëll I, Publikuar Biblioteka Kombëtare, Tiranë 1997, f. 11

### **a. Vepra të Botuara**

1. Türkenkalender [Mainz 1454] Kalendarit turk. Thirrje drejtuar krishtërimin kundër turqve. Libër prej 180 vargjesh<sup>4</sup>.
2. Bessarion Johannes [1471] Letra dhe ligjërata për luftën që i duhet bërë turqve. Në vepër vihet në dukje se po pushtohej Ballkani Perendimor nga turqit, Italia do të ndodhej përballë një rreziku të madh. Pë vëndet dhe popullsitë, duke përfshirë edhe Shqipërinë, janë përdorur emrat e botës antike si: Epir, Maqedoni, Iliri etj<sup>5</sup>.
3. Piccolomini Aeneas Sylvius [1473] Letra e Papa Piut II për Kuvendin e Mantovës. 52 letra të Papa Piut II drejtuar disa personaliteteve të kohës. Në to përfshihet edhe letra për sultan Mehmetin II. Lufta e Shqiptarëve gjatë shek. XV, Skënderbeu, mundësia e zbarkimit në Vlorë të trupave të kualicionit evropian etj. (letrat I, VIII, XLIII, XLVI)<sup>6</sup>
4. Merula Georgius [1474] Lufta e Shkodrës. Relacion për Rrethimin e Parë të Shkodrës të v.1474<sup>7</sup>.
5. Cepio Corolianus [1477] Tre libra për bëmat e komandantit Pjetër Moceniku. BK ka bot. italisht: In Venetia, per Domenico et Gio. Batista Guerra, fratello, MDLXX (An III T 25).  
Për luftimet e zhvilluara në Shqipëri gjatë rrethimit të parë të Shkodrës në v. 1474 ( bot. 1570, libri III, 42-52)<sup>8</sup>.
6. Piccolomini Aeneas Sylvius [1477] Komentaret të ngjarjeve të shënuara që kanë ndodhur në kohën e tij. Roli i shqiptarëve në luftën antiturke, ekspedita e Skënderbeut në Itali, letër këmbimi i tij me princin e Tarantit në vitet 1460<sup>9</sup>.
7. Simoneta Johannes [1479] Tridhjetë e një libra për bëmat e Françesk Sforcës, dukes së Milanos. Në vepër ka njoftime për ndihmën që trupat shqiptare, të komanduara nga vetë Skënderbeu, i dhanë Ferdinandit të Napolit<sup>10</sup>.
8. Sabellicus Marcus Antonius Coccius [1487] 33 pjesë ose libra për ngjarjet e Venedikut. Shqipëria, Shkodra dhe Kruja gjatë luftës kundër Turqve, ekspedita e Skënderbeut në Itali dhe përkujtimi i tij pas vdekjes me këngë

---

<sup>4</sup> Kostić, 87, 89

<sup>5</sup> Brunet, I, 820; Göllner, I, 791, shën.

<sup>6</sup> BK-An III B3. Albanica 1; Bibliografia 1.

<sup>7</sup> AQSH (fot). Legrand, 1; Bibliografia, 2.

<sup>8</sup> Burent, I, 1740; Pall. 1, 33, 168; Bibliografia, 5.

<sup>9</sup> Didot, 40, 100; Noli, 177.

<sup>10</sup> Burent, V, 395; Pall. 1, 51, 80, 179; Bibliografia, 6



- nga populli shqiptar<sup>11</sup>.
9. Schedel Hartman [1493] Libri i Kronikave Në këtë libër trajtohet Gjon Kastrioti , i cili quhej edhe Hamza, fitoret e Skënderbeut dhe mardhëniet e tij me Alfonsin dhe Papa Kalistin, tradhëtia e Hamza Kastriotit (CCLXXVI v.: De Albania)<sup>12</sup>.
  10. Philelphus Franciscus [1502] 37 libra të letrave me miqtë. Qëndrimi i Skënderbeut në oborin Osman (34 v., 147).
  11. Becichemus Marinus [1503-1504]. Vëll. I [177], Vëll II [204] Veprat e Beçikemit, janë të përmbledhura në dy vëllime.
  12. Barletius Marinus [ 1504] Rrethimi i Shkodrës
  13. Volaterranus Raphael [1506] 38 libra komentareësh për historinë e Romës. Në librin VIII jepen njoftime për qëndrimin e Skënderbeut në oborin osman, vdekjen e t'et, Gjonit, dhe kthimin e Heroit në atdhe, për një nip të Skënderbeut të quajtur Hamza, për rrethimin e I të Krujës etj. (lib. VIII, 94 v, 144r-144v, etj.)<sup>13</sup>.
  14. Barletius Marinus [1508-1510]. Historia për jetën dhe bëmat e Skënderbeut, princit të Epirotëve.
  15. Spanduginus Theodorus [1523] Sekretet e turqve. Një libër i ri i dobishëm, me shumë tregime të vërteta dhe dëfryese, për prejardhjen, zakonet e oborrit dhe doket e turqve në kohë lufte dhe paqeje. Shkruar latinisht dhe kushtuar të ndjerit e të shenjtit Papa Leonit X<sup>14</sup>.
  16. Pontanus Johannes Jovianus [1531] Këngët e Varrit. Gjendet një poezi kushtuar Skënderbeut (varri i burrit të pavdekshëm, Skënderbeut).
  17. Bonfinius Antonius [1543] Tri pjesë të ngjarjeve të Hungarisë ku në pjesën e tretë ka dhënë për lidhjet e oborrit hungarez me popullsitë e Ballkanit, për mardhëniet e Skënderbeut me Huniadin, rrethimin I të Krujës<sup>15</sup>.
  18. Iovio Paulo [1561] Në vëllimin e parë (227, 263-264), kur flitet për Muratin II dhe Mehmetin II, përmendet Shqipëria dhe Skënderbeu. Në vëllimin e I i kushtohet autorit të Historisë së Skënderbeut M. Barleci dhe jo M. Beçikemit<sup>16</sup>.
  19. Zurita Geronimo [1562] Vjetarët e mbretërisë së Aragonës. Në kë botim ka

<sup>11</sup> Burent, V. 6; Pall. 1, 178; Bibliografia, 9.

<sup>12</sup> BNW; BK-An I F 3 (fot. Fl.276). Brunet, I, 1860; Bibliografia, 10.

<sup>13</sup> Pall. 1, 69, 71, 78, 90, 180; Bibliografia, 16.

<sup>14</sup> Göllner, 1, 30; Pall, 2, 92-101; Bibliografia, 17.

<sup>15</sup> BK-mfa I A 14. Bibliografia, 82.

<sup>16</sup> BK3-AnII S 19. Albanica, 46; Bibliografia, 115.

- të dhëna për mardhëniet e Skënderbeut me Mbretërinë e Napolit<sup>17</sup>.
20. Bielski Marcin [1564] Kronika, d.m.th. historia e botës në gjashtë shekuj, e ndarë në katër pjesë. Fl. 241-258: O Skanderbegu Makedonia Albanskim Ksiazeziu. Frontespici është shkruar kuq e zi. Libri është i paisur me një portret të Skënderbeut dhe me gravura të ndryshme<sup>18</sup>.
  21. Lavardin Jacques de [1576] Historia e Gjergj Kastriotit i mbiquajtur Skënderbe, mbretit të Shqipërisë. Përmban bëmat e shquara ushtarake të tij dhe fitoret e përmendura kundër turqve për fenë e Jesu Krishtit. Gjithsej 12 libra , nga Zhak dë Lavarde zot i Plesis-Buro<sup>19</sup>.
  22. Barletius Marinus [1577] Sënderbeu përshkrimi i vërtetë, original dhe i shkurtër i të gjitha luftërave dhe kreshnike e të famshme, të cilat shumë luftëtarë dhe shumë i shtrenjti princ, zoti Gjergj Kastrioti, i quajtur Skënderbe, dukë i Epirit dhe i Shqipërisë etj., i kreu burrërisht dhe me sukses gjatë jetës së tij kundrejt dy sulltanëve të Turqisë, Muratit dhe Mehmetit dhe kundër armiqëve të tjerë të tij, në kohën e Papa Eugjenit të IV, të Papës Piut II dhe perandorit Frederik III, prej vitit 1444 deri më 1466<sup>20</sup>.
  23. Boissardus Janus Jacobus [1596] Jetët dhe portretet e sulltanëve turq, princave si dhe të heronjëve dhe heroinave të tjerë të shquar, që nga Osmani dhe Mehmeti II. Në gravurat, me të cilat është paisur libri, paraqitet përveç portretit të Skë Skënderbeut, edhe ai i Donikës, Hamza Kastriotit, Moisi Golemit e Tanush Topisë. Në Vepë përshkruhen edhe disa vargje për Skënderbeun<sup>21</sup>.
  24. Capriolo Aliprando [1596] Portretet e njëqind komandantëve të shquar, të gdhendur nga Aliprand Kapriolo, bashkë me bëmat e tyre të luftës, të përshkruara shkurt prej tij. Në fl. 70-71 ndodhet portreti dhe një tekst për Skënderbeun<sup>22</sup>.
  25. Bogati Fazekas Miklos [1597] Për bëmat e mëdha e të çuditshme trimërore të të madhit Skënderbe, të cilin e mbanin për princin Gjergj Kastrioti, zot i Epirit, Shqipërisë së Madhe dhe Maqedonisë, që, pas humbjes së Greqisë, në kohët e Janosh Huniadit, i vetëm në Evropë u qëndroi dy perandorëve

<sup>17</sup> Didot, 46,1034; Brunet, II, 445; Noli, 60, 89, 180.

<sup>18</sup> BNW; Bk-An I F 1 (fot. F. 241-258). Bibliografia, 19

<sup>19</sup> BMN-300-775; BIHGJ-mf 67/53. Petrovicht, 31-35; Legrand, 34; Göllner, 1, 1661; Bibliografia, 139.

<sup>20</sup> BK- An II B 13, An IV G 6, An IV C 14, An I F4, An IX A 9. Petrovitch, 38-40; Legrand, 35; Göllner, 1, 1677; Albanica, 64; Bibliografia, 142.

<sup>21</sup> Göllner, 1, 2185; Mostra, 227.

<sup>22</sup> KMUL – 18,5, 60; BK-mfa I K 45 (pjes). Legrand, 48; Bibliografia, 176.

- turq<sup>23</sup>.
26. Summonte Giovanni Antonio [1601] *Historia e qytetit dhe e Mbretërisë së Napolit*. 4 vëllime ku vëll. I është botuar më 1601, vëll. II më 1602, vëll. III më 1640 dhe vëll. IV më 1643. Pjesët për Skënderbeun, duke përfshirë edhe letërkëmbimin e tij, në vitet 1460, me princin e Tarantit, janë marrë prej Sumontes dhe veprat e Pontanos, Piut II dhe Zuritës<sup>24</sup>.
  27. Funccius Theodorus [1606] *Scanderbeg. Skënderbeu*. Ky është një tregim i vërtetë dhe original për veprat luftarake kundër Perandorisë Turke. Teodor Funcihistorian hungarez, e përktheu nga latinishtja në gjermanish. Në këtë vepër janë përfshirë edhe disa letra të sulltanëve turq drejtuar princit Skënderbe dhe përgjigjet e dhëna prej tij<sup>25</sup>.
  28. Des Champs [1670] *Kujtime nga saraji në kohën e Muratit II*. Roman për Skënderbeun i përbërë nga 7 libra<sup>26</sup>.
  29. Pufendorf Samuel de [1684] *Historia e Gjergj Kastriotit, të quajtur zakonisht Skënderbe*. Dhënë e përmbledhur<sup>27</sup>.
  30. Meneses Luis de [1688] *Shëmbull virtytësh morale në jetën e Gjergj Kastriotit, të quajtur Skënderbe, princ i epirotëve dhe shqiptarëve*. Vepër historike për Skënderbeun<sup>28</sup>.
  31. Pufendorf Samuel de [1690] *Historia e Gjergj Kastriotit, të quajtur zakonisht Skënderbe*. Dhënë e përmbledhur më 1684 dhe rishtypur në Upsala në vitin 1690<sup>29</sup>.
  32. Savage J. [1701] *Historia e Turqisë*. Lufta shqiptaro-turke e shek. XV dhe Skënderbeu (156, 163-165, 168-169, 171-177, 191-202, 204-209)<sup>30</sup>.
  33. Chevigny De [1706] *Shkenca e personave të oborrit, të shpatës dhe mantelit me anë pyetjesh dhe përgjigjesh*. Vëll II. Në artikullin kushtuar Shqipërisë, Skënderbeu zë një vend të rëndësishëm (158-162)<sup>31</sup>.
  34. Briot Pierre [1709] *Hyrje për historinë e turqve*. Brio shkruan për Gjon Kastriotin, dërgimin e djemve të tij peng tek Sulltani, kthimin e Skënderbeut në atdhe, për mbrojtjen e Krujës dhe vdekjen e Skënderbeut (25, 26-27,

<sup>23</sup> Picot, 408; Pall, 25; Göllner, 1, 2283.

<sup>24</sup> Michaud, 44, 216; Pérovitch, 173.

<sup>25</sup> BK – An IV G 17. Pérovitch, 62; Legrand, 55; Albanica, 94; Bibloografia, 206-207.

<sup>26</sup> BNP Y<sup>2</sup> 6882-6883. Jaka, 7, 104-127, 341.

<sup>27</sup> OSBK-1138; BK-mf. II K 3. Pérovich, 85; Legrand, 75, Bibliografia, 282.

<sup>28</sup> BK- An IV G 11, An V G 5. Pérovitch, 85-86; Legrand, 79; Albanica, 175; Bibliografia, 293.

<sup>29</sup> KBS; BK-mf. II H8. Bibliografia, 299.

<sup>30</sup> BK –An III S 11.

<sup>31</sup> BNP – G. 13192-13193. Jaka, 1.

- 31)<sup>32</sup>.
35. Duponcet Jean Nicolas [1709] Historia e Skënderbeut, mbretit të Shqipërisë, nga i ati i nderuar Dyponse SJ. Gjatë vitit 1709 është botuar 2 herë<sup>33</sup>.
  36. Biemmi Giammaria [1742, 1752, 1756] Istoria di Giorgio Castrioto detto Scander-Begh di Giammaria Biemmi prete Bresciano. Historia e Gjergj Kastriotit, të quajtur Skënderbe, nga Xhanmaria Biemi prift breshian<sup>34</sup>.
  37. Mignot Vincent [1771] Historia e Perandorisë Osmane, që nga fillimet e saj deri në paqen e Beogradit më 1740. Në këtë vepër trajtohet pjesmarrja e shqiptarëve në betejën e Kosovës, Skënderbeu në luftat e popullit shqiptar nën udhëheqjen e tij etj<sup>35</sup>.
  38. Zannowich Stefano [ 1777, 1779, 1780, 1778, 1782, 1783, 1784, 1788] Shurtore e historisë së jetës dhe bëmave të Skënderbeut, mbret i Shqipërisë dhe dukë i Epirit, nga autori i letrave turke. Historia e Kastriotit të madh të Shqipërisë. Historia e Kastriotit të madh të quajtur Skënderbe mbret i Shqipërisë dhe princ i Epirit. Fjala e fundit, drejtuar djalit të vet, Kastriotit të madh, të quajtur Skënderbe, mbret i Shqipërisë dhe princ i madh i Epirit. Përkthyer nga frëngjishtja<sup>36</sup>.
  39. Marsci Angelo [1808] Ligjërata nga Anxhelo Mashi për origjinën, zakonet dhe gjëndjen e tanishme të kombit shqiptar. Në vepër ai ka trajtuar Skënderbeu, emigrimet e shqiptarëve në Itali, Pronat e Skënderbeut në Itali etj<sup>37</sup>.
  40. Becker Gottfried Wilhelm [1813] Gjergj Skënderbeu dhe Murati. Jetëshkrim për Skënderbeun i botuar në katër numra të revistës arkiv. Jetëshkrimi i ribotua pa asnjë ndryshim si libër më vete, në vitin 1821<sup>38</sup>.
  41. GRÄFE [1828] Gjergj Kastrioti. Një skicë biografike nga e kaluara që paraqet një krahasim me kohën e tanishme<sup>39</sup>.
  42. COMPAGNONI [1829] Historia e Perandorisë Osmane. Përpiluar nga kalorësi Kompanjoni, në bazë të veprave të Sagredos, Kantemirit, Busbegut, Muredjes, Ohsonit e të shkrimtarëve të tjerë të hershëm dhe të tanishëm. Në

---

<sup>32</sup> BK- An IX R 17. Albanica, 201.

<sup>33</sup> BK- AN IV S 13. 80 U 35. Pétrovitch, 87-92; Legrand, 86; Albanica, 200.

<sup>34</sup> BK-An I F 15, An III S 25, An IV R 12. Pétrovitch, 94-95; Legrand, 97; Albanica, 236.

<sup>35</sup> BK- An VIII S 7. Albanica, 266

<sup>36</sup> BML-10605. Aa.28; BK- An V F 15 (fot). BK- , An V D 11, An IV G 19, An V R 3. Pétrovitch, 99-100; Legrand, 109; Albanica, 272.

<sup>37</sup> BK-83 G 11. Albanica II, 27.

<sup>38</sup> BK- An V F 12 (fot). Pétrovitch, 105.

<sup>39</sup> BK-An III S 24, 80 T 43. Pétrovitch, 110; Albanica II, 180.

këtë vepër trajtohet Skënderbu dhe fitoret e tij kundër sultan Muratit II dhe Mehmetit II<sup>40</sup>.

43. Thjulen Lorenzo Ingazio [1832] Dialogë në Mbretërinë e të vdekurve. Dialogu i parë flet për Gjergj Kastrioti i quajtur ndryshe Skënderbe, mbreti i Shqipërisë dhe Epirit<sup>41</sup>.

### **Vepra të pabotuara në formën e dorshkrimeve**

1. Bolonius Heironymus [XV-1517] Skënder është titulli I këtij libri. Nëntitulli vazhdon me ankimi i mallëngjyeshëm për shkatërrimin e të krishterëve, të gënjyer nga turqit e tmerrshëm. Poemas për heroin shqiptar është shkruar prej bashkëkohësit më të ri të tij Xherolamo Bolonjit, shkrimtar, humanist nga Trevizo e Italisë.
2. ARCANGELO [1581-1637] Shqipëria e sulmuar. Tragjedi morale e shumë të nderuarit at F. Arkanxhelo, roman i urdhërit të Shën-Françeskut.
3. Montalban Juan Perez de [1629] Akt sacramental i famshëm për princin e robëruar Skënderbe nga doctor Juan Perez de Montalban, viti 1629.
4. Barletius Marinus [XVII] Shembull virtytësh morale në jetën e Gjergj Kastriotit, të quajtur Skënderbe, princ i epirotëve dhe shqiptarëve. Ky dorshkrim është i ndryshëm nga botimi i vitit 1588.
5. Vivaldi Antonio [1718] Skënderbeu. Dorëshkrim që ruhet BNT Raccolta Mauro Foa e Renzo Giordano, Vol. II; BK- mf I G 23.
6. Franco Demetrio [1763] Bëmat e dëgjua dhe të lavdishme dhe fitoret që ka korrur kundër turqve Gjergj Kastrioti, i quajtur Skënderbe, zot dhe sundimtar i Epirit. Tregohet mjeshtëria ushtarake e të komanduarit të ushtrisë për t'i bërë ushtarë e gatshëm për luftë, që të fitojnë çdo betejë të rëndë. Përkthyer nga italishtja prej Vladul Boculeskut nga Malaeshti në vitin 1763 në Milano të Lombardisë.
7. Gisslasson Forestien [1832] Skënderbeu. Është një histori e Skënderbeut në gjuhën Islandeze që ruhet në dsh. dhe në disa kopje ose versione në sektorin e dorëshkrimeve të Biblotekës Kombëtare të Islandës.

Të pakta janë figurat historike, që kanë gjetur një jehonë kaq të gjerë në literaturën botërore gjatë shekujve, siç është figura e Heroit Kombëtar shqiptar Gjergj Kastrioti-Skënderbeu. Këtu nuk është fjala vetëm për literaturën e mirëfilltë shkencore, siç është ajo historiografike, një jehonë që nuk është e gjerë vetëm nga numri, nga shtrirja gjeografike e vendbotimeve, e gjuhëve, gjinive

<sup>40</sup> Bk-67 V 3 (1). Albanica II, 197.

<sup>41</sup> BIHGJ-I. Ital. Th. 506.

(artistike, letrare etj.), por një literaturë që vjen duke u zgjeruar vazhdimisht nga koha e prodhimeve të para të artit tipografik, nga inkunabet e para të shek. XV e deri në ditët tona.

Orvatja e parë për një bibliografi të tillë, të cilën e pat botuar në kushte të vështira bibliografi i apasionuar G. Petroviç, kur hartoi një bibliografi të Skënderbeut, ku mundi të regjistronte njëqind e tëtëdhjetë botime vetëm në gjuhët e Evropës Perendimore, ky numër është kapërcyer dhe ka ardhur duke u rritur për t'iu afruar mijëshit. Mjafton të themi se në kohët e fundit po zbulohen vazhdimisht thesare të reja bibliografike në vënde e biblioteka deri tani të panjohura.

Duke patur këtë numër jashtëzakonisht të madh të veprave kushtuar heroit dhe luftës popullore që udhëhoqi ai, lind vetvetiu pyetja: **Cila është vlera shkencore e mirëfilltë e tyre?**

Nuk ka dyshim se vetë numri është një tregues i qartë për peshën e kësaj ngjarjeje e po aq elokumente në këtë drejtim është larmia tematike të veprave të kësaj bibliografie si dhe shtrirja aq e gjerë gjeografike e vëndeve nga të cilat vijnë ato.

Studiuesi që i drejtohet kësaj bibliografie do të ketë parasysh faktin që kjo nuk përfshin vetëm ose kryesisht literaturë shkencore, që mund të shërbejë për të njohur burimet parësore për këtë periudhë historike. Në këtë drejtim, po të kishte ky punim vetëm këtë qëllim, të jepte burimet historike, ose të rregjistronte botimet studimore, ai duhej të reduktohej vetëm në një përqindje të vogël, aq më tepër që burimet për këtë periudhë janë thuajse tërësisht të karakterit arkivor; akte, kronika etj., që ruhen si dorëshkrime nëpër arkiva dhe vetëm një numër i vogël ka parë dritën e botimit dhe rrjedhimisht është përfshirë në këtë bibliografi. Kjo nuk pakëson vlerën praktike të këtij punimi. Kjo bibliografi përveç një qëllimi praktik merr një domethënie të veçantë; ajo dëshmon se përtej shekujve figura e Skënderbeut dhe lufta e udhehequr prej tij e ka ruajtur domethënien dhe ka vazhduar të tërheqë interesin jo vetëm të historianëve të mirëfilltë po në përgjithësi të mendimit politik dhe ushtarak, të njerëzve të artit etj., duke kapur aspekte të ndryshme që paraqet ajo si ngjarje e madhe historike, si dukuri shoqërore dhe në aspektin njerëzor. Secila periudhë e ka parë epokën dhe figurën e saj qëndrore sipas shijeve dhe rrymave letrare artistike dhe koncepteve filozofike që mbizotëronin në atë periudhë ta caktuar, duke ju përshtatur problemeve dhe interesave të saj. Në këtë kuptim figura e Skënderbeut e pasqyruar në prodhimet historografike dhe letrare është përsëri prodhim i historisë, i shijeve dhe interesave të secilës epokë; sipas këtyre ndërrojnë përpjestimet që i jepen asaj, figurat metaforike, stili i lulëzuar ose retorik.

Sipas rastit dhe mjedisi nga i cili vjen kjo literaturë, ndryshe nga mjedisi

oborrtar, apo popullor dhe folklori, ndryshe nga rrethet e intelektualëve klerikë ose të borgjezisë së re dhe të apsolutizmit illuminist, figura e heroit shqiptar merr ngjyra herë reale e herë johistorike, herë të një heroit sallonesh, ose të amantit kalorsiak duke i dhënë heroit shqiptar një ngjyrë që ndryshon për çdo periudhë historike. Por ajo që mbetet pa ndryshuar është fakti se pamvarsisht nga trajtimi historik ajo zë gjithmonë një vënd nderi, së cilës koha nuk i hoqi dot shkëlqimin. Mbetet kurdoherë fjala e humanistit bashkëkohës Enea Pikolomini “ Nuk qenë shekujt që e zbehën këtë figurë të madhe, përkundrazi Gjergj Kastrioti i mposhti shekujt”. Ato nuk mundën as të zhdukjin rrjedhimet objektive të kësaj lufte, as kujtimin e saj në zemrën e kujtesën e popullit shqiptar dhe të botës mbarë. Edhe në shekujt më të errët të robërisë, popujt u mbajtën mbas këtij emri duke e valëvitur si flamur lufte.

Është krenari për historinë tonë kombëtare që kjo letërsi kaq e pasur botërore mbështetet mbi veprën e një shqiptari, në biografinë e shkruar nga një bashkëkohës më i ri i heroit tonë, Marin Barleci shkodrani, siç e quan ai veten me krenari. Me një stilt ë shkëlqyer prej humanisti, me patriotizëm të zgjarrtë luftarak prej shqiptari, me një tregim dramatik, Marin Barleci, po aq artist sa dhe historian, hyri në letërsinë botërore, ashtu siç hyri hero i tij në historinë botërore. Një vështrim mbi datat e botimeve të origjinalit latinisht të veprës së humanistit shkodran dhe e përkthimeve të saj në gjuhët kryesore evropiane e vërtetojnë këtë plotësisht. E botuar gjatë viteve 1508-1510 kryevepra e Barlecit njohu jo më pak se 16 botime deri në mesin e shek XVIII: 4-latinisht, 4-gjermanisht, 4-italisht, 1-portugalisht, 1-polonisht, 2-spanjisht. Përtej këtyre botimeve që u ruajtën integralisht qoftë edhe në gjuhë të tjera origjinalin e Barlecit, ajo u bë një mbështetje drejtpërdrejtë e pothuajse të gjithë prodhimit historografik letrar të shekujve të mëvonshëm në vëndet më të ndryshme evropiane.

Një rol të rëndësishëm si burim të dhënash për këto histori kushtuar Skënderbeut në vënde të ndryshme evropiane, krahas Barlecit, ka luajtur edhe një vepër tjetër e historografisë shqiptare për Skënderbeun, e hartuar së pari në latinisht prej një bashkëluftëtari të heroit, të quajtur Dhimitër Frëngu, që jetonte i mërguar në Itali në të njëjtën kohë me Barlecin. Veprën e këtij, Dhimitër Frëngu pa dyshim që e ka njohur. Kështu shpjegohet që ajo përsërit në mënyrë të përmbledhur, ndonëse me disa ndryshime, të dhënat kryesore të Barlecit, ndonëse me disa shtesa interesante që tregojnë se autori ishte njeri i rrethit të heroit të Krujës(ai i përkiste një familjeje të madhe drishtiane).

Vepra latinisht e Dhimitër Frëngut u përkthyer në Italisht dhe u botua anonime për herë të parë më 1539. Në krahasim me historinë e Barlecit ajo ishte më e përmbledhur, më e ngjeshur dhe më e përdorshme. Rrjedhimisht botimi i saj më pak i kushtueshëm. Prandaj ajo njohu shumë botime: deri në

shek XVIII ishte afër 18 botime italisht, një frengjisht, një anglisht; një përkthim në dorëshkrim rumanisht. Kurse botimi italisht i kësaj vepre i vitit 1584 e të tjerë që e pasuan u bënë në përputhje me tekstin latinisht fillestar.

Vepra me vlera të veçanata autentike të historografisë shqiptare në epokën e Skënderbeut janë “ Rrethi i Shkodrës” i Barleci botuar në 1504 dhe një fjalim panegjirik i një humanisti tjetër shqiptar Marin Biçikemit nga Shkodra. Një vepër e tretë, me vlera themelore si burim historik, është “ Historia dhe gjenealogjia e shtëpisë së Muzakajve”, hartuar më 1510, prej bashkëluftëtarit të Skënderbeut Gjon Muzaka, një burim që është quajtur “një xhevahir i paçmueshëm” për historinë shqiptare.

Edhe pse nuk mund të krahasohen me veprat e përmendura më lart, nuk mund të lihen pas dore e nuk duhen harruar veprat e Frank Bardhit kushtuar mirëfilltas Skënderbeut, një përpjekje plot eurodicion për të mbrojtur origjinën shqiptare kundër përpjekjeve për ta nxjerrë me origjinë sllave. Kuadri i historografisë së vjetër shqiptare plotësohet në veprat e Pjetër Bogdanit dhe të Andrea Ğngjellit. Pamvarsisht se nuk kanë vlerën e veprës themelore të Barleci të gjitha këto përbëjnë një dëshmi edhe të nivelit intelektual të shqiptarëve bashkëkohës, por edhe të patriotizmit që i shtynë autorët e tyre për të rrokur pendën, për të mbajtur gjallë kujtimin e heroit ashtu siç e bënte folklori me këngët epike dhe legjendat.

Figura e Skënderbeut dhe lufta heroike e udhëhequr prej tij u bë qysh herët një temë e trajtuar vazhdimisht në historografinë e huaj. Është e qartë se në veprat kushtuar historisë së Perandorisë Osmane, mbretërisë së Napolit, Venedikut nuk mund të lihej pa përmendur qoftë edhe në mënyrë episodike, ndërhyrja e heroit shqiptar në historinë e tyre, duke ndjekur zakonisht tregimin e Barleci. Titujt që mbajnë disa nga këto vepra të shumta që qarkullonin në Evropë për Skënderbeun tregonin qartë se ç’kuptim kishte për autorët e tyre figura e Skënderbeut.

Prifti çek Jakob Pontano në botimin e tij latinisht (viti 1609) i dha veprës së tij, një analogji me fjalimet e Skënderbeut të nxjerra nga Barleci me titull elokuent: Ajo duhet të shërbente “Për të kuptuar për të përbuzur dhe për të luftuar tërbimin e pafe të turqve veçanërisht në ditët e sotme”. Ky synim aktual i qartë del shpeshherë në botimet. Kështu më 1683 kur ushtritë osmane gjëndeshin përpara Vjenës, që e kishin rrethuar, një autor anonim mendonte se vetëm po të ndiqej shëmbulli i Gjergj Kastriotit, shtetet e Evropës Qëndrore do të mund të zbrapsnin furinë osmane duke shpëtuar popujt e vet nga shkatërrimi: “Kastrioti, Skënderbeu i ringjallur, ose arsytim politik i mprehtë, si dhe ç’mënyrë sundimtarët mund të dëbojnë brënda katër vjetëve krejtësisht osmanët nga Evropa”.

Nuk është e habitshme prandaj pse figura e Skënderbeut ishte e bërë e njohur botërisht si symbol i luftës për çlirim e bashkim të popujve.



Një poet francez në shek XVI, në një vjershë me të cilën shoqëronte veprën e historianit francez Zhak Lavarden kushtuar Skënderbeut, u drejtohej francezëve me thirrje: “ Francezë ndiqni shëmbullin e Skënderbeut, hiqni dorë nga lufta vëllavrasëse dhe luftoni kundër të huajve që ju shkelin tokën amtare”. Në një drejtim të kundërt e ngrinin lart heroit shqiptar më 1657 fjalimet e mbajtura mbi varrin e udhëheqësit ukrahinas Bogdan Hmelnicki që e vajtonin atë si Skënderbeun e lavdishëm të Ukrainës.

Një aspekt tjetër tërhiqte interesin e një vargu burrash shteti, strategësh e filozofësh të Evropës Perendimore.

Ushtarakët anglezë U. Temple dhe XH. Volf të shek XVII-XVIII studionin artin ushtarak të heroit shqiptar si shëmbull për teoritë e tyre strategjike dhe theksonin se vendimtare në luftën moderne të kohës nuk duhej të ishin “sasia, numri, por forca goditëse e një ushtrie të vogël të lëvizshme, siç kishte treguar përvoja e ushtrisë e udhëhequr nga Skënderbeu”.

Sundimtarëve të zvetënuar të kohës filozofi iluminist Volter u kundërvinte figurën e Skënderbeut, duke shfaqur mendimin se: “historia botërore do të kishte marrë një rrugë tjetër, po qe se në vënd të bizantëve do të kishin qëndruar Skënderbeu dhe populli i tij”.

Lëvizjet e reja ideologjike, iluminizmi evropian, e kapën këtë figurë si shëmbull të një njeriu që qëndronte mbi dhe jashtë feve fanatike siç ishte islami dhe krishtërimi, si një njeri që u shkëput nga tirania dhe një karrierë e shkëlqyer në shërbim të sulltanëve, për t’u kthyer në atdheun e tij, për t’u vënë në krye të luftës së masave popullore, për t’u sjellë lirinë dhe pavarësinë e humbur.

Heroi ynë merr tani, në letërsinë evropiane të shek XVIII, në Francë, në Gjermani etj., karakterin e një burri shteti ideal, të një mbreti “të urtë”, “filozof” sipas përfytyrimit të iluministave të rinj, të frymëzuar nga racionalizmi dhe antiklerikalizmi karakteristik për këtë rrymë.

Lindi kështu rreth figurës së Skënderbeut një letërsi e re, në dukje me karakter biografik, po me qëllime politike e filozofike që meriton po aq vëmëndjen tonë sa ajo letërsi glorifikuese në historiografi ku heroit shqiptar paraqitet si symbol i luftës për pavarësi.

Këto qëllime polemike aktualizuese që i atribohen Skënderbeut duken qartë në një varg veprash si në ato të një autori dalmat S. Xanoviçit botuar në frengjisht, gjermanisht, suedisht dhe në vënde të Evropës Lindore me titull “Kastriot i Madh i Shqipërisë”. Ajo që e shpjegon suksesin e veprave të tij nuk është përmbajtja e pasur, madje veprat përmbajnë një varg shtrembërismesh të fakteve të bëra me qëllim aktualizmi, as edhe cilësitë e tyre artistike. E reja që i siguroi veprës së tij përhapje të gjërë ishin prirjet antiabsolutiste, antiklerikale dhe iluministe që i ishin veshur figurës së Skënderbeut. Ai paraqitej në mënyrë

anakroniste si kombinacion i filozofit dhe mbretit iluminist.

Duket sikur dëgjojmë një përfaqësues të iluminizmit evropian kur në një letër të Skënderbeut drejtuar Sulltan Mehmetit II autori shkruan fjalët: “Unë nuk dua të shtoj pasurinë dhe lavdinë time në kurriz të jetës dhe mirëqënies e të lumturisë së popullit tim”.

Si një skicë e filozofisë së shtetit dhe së drejtës së iluminizmit evropian tingëllojnë mendimet e Skënderbeut, që i shfaq të birit para vdekjes së vet. Aty karakteri anakronist është fare i hapur ashtu si edhe qëllimi i autorit për të fshehur në këtë mënyrë mendimet e tij nga censura politike e kohës: “Mbroji zejtarët si njerëzit më të dobishëm dhe kij kujdes se mos shtypen nga të pasurit, mbro filozofët në shtetin tënd kundër zellit të tepruar të fetarëve e priftërinjëve hipokritë”. Kuptohet se me të tilla ide i ashtëquajturi testament i Skënderbeut u bë shumë popullor në Evropë dhe u botua madje si botim i veçantë (gjermanisht më 1794; rusisht më 1856).

Krahas kësaj literature historografike, publicistike dhe politike qysh herët mori hov e u zhvillua dhe letërsia artistike që kishte si figurë qendrore Skënderbeun. Madje mund të thuhet se letërsia që e para që rrahu këtë temë në formën e këngëve popullore të lindura në Shqipëri që në kohën e ngjarjeve luftarake por jo vetëm këtu, po edhe në viset e tjera ballkanike.

Dëshmitë e para të letërsisë artistike të mirëfilltë sidoqoftë janë diçka më të vona se vdekja e heroit tonë; mund të thuhet se ndër ata që i kushtuan homazhin e vet Skënderbeut në krijmtarinë artistike qëndrojnë emra nga më të mëdhenjtë të letërsisë evropiane si Ronsar, poet i madh lirik francez, spanjulli Lope de Vega e anglezi Marlow (Marlow) etj.

Në shek e XVI, shekulli i poezisë së madhe heroike të Ariostos, Tasos dhe e poetëve të mëdhenj Italianë i shërbeu si model një vargu të tërë poetësh si p.sh. italianëve Skarameli, Saroki, hungarezit Bogati etj.

Në shëmbullin e klasikëve këto poema gërshetohen elementë historikë me elementë fantastikë të marra hua nga epika feudale nga romanet oborrtare dhe më në fund nga epika klasike e antikitetit. Skemën e këtyre poemave e mbushin heronj me emra, armë dhe veshje që u bëjnë t’u ngjasin më shumë Rolandit se sa shqiptarëve dhe turqve të shek XV.

Në ushtritë e sjellë nga sultan Murati II përpara Krujës nuk mungojnë as mbretër të vëndeve përralore, si ai i Abisinisë, magjistarë orjentalë etj; në betejat marrin pjesë gra të veshura si burra dhe midis armiqve krijohen lidhje dashurie; heronj shqiptarë si Skënderbeu, Vrana Konti dashurohen me heroina që vijnë nga oborri i sulltanëve dhe bien si robër të bukurisë dhe dashurisë së tyre.

Temën e Skënderbeut, të heronjëve të krishterë luftëtarë kundër “të pabesëve” nuk munguan të lëvronin edhe shkrimtarë dhe poetë që vinin nga radhët e klerit

katolik si p.sh. jezuitët që në shkollat e tyre e bënë heroin shqiptar hero të një vargu dramash dhe tragjedish.

Në fund të shek. XVII dhe fillim të shek. XVIII periudhë që njohu zhvillimin e romanit oborrtar veçanërisht në Francë, e kanë origjinën disa botime të tipit të romaneve, kalorsiakëve dhe oborrtarë që ishin atëherë në modë.

Për arsye të peripecive dramatike që njohu jeta e heroit, tema e Skënderbeut nuk mund të mos i interesonte teatrit. Në historinë e teatrit evropian, veçanërisht të Evropës Perëndimore, në Spanjë, në Francë, në Austri e Gjermani nuk munguan një varg veprash me temën e Skënderbeut. Këtë temë e kapën edhe komedianët ambulantë profesionistë anglezë dhe gjermanë, për qëllimin e tyre, duke e shpënë tej deri në Evropën Lindore.

Tema e Skënderbeut përbën një nga ato tema madhore, kurdoherë aktuale që duke shkuar përtej interesit thjesht shkencor e duke qëndruar në nivelin më të lartë të interesit që i kushtoi letërsia botërore, për nga pesha dhe rëndësia zë gjithmonë një vënd të veçantë në historinë e luftërave çlirimtare të popujve.

## **Përfundime dhe Rekomandime**

Në përfundim të këtij punimi është domethënëse fakti që, nga kalimi i mesjetës në historinë e re evropiane, Shqipëria dhe figura e Skënderbeut hyjnë tashmë për të zënë një vënd qëndror në historinë botërore, gjë që pasqyrohet më së miri në rritjen e hovshme të botimeve kushtuar kësaj epoke në literaturën botërore. Dhe pikërisht nga kjo periudhë fillon të shfaqet e të kërkojë zgjidhje problem i një bibliografie kushtuar kësaj figure, me përmasa botërore, të historisë shqiptare.

Një bibliografi kushtuar Skënderbeut padyshim nuk mund të lërë jashtë periudhën e pushtime osmane në Ballkan, as nuk mund të injorojë historinë politike, ekonomike ushtarake, kulturore të popullit shqiptar e vëndit të tij në shek XV dhe në shumë pikpamje do të ndeshet me historinë e mardhënieve ndërkombëtare në shkallë evropiane, sepse i tillë qe rrezatimi i gjerë i domethënies botërore të kësaj lufte, qoftë i invazionit por edhe atyre që iu kundërvunë këtij invazioni dhe iu bënë ledh këtij vërshimi.

Ne jemi larg dhe kundër atij koncepti që do të donte ta shihte vërshimin osman thjesht si një dukuri ushtarake, duke abstraguuar nga sfondi i tij ekonomiko-shoqëror nga të dyja anët, të pushtuesve dhe të mbrojtësve, por dhe po aq larg jemi nga koncepti që nuk do të vlerësonte faktorin dhe rolin e personalitetit të njerzve që e bënë këtë luftë, të atyre masave popullore që mbajtën në shpatulla peshën e tyre kryesore, sakrificat e kësaj lufte, si dhe të figurave udhëheqëse të kësaj lufte që vunë në lëvizje masa e mjete njerëzore e ushtarake të panjohura gjer atëherë, siç qenë “pushtuesit e botëve”.

## **Conclusions and Recommendations**

At the end of this paper, it is significant that since the medieval transition to the new European history, Albania and Skanderbeg figure are now entering a central place in world history, which is best reflected in the widespread growth of dedicated publications this era in world literature. And from this period begins to appear and seek the solution problem of a bible dedicated to this figure, of world scale, of Albanian history.

A sculpture devoted to Skanderbeg certainly can not leave the period of Ottoman invasions in the Balkans nor can he ignore the political, military, cultural, and cultural history of the Albanian people of his country in the 15th century and in many respects will face the history of relations international on a European scale, because such was the widespread radiation of the world's significance of this war, both of the invasion but also of those who opposed this invasion and became the cause of this flood.

We are far from and against that concept that would like to see the Ottoman flood simply as a military phenomenon, abstraction from its socio-economic background on both sides, invaders and defenders, but as far from the concept as would not appreciate the factor and the role of the personality of the people who made this war of those popular masses that held their major weight, the sacrifices of this war, and the leading figures of this war that set the masses and tools human and military alien until then, as were "the invaders of the worlds".

## **Bibliografia**

- A. Zoba, Z. Prela: Albanica I, Vepra të botura në shek XVI-XVIII, Tiranë 1965.
- A. Shuli: Bibliografia shqiptare pasurohet. [In]: Tempo-Koha. Roma, nr.9 7 maj 1942
- Albanica I. Bibliografia e shek XV-XVIII, Përgatitur nga Shpëtim Mema dhe Afërdita Sharrëxhi, Tiranë, 1998.
- Albanica II. Bibliografi e viteve 1800-1849, Përgatitur nga Shpëtim Mema dhe Afërdita Sharrëxhi, Tiranë, 1987.
- B.B. Ashcom: Note on of development of the Scanderbeg theme. [In]: Comparative literature, V, 1953, Eugene, Oregon USA.
- Bardhi, Frang, Skënderbeu (Apologji). Përkthyer St. Prifti, Tiranë 1957. Ribotuar Tiranë 1962, Shkup 1968. Shih veprën origjinal: Blancus Franciscus.
- Barletius, Marinus., De obsidione Scodrensi, Venetiis 1504, f.44. Përkthyer shqip: M. Barleti Rrethimi i Shkodrës (përkthyer nga H. Laçaj) Tiranë 1962. Botimi i dytë, Tiranë 1968.
- Barletius, M. Historia de vita at gestis Epiratorium Principis etc, Impressum Romae per B (ernardinus) V (itabilus) S.a. (1508-1510). Në shqip M. Barleti Skënderbeu (përkthyer nga S. Prifti), Tiranë 1964. Ribotuar: Tiranë 1968, Prishtinë 1968.
- Dh. Pilika: Duke kërkuar “Albanica” ndër arkiva dhe biblioteka të huaja. [In]: Konferenca e parë e Studimeve Albanologjike. Tiranë, 1965.
- F.S. Noli: George Castrioti Scanderbeg (1405-1468), New York, 1947.
- F.S. Noli: George Castrioti Scanderbeg (1405-1468), New York, 1947.
- G. Biemi: Istoria di Giorgio Castrioto deto Scander-Begh, Brescia, 1742.
- K. Biçoku, J. Kastrati: Gjergj Kastrioti Skënderbeu Bibliografi, 1454-1835, Vëll I, Publikuar Biblioteka Kombëtare, Tiranë 1997.
- Shpëtim. Mema, Lindita. Bubs: Albanica II, Bibliografi e viteve 1800-1849, Tiranë, 1987.

**Prof. Asoc. Dr. Enver BYTYÇI**

## **DIPLOMACIA E SKËNDERBEUT DHE MARRËDHËNIET E TIJ ME VENDET E KRISHTERA!**

Historia politike dhe diplomatike e Gjergj Kastriotit Skënderbeut është një histori e pasur dhe e mbushur me një veprimtari të ngjeshur në këtë fushë. Vetë aktet e bashkimit të shqiptarëve me Lidhjen e Lezhës të 2 marsit 1444 ose udhëheqja e betejave ushtarake kundër invazionit osman përbëjnë gjithashtu një lëvizje të fuqishme politike të heroit tonë kombëtar. Gjithë jeta e tij mund të shpjegohet dhe interpretohet si një jetë e gjallë politike e ushtarake dhe diplomatike.

Ushtrimi i diplomacisë nga ana e principatës së Krujës të drejtuar nga Skënderbeu nuk bën përjashtim nga rregullat e përgjithshme të misioneve diplomatike të mesjetës së vonë, madje ngjason me përpjekjet e rregullat e diplomacisë së sotme për lidhjen e aleancave, përfaqësimin diplomatik, nënshkrimin e dokumenteve, marrëveshjeve, traktateve si dhe memorandumeve midis shteteve e përfaqësuesve të tyre.

Duhet të kemi parasysh se Skënderbeu për 25 vite radhazi u angazhua në një luftë të pabarabartë dhe të ashpër kundër trupave të ushtrisë më të madhe të kohës, Perandorisë Osmane. Në këto luftëra ai korri fitore të njëpasnjëshme, por pësoi gjithashtu humbje e shkatërrime të pallogaritshme. T'i kundërviheshe një ushtrie perandorake i vetëm dhe pa mbështetje të aleatëve dhe partnerëve europiane, ishte një sipërmarrje e paimagjinueshme.

Prandaj Gjergj Kastrioti - Skënderbeu betejat e tij ushtarake i shoqëroi vazhdimisht me beteja diplomatike, duke i harmonizuar këto veprimtari në varësi të njëra –tjetrës. Pas çdo beteje dhe fitores së radhës, atij i trokitën në derë aleatë të shumtë, të sinqertë ose më pak të sinqertë, të besueshëm ose më pak të besueshëm, të afërt apo pak më të largët. Në çdo rast ai u përpoq të shfrytëzojë rrethanat e krijuara nga kryengritja anti-osmane shqiptare për të ndërtuar marrëdhënie bashkëpunimi me shtetet fqinjë të Italisë, të rajonit dhe të Europës Qendrore.

Nga studimi i kësaj veprimtarie diplomatike të Skënderbeut rezulton se lidhjet e tij diplomatike aso kohe u shtrinë në tri linja kryesore:

1. Në linjën e marrëdhënieve dhe ndihmës ushtarake të ndërsjellë me Hungarinë e Janosh Huniadit, si dhe me Austrinë!
2. Me vendet fqinjë, Bosnjë-Hercegovinën dhe Raguzën (Dubrovnikun e sotëm) si dhe principatat e tjera ballkanike.
3. Ndërsa marrëdhëniet diplomatike e politiko-ushtarake me shtetet italiane, përkatësisht Mbretërinë e Napolit, Vendikun, Papën, Romën dhe shtetin e Mailandit (Milanos) ishin më aktive, konkrete dhe interesante.

Ajo që bie në sy në diplomacinë e Skënderbeut ka të bëjë me faktin se ai shumë herë i ndërtoi marrëdhëniet personalisht me mbretërit dhe personalitetet më të larta të kohës. Në këtë sipërmarrje diplomatike e favorizoi fakti se Gjergj Kastrioti dinte, sipas Barletit, shumë gjuhë, osmanllisht, arabisht, greqisht, bullgarisht dhe serbo-kroatisht. Vizitat dhe kryqëzatat e Skënderbeut përtej Adriatikut, sidomos në ndihmë të djalit të ish Mbretit Alfons IV, Ferdinandit, dëshmojnë për atë se komandanti ushtarak i Krujës ishte gjithashtu një burrë shteti që i qëndronte marrëveshjeve. Skënderbeu vizitoi Romën si dhe Raguzën.

Sipas Marin Barletit, Gjergj Kastrioti Skënderbeu ishte shtat lartë, i fortë, me një trup perfekt në pamje, siç ishte pamja e njeriut ilir, gjurmët e të cilit gjendeshin në banorët e maleve të Shqipërisë, ku bënte pjesë edhe familja e Kastriotëve. Por jo vetëm kaq. Barleti shkruan se Skënderbeu dallohej në mesin e të tjerëve edhe për inteligjencën, kulturën dhe aftësitë e tij si një ushtarak, politikan e diplomat i talentuar.

Në këtë kuptim duket qartë se diplomacia e Skënderbeut shfaqet si mjeshtrëri e diplomacisë për kohën e atëhershme, por dhe si model për kohët e sotme. Ai e pa diplomacinë si mjet për aleanca, si mënyrë për hartimin dhe zbatimin e strategjisë së udhëtimit 25 vjeçar anti-osman, por edhe si armë për mbijetesë. Në këtë kuptim, kompromisi dhe respektimi i marrëveshjeve ishin karakteristikë e diplomacisë skënderbeniane. Ndërkohë që në shumë raste marrëveshjen ai e pa si taktikë të ndërmjetme për të arritur një strategji të caktuar. Vetëm në një rast, kur më 1461-tën nënshkroi marrëveshjen e armëpushimit me Sulltanin, ai nuk e respektoi atë deri në fund. Edhe në këtë rast u ndikua nga nxitja e Venedikut dhe Papës që kjo marrëveshje të mos arrihej ose së paku të shkelej.

Më 26 mars 1451 Skënderbeu kishte lidhur me Mbretin e Napolit, Alfons IV, një traktat politik, të cilin e kishte nënshkruar në emër të Lidhjes së Lezhës.<sup>1</sup>

Qëllimi ishte që ushtria shqiptare e Skënderbeut të bashkohej me ushtrinë e Mbretërisë së Napolit dhe së bashku të dy ushtritë të çlironin territoret shqiptare nga invadimi dhe sulmet e ushtrisë osmane. Me çlirimin e territoreve shqiptare,

<sup>1</sup> *Andrea Frediani: I grandi condottierichehannocambiato la storia. NewtonComptoneditoris.r.l., Rom, 2012, S. 403 (italienisch, Online-Version in der Google-Buchsuche [abgerufen am 2. November 2016]).*

Skënderbeu ishte i gatshëm, sipas marrëveshjes, t'i ofronte Alfonsit IV privilegje në Principatën e Krujës, duke i paguar Mbretit të Napolit një kontribut (taksë) të përhershme, si dhe duke e njohur atë si Mbret të Krujës. Në të njëjtën kohë Napoli i ofroi Krujës garanci për çlirimin e saj e të territoreve shqiptare nga ushtritë e Perandorisë Osmane, si dhe solli në Shqipëri municione, armë, trupa ushtarake dhe para si mbështetje për mbrojtje. Por marrëveshja parashikonte që Shqipëria të ruante autonominë e saj dhe të vetëadministrohej nga ana e Skënderbeut.

E vërteta është se Alfonsi IV e ndihmoi Skënderbeun sipas kushteve të parashkuara në traktat, por jo me trupa ushtarake të konsiderueshme, aq sa të ndryshojë balancën në favor të kryengritjes shqiptare. Megjithatë Gjergj Kastrioti i qëndroi besnik atij edhe pas vdekjes së tij më 27 qershor të vitit 1458. Megjithëse situata ndryshoi në Napoli, Mbreti Ferdinand I vijoi ndihmat e tij derisa pasuesi i Alfonsit IV u gjend përballë revoltës lokale të baronëve francezë.<sup>2</sup>

Në kushtet kur Ferdinand i po rrezikohet në fron, Papa Pius II i shkroi Skënderbeut dhe i kërkoi që t'i shkonte në ndihmë Mbretit të Napolit.<sup>3</sup>

Për të ndihmuar aleatin e tij në Napoli, Skënderbeu dërgoi një forcë ushtarake të fuqishme prej 5000 vetash, në krye të së cilës emëroi nipin e tij (djalin e motrës), Gjok Balsha. Gennaro Maria Montishkruan se kjo ushtri erdhi në Napoli në këmbë dhe me kuaj dhe se ajo u dërgua nga Skënderbeu në ndihmë të mbretit napolitan.

Më 17 prill 1461 Skënderbeu lidhi një marrëveshje armëpushimi tri-vjeçare me Sulltanin, ndërkohë që periudhën e parë të saj e shfrytëzoi të ndërmerre veprimtari diplomatike të drejtpërdrejta, si udhëtime në disa vende. Gennaro Maria Monti, S. 138 Në gusht të atij viti Ai udhëtoi me anije në Ragusa (Dubrovnik), ku u prit me festime në Senat. Në të njëjtën ditë nipi i tij, Gjoka, mbërriti me ushtrinë e tij në Barreta të Puljas me 1000 kalorës dhe 2000 këmbësorë.<sup>4</sup>

Dhe për të argumentuar këto, do të më lejohet të prek disa detaje të ushtrimit të diplomacisë ndërkombëtare nga ana e Gjergj Kastriotit Skënderbeut.

Pasi mori Krujën përmes fermanit të remë të Sulltanit dhe pasi asgjësoi komandantin e ushtarët e Sulltanit, Skënderbeu thirri Lidhjen e Lezhës, e cila u mbajt më 2 mars të vitit 1444 në Kishën e Shën Nikollit në Lezhë. Krerët

<sup>2</sup> Gennaro Maria Monti, S. 127

<sup>3</sup> F.A. Primaldo Cocco: *Casali Albanesin el Tarentino*. Scuola Tipografica Italo-Orientale "San Nilo", Grottaferrata 1921, S. 9 (italienisch).

<sup>4</sup> Gennaro Maria Monti, S. 138.



e principatave shqiptare, të cilët morën pjesë në këtë mbledhje u njohën me programin politik të qëndresës së Skënderbeut kundër ushtrisë osmane dhe i dhanë atij mbështetje politik të plotë politike, materiale, njerëzore, financiare dhe orale. E ngarkuan atë gjithashtu me detyrën e Komandantit të Përgjithshëm të Kryengritjes së Armatosur. Kjo do të thoshte se principatat shqiptare të kohës ishin ngritur cilësisht në stadin më të përparuar të implementimit të normave shtetërore, njësoj sinë të gjitha vendet europiane.

Pas kësaj, vetëm pak muaj më vonë, më 29 qershor 1444 u zhvillua beteja e parë e ushtrisë shqiptare të Skënderbeut me ushtrinë osmane në Fushën e Terviollit, ku ushtria e Skënderbeut e asgjësoi atë të osmanëve, duke korrur fitoren e parë të bujshme në mbrojtje të trojeve arbërore. Kjo fitore u përhap në të gjithë rajonin, aq sa Papa Eugen IV propozoi një fushatë ushtarake antiislame, të cilën do ta udhëhiqte Skënderbeu. Kësisoj që në fillim princi shqiptar e hapi derën për një marrëdhënie intensive diplomatike me shtetet italiane dhe ballkanike. Pesëmbëdhjetë muaj më vonë, më 10 tetor 1445, Skënderbeu në krye të 15 mijë kalorësve zhvilloi betejën e dytë kundër osmanëve, tashmë në Mokër dhe korri përsëri një fitore të bujshme ndaj tyre. Kësaj here Papa dhe Alfonsi I i Aragonës, Mbret i Napolit, dërguan delegacione në Krujë dhe festuan fitoren e arritur. Skënderbeu u quajt nga ata “Mbrojtës I palëkundur I civilizimit perëndimor, mbrojtës i Krishtëritit dhe madje u emërtua si “atlet i Krishtit”. Ishte ky rezultat e kjo fitore në thelbin e vlerësimit të madh dhe respektit që udhëheqësi ushtarak i shqiptarëve fitoi në shtetet perëndimore, parasëgjithash ato fqinjë italiane.

Një vit më vonë, Sulltan Murati II dërgoi kundër Skënderbeut një ushtri prej 25 mijë vetash. Në betejën e zhvilluar më 27 shtator 1446 osmanët pësuan një humbje katastrofale, gati u asgjësuan tërësisht. Për këtëfitore Papa Caliktus III I dërgoi Skënderbeut ndihma financiare në para dhe i premtoi ndihmë ushtarake, duke ndërmjetësuar edhe me Venedikun.<sup>5</sup>

Fan S. Noli në librin e tij “Historia e Skënderbeut (Mbretit të Shqipërisë) 1412-1468, shënon disa ngjarje kryesore të viteve 1444 deri më 1451, ndër të cilat veçojmë betejat e Skënderbeut në Fushë Torviollit kundër Ali Pashës më 29 qershor 1444, Betejën e Varnës të 10 nëntorit të atij viti, Betejën e Mokrës të 10 tetorit 1445, Betejën e Otonetës të 27 shtatorit 1445 si dhe luftën kundër Venedikut dhe Betejën e Drinit kundër DanielJuriçit të 23 korrikut 1448.<sup>6</sup>Por humbja e Beratit në vitin 1450 ishte një goditje e rëndë për Skënderbeun. Prandaj ai u drejtua aleancave të ndryshme. Atë vit Sulltan Murati i II erdhi personalisht

<sup>5</sup> AdamYamey: *FromAlbania to Sicily*. LuluPressInc., 2014, S. 146.

<sup>6</sup> “Historia e Skënderbeut (Mbretit të Shqipërisë) 1412-1468, Boston 1921 faqe 231.

në Shqipëri dhe në krye të 150 mijë ushtarëve dhe komandantëve osmanë rrethoi Kalanë e Krujës. Lufta vazhdoi disa muaj. Megjithëse osmanët humbën gjysmën e ushtrisë dhe vetë Skënderbeu vrau komandantin e saj Firuz Pashën, gjendja ishte shumë serioze.

Për t'i shpëtuar invazionit osman Skënderbeu iu lut venedikasve që të hynin në luftë për mposhtjen e ushtrisë së Sulltanit, madje duke u ofruar vetë kryeqendrën e tij, Krujën. Por venedikasit refuzuan të angazhohen në një luftë te drejtpërdrejtë me Perandorinë Osmane. Shkak ishte fakti se Venediku nuk mund të vinte në rrezik marrëdhëniet e mira tregtare me këtë perandori. Në këto kushte Skënderbeu u përpoq të gjejë aleatë të tjerë përtej Adriatikut. dhe iu drejtua për këtë Mbretit të Napolit, Alfonsit të Aaragonës. Mbreti napolitan ndjehej i rrezikuar nga një pushtim i mundshëm i Perandorisë Osmane, prandaj u tregua i gatshëm që ta ndihmojë Skënderbeun në luftën e tij të pabarabartë me një ushtri shumë herë më të madhe sesa ushtria e princit shqiptar. Skënderbeu vërtet i fitoi betejat e shumta e të pabarabarta kundër ushtrisë osmane, por nga ana tjetër ushtria e tij u dobësua në maksimum dhe ai e shihte të pamundur një qëndresë afatgjatë pa ndihmën e shteteve të tjera kristiane.

Për këto arsye Gjergj Kastrioti nënshkroi më 26 mars 1451 në emër të Lidhjes Shqiptare të Lezhës një marrëveshje politike me Mbretin e Napolit, Alfons I. Në emrin e tij dhe të Lidhjes Skënderbeu e shpalli Mbretin e Napolit si Zot të Lartë dhe u deklarua si vasal i Alfonsit, duke respektuar autoritetin e Mbretit të Napolit dhe u shpreh i gatshëm që këtij të fundit t'i paguajë një taksë (tribut). Në këmbim të kësaj Mbreti Alfons I do t'i jepte Skënderbeut dhe ushtrisë së tij si dhe Lidhjes së Lezhës municione, trupa ushtarake, para dhe rezerva ushqimore me qëllim që të mbështesë dhe ta mbrojë kryengritjen anti-osmane të shqiptarëve. Mbreti Alfons I ishte i detyruar sipas marrëveshjes që të mbrojë çdo qytet, i cili rrezikohet nga pushtimi osman, nëse këto qytete kishin nevojë për ndihmë ushtarake. Në momentin kur territori shqiptar do të konsiderohej i liruar plotësisht nga invazioni osman, në këtë moment duhej që Skënderbeu të fillonte të paguante taksën për Mbretërinë e Napolit dhe do ta njihnte Mbretin Alfons I si mbret të shqiptarëve. Por Mbreti i Napolit ishte i detyruar të njihnte autonominë dhe vetëadministrimin e territoreve shqiptare nga princërit vendas.<sup>7</sup>

Marrëdhëniet dhe interesat e mbretërive italiane nga njëra anë dhe principatave shqiptare në anën tjetër ishin të ndryshme, madje shpesh herë të kundërta. Ndërsa Skënderbeu luftonte kundër Perandorisë Osmane, Venediku nga ana e tij tentoi disa herë të zgjeronte zotërimet e tij në bregdetin lindor

<sup>7</sup> Gennaro Maria Monti: *La spedizione in Puglia di Giorgio Castriota Scanderbeg e i feudi pugliesi suoidellavedova e del figlio* in: *Palaver 4 n.s., Issue 1. Università del Salento, 2015, S. 125 ff. h.*

të Adriatikut dhe ta shtrinte sundimin e tij në qytetet bregdetare ballkanike e shqiptare. Ndërkohë Mbretëria e Napolit ishte e interesuar gjithashtu të shtrinte ndikimin dhe zotërimet e saj në Ballkanin Perëndimor. Për Napolin territoret e principatave shqiptare ishin më të volitshmet. Prandaj dhe Alfonsi I kishte interes që ta dobësonte Venedikun.<sup>8</sup>

Duket qartë se Skënderbeu në marrëveshjen me Mbretin Alfons I shfrytëzoi jo vetëm ankthin e tij se Perandoria Osmane do të kapërcente Adriatikut dhe do ta fshinte nga harta mbretërinë e tij, por edhe ambicien për ta shtri sundimin politik të tij në Shqipëri. Kushtet që Alfonsi I i diktoi Skënderbeut për t'i paguar një taksë të përhershme dhe për ta njohur si Mbret të Krugës, pas largimit përfundimtar të forcave osmane nga territori shqiptar, dëshmojnë për këto ambicie.

Në Shqipëri gjithashtu princat shqiptarë ishin të ndarë në marrëdhënien me shtetet italiane. Dukagjinasit ishin pro Venedikut dhe ndikimit e prezencës së tyre në territorin e principatës së tyre. Pal Dukagjini dhe Lekë Dukagjini, sipas Schmitt iu bashkuan Leka Zaharias në shërbim të qëllimeve venedikase. Lekë Zaharia ishte gjithashtu shtetas i Venedikut.<sup>9</sup>

Ndërkohë Gjergj Kastrioti duket se midis dy të këqijave, pushtimit osman dhe ndikimit politik me varësi në Napoli, zgjodhi këtë të dytën. Historiani i njohur Oliver Jens Schmitt shkruan në librin e tij të botuar më 2009-ën se marrëveshja midis Skënderbeut dhe Alfonsit I ishte një marrëveshje vasaliteti.<sup>10</sup>

Historianët tanë nuk e pranojnë këtë version të trajtimit të këtij dokument. Ndër ta Oliver Jens Schmitt ka shkaktuar shumë reagime edhe me dy trajtesa të tjera për figurën e Skënderbeut, atë të paraqitjes së nënës së Skënderbeut si vajzë e princit serb Brankoviç dhe atë që, sipas Schmitt, Skënderbeu e nisi luftën kundër Sulltanit në shenjë hakmarrje për vrasjen e babait të tij, Gjon Kastriotit si dhe të vëllezërve të Gjergj Kastriotit. Nëse versioni i përkatësisë serbe të origjinës të nënës së Skënderbeut duhet kundërshtuar me fakte dhe jo apriori, versioni i luftës së Skënderbeut për hakmarrje më duket se nuk mbështetet në fakte dhe argumente. Sigurisht që ndjenjat emocionale kanë rol në çdo konflikt dhe kjo nuk përjashtohet as në rastin e luftës së Skënderbeut kundër Sulltanit. Por një luftë 25-vjeçare kurrë nuk mund të shndërrohet në një kauzë dhe mision, dhe kurrë nuk do të çonte nga një fitore te tjetra pa patur një projekt përtej hakmarrjes!

<sup>8</sup> *Oliver Jens Schmitt: Das Venezianische Albanien 1392-1479, R. Oldenbourg Verlag Muenchen, 2001, faqe 301.*

<sup>9</sup> *Oliver Jens Schmitt: Das Venezianische Albanien 1392-1479, R. Oldenbourg Verlag Muenchen, 2001, faqe 300.*

<sup>10</sup> *Oliver Jens Schmitt: Skanderbeg. Der neue Alexander auf dem Balkan. Verlag Friedrich Pustet, Regensburg 2009. S. 44f.*

Por kjo marrëveshje nuk u zbatua. Pas vdekjes së Alfonsit I, vendin e tij e zuri i biri, Ferdinand. Marrëdhëniet e Skënderbeut me Ferdinandin vazhduan si marrëdhënie besnikërie, madje me një kontribut të pa parashikuar në marrëveshje të Skënderbeut në ndihmë të Mbretit të ri të Napolit. Ferdinandi vazhdoi mbas vdekjes së të atit që të dërgojë në ndihmë të Skënderbeut ndihma në para, ushtarë, veshje dhe ushqime.<sup>11</sup>

Në të vërtetë situata kishte ndryshuar. Mbreti Ferdinand nuk kishte aftësitë e të atit dhe shpesh herë dobësia e tij sillte mosbesim. Si rezultat i kësaj dobësie baronët francezë bënë thirrje për kryengritje kundër tij. Kështu Ferdinand u detyrua të largohet nga fronti. Por Papa Piu II i kërkoi Skënderbeut që t'i shkonte në ndihmë dhe ky i fundit dërgoi një kompani me 500 kalorës për t'i ardhur në ndihmë mikut të tij Ferdinand. Në krye të kësaj kompanie ai dërgoi nipin e tij (djalin e motrës).

---

<sup>11</sup> *JannTibbetts: 50 GreatMilitaryLeadersof All Time. AlphaEditions, New Delhi 2016, S. 575 (englisch, Online-Version in derGoogle-Buchsuche [abgerufenam 3. November 2016]).*

## **Bibliografia**

1. Oliver Jens Schmitt: Skanderbeg. Der neue Alexander auf dem Balkan. Verlag Friedrich Pustet, Regensburg 2009.
2. Jann Tibbetts: 50 Great Military Leaders of All Time. Alpha Editions, New Delhi 2016
3. Gennaro Maria Monti: La spedizione in Puglia di Giorgio Castriota Scanderbeg e i feudi pugliesi suoidella vedova e del figlio in: Palaver 4 n.s., Issue 1. Università del Salento, 2015
4. Oliver Jens Schmitt: Das Venezianische Albanien 1392-1479, R. Oldenbourg Verlag Muenchen, 2001
5. Adam Yamey: From Albania to Sicily. Lulu Press Inc., 2014
6. "Historia e Skënderbeut (Mbretit të Shqipërisë) 1412-1468, Boston 1921
7. F.A. Primaldo Coco: Casali Albanesi nel Tarentino. Scuola Tipografica Italo-Orientale "San Nilo", Grottaferrata 1921
8. Andrea Frediani: *I grandi condottieri che hanno cambiato la storia*. Newton Compton editoris.r.l., Rom, 2012.

**Prof. As. Dr. Edmond MALAJ<sup>1</sup>**

## **MONOGRAFIA “SKANDERBEG” E JULIUS PISKOS, NJË STUDIM I VJETËR, POR I PANJOHUR MIRË PËR HISTORIOGRAFINË SHQIPTARE**

### **Disa të dhëna mbi autorin**

Konsujt austro-hungarezë kanë dhë një kontribut të çmuar në fushën e albanologjisë, këtu mund të përmend si shembull Johan Georg von Hahn që mbahet si themeluesi i albanologjisë, apo konsullin Theodor Ippen, që dha kontributin e tij sidomos në arkeologji dhe në historinë mesjetare. Një tjetër konsull austriak që dha kontribut në albanologji ishte edhe Julius Pisko.

Në fillim ja vlen të jepen disa informacione për Julius Piskon. Në fakt Pisko nuk ishte vetëm një diplomat por edhe një albanolog, i cili ka dhënë kontributin e tij në dy fusha, në fushën e historisë dhe në atë të gjuhësisë. Të gjesh të dhëna biografike të tjera mbi jetën e Piskos është e vështirë. Veprimtaria e tij diplomatike në shërbim të Perandorisë Austro-hungareze është më mirë e dokumentuar.<sup>2</sup> Ai u lindur në Vjenë, më 3. 2. 1863. Ai ka qenë zëvendëskonsull i Konsullatës së Përgjithshme Austro-Hungareze në Janinë dhe më vonë edhe konsull në Shkup. Pisko ka qenë një diplomat karriere dhe ka ushtruar veprimtarinë e tij në shumë

---

<sup>1</sup> Instituti i Historisë; Akademia e Studimeve Albanologjike

<sup>2</sup> Një veprimtari të detajuar të tij po japim më poshtë: Praktikant për shërbimet konsullore për Monarkinë Austro-Hungareze 1885; me shërbim në Konsullatën e Beogradit 1885-1886, me shërbim në qeverinë vendore të Bosnjë-Hercegovinës 1886-1887; Shërbim në Konsullatën e përgjithshme Austro-Hungareze në Shkodër 1887-1888; në Konsullatën e Kievit 1888-1889, në Konsullatën e përgjithshme të Aleksandrisë 1889; në Konsullatën e përgjithshme të Shkodrës 1889; gjerent në nënkonsullatën e Prizrenit 1891-1892; drejtues i konsullatës së përgjithshme në Janinë 1892-1896; drejtues në Konsullatën e Shkupit 1896-1897; gjerent në Konsullatën e Përgjithshme në Selanik; gjerent i vazhdueshëm në Konsullatën e përgjithshme në Shangai 1899-1901, i dërguar më 1. 10. 1902 deri më 20. 8. 1903 si raportues politik-ekonomik i dy ministrive të tregtisë me anijen “Zenta”; Gjerent apo drejtues i Konsullatës së Përgjithshme në Rio de Zhaneiro 1904-1906; drejtues i Konsullatës së Përgjithshme në Liverpul 1907-19012; në Marsejë 1912-1914. Nga data 27. 7. 2014 në pension. Të dhënat e marra nga: Rudolf Agstner, *“Die Hitze hier ist wieder kolossal...”*. *Des Kaisers Diplomaten und Konsuln auf Reisen und Reiseschlidungen* 1808-1918. Wien/Berlin: LIT 2014, f. 279.

vende të botës. Atë e gjejmë edhe si konsull në Shangai<sup>3</sup> dhe në vitet në 1903-04 si K. u. K. Konsull në Amerikën Jugore<sup>4</sup> (Argjentinë dhe Brazil<sup>5</sup>). Emri i tij del shpesh edhe nëpër raportet<sup>6</sup> që ai bën sidomos për Ministrinë e Tregtisë së Perandorisë Austro-Hungareze<sup>7</sup>, por edhe nëpër raportet shumë sekrete që ai dërgon edhe në lidhje me Kultus-Protectoratin austriak për katolikët në trojet shqiptare gjatë periudhës së fundit të pushtimit osman.<sup>8</sup> Më tepër në lidhje me jetën e tij, d.m.th. në lidhje me vitet e tij të formimit shkollor dhe të studimit, nuk mundëm të mësojmë. Ai vdiq në Vjenë më 13. 3. 1926.

Përsa i përket hulumtimeve të tij në fushën e Albanologjisë, përveç Studimit mbi Historinë e Skënderbeut<sup>9</sup> ai ka hartuar edhe një libër mbi gramatikën shqipe të dialektit të veriut me titull “*Doracak i shpejtë i gjuhës shqipe veriore*” (*Kurzgefasstes Handbuch der Nordalbanesischen Sprache 1896*)<sup>10</sup>. Pra Pisko ka qenë një studiues që mesa duket e ka njohur mirë gjuhën shqipe, ka jetuar në një mjedis shqiptar, në Janinë dhe në Shkup, por edhe në veri, si në Shkodër dhe në Prizren dhe është marrë edhe me studimin e historisë së kombit tonë dukë u përqendruar në Historinë e Skënderbeut, dhe si rrjedhim del se është një nga albanologët austriakë që ka pasur njohuri të konsiderueshme mbi historinë, gjuhën dhe kulturën e kombit tonë.

<sup>3</sup> Kurt Gostentschnigg, *Wissenschaft im Spannungsfeld von Politik und Militär: Die österreichisch-ungarische Albanologie 1867-1918*. Wiesbaden: Springer 2018, f. 349.

<sup>4</sup> Rudolf Agstner, *Von Kaisern, Konsuln und Kaufleuten: Die k.(u.)k. Konsulate in Arabien, Lateinamerika, Lettland, London und Serbien*. Band 2. Wien/Berlin: LIT 2012, f. 128.

<sup>5</sup> Më 1. 3. 1904 Pisko bëhet gjerent (tip drejtuesi ?) në Konsullatën austro-hungarese të Rio de Zhaneros. Shih: Rudolf Agstner, *Handbuch des k. (u.) k. Konsulardienstes*. Die Konsulate der Donaumonarchie vom 18. Jh. bis 1918. Aus dem Nachlass herausgegeben vom Bundesministerium für Europa, Integration und Äußeres in Zusammenarbeit mit Gerhard Gonsa. Wien: new academic press 2018, f. 51.

<sup>6</sup> Julius Pisko, *Berichte des commerciellen Fachberichterstatters des k. k. Handelsministeriums Julius Pisko, k. und k. Consul*. (Vertraulich). III. Theil. (Schluss). Wien: Kaiserl.-Königl. Hof- u. Staatsdruckerei 1903.

<sup>7</sup> Shih edhe: Julius Pisko, *Die Südhalbkugel in Weltverkehr – Reise als handelspolitischer Fachreferent des k.k. österr. u. k. ung. Handelsministeriums*, Wien 1904.

<sup>8</sup> Engelbert Deutsch, *Das k.(u.)k. Kultusprotectorat im albanischen Siedlungsgebiet in seinem kulturellen, politischen und wirtschaftlichen Umfeld*. Wien, Köln, Weimar: Böhlau 2009, f. 285, 540.

<sup>9</sup> Julius Pisko, *Skanderbeg, Historische Studie*. Wien: Frick 1894.

<sup>10</sup> Julius Pisko, *Kurzgefasstes Handbuch der Nordalbanesischen Sprache*. Wien: Alfred Hölder, 1896.

## Monografia “Skanderbeg”

Tani përsa i përket monografisë, kjo vepër e tij mban vitin e botimit 1894 dhe titulli i saj është i thjeshtë “*Skënderbeu. Një studim historik*” (*Skanderbeg. Eine historische Studie*). Sipas Fan Nolit, Pisko është i pari nga historianët gjermanofonë që shkroi një biografi të detajuar për Skënderbeun.<sup>11</sup> Ky pohim i Nolit është shumë i saktë, nëse e krahasojmë me disa monografi të tjera studimore për Skënderbeut që u botuan në sidomos në gjysmën e parë të shekullit të XIX, në veçanti në kuadër të filhelenizmit gjerman, që u bë shumë aktiv sidomos gjatë periudhës 1821-1829 që janë vitet kryengritjeve të popullit grek për pavarësi e çlirim nga zgjedha osmane.

Në studimin e tij mbi Skënderbeun Pisko ju referua qoftë studimeve dhe veprave që ishin shkruar deri në atë kohë qoftë burimeve arkivore, që të kishte pasur në dispozicion, por që mesa duket nuk ka qenë shumë i kënaqur në lidhje sasinë e tyre. Për këtë ai shkruan vetë si më poshtë:

“Në shkrimin e këtij libri që keni përpara për fat të keq nuk kam pasur në dispozicion të gjithë atë material që do të ishte i domosdoshëm, për të përcaktuar me saktësi të plotë marrëdhëniet jashtëzakonisht të ndërlikuara që kanë pasur ndërmjet njëri-tjetrit fisnikët shqiptar me pushtet në shekullin XV. Si rrjedhojë mund të jetë e mundur që unë në mirëbesim të kem thënë supozime apo përfundime që mund të gjinden tashmë edhe në vepra të tjera, të cilat nuk i njoh akoma: lutem që të ma falin këtë gjë dashamirësisht”<sup>12</sup>

Një kontribut të rëndësishëm për krijimin e kësaj vepre ka dhënë edhe etërit jezuitë në Shkodër që vunë në dispozicion të autorit, qoftë punime të vjetra, qoftë burime dokumentare që filluan ti mbledhin në arkivin e tyre dhe këto e ndihmuan Piskon që të korrigjonte shumë nga pasaktësitë e bëra nëpër biografitë e Skënderbeut.<sup>13</sup>

Vepra ka 162 faqe dhe përbëhet nga 18 kapituj që janë të numëruar me shkronja romake dhe pa tituj. Në fund të veprës, autorit ju duk e rëndësishme që të vendoste edhe dy shtojca të cilat përbëhen nga disa dokumente të rëndësishme, ndonjë letër e Skënderbeut dhe pjesë nga studime të ndryshme që kanë një rëndësi të veçantë për historinë e Skënderbeut.<sup>14</sup> Këto fragmente dhe materiale dokumentare janë në gjuhën latine dhe italiane mesjetare dhe përbëjnë edhe sot akoma material të çmueshëm qoftë për historinë e Skënderbeut qoftë për atë

<sup>11</sup> Fan Stilian Noli, *Gjergj Kastrioti Skënderbeu (1405-1468)*. Prej Peshkop Fan Stilian Nolit, Doktor i Shkencave Filozofike. Tiranë: “Naim Frashëri” 1967, f. 192.

<sup>12</sup> J. Pisko, *Skanderbeg*, f. 4. (Pasazhi i përkthyer nga origjinali nga Edmond Malaj)

<sup>13</sup> J. Pisko, *Skanderbeg*, f. 4.

<sup>14</sup> J. Pisko, *Skanderbeg*, f. 133-162.



mesjetare. Fragmentet janë marrë nga veprat e Du Canges (*Historia Byzantina*), Farlatit (*Illyricum Sacrum*), Rainaldit (*Annales Ecclesiasticae*) dhe përbëhen kryesisht nga letra të ndryshme dhe raporte që kanë të bëjnë me Skënderbeun dhe aktivitetin e tij. Këto materiale tashmë njihen nga studiuesit shqiptarë, pasi janë të cituara nëpër shumë punime dhe janë të përkthyer pjesërisht.

I një rëndësie të veçantë është këtua materiali i nxjerrë nga vepra lartpërmendur e Carl du Fresne domino Ducange “Historia Bizantine” (*Historia Byzantina*)<sup>15</sup>, i cili përbëhet nga të dhëna historike dhe biografike rreth familjeve më të rëndësishme fisnike të Mesjetës së vonë dhe të periudhës së Skënderbeut, që nga zanafillat e dokumentuara e këtyre familjeve. Këtua, të nxjerra nga *Historia Byzantina* radhiten njëra pas tjetrës familjet Kastrioti<sup>16</sup>, Komneni<sup>17</sup>, Dukagjini<sup>18</sup>, Zernojeviqi<sup>19</sup> dhe Shpani<sup>20</sup>. Ky material është në shtojcën e parë të punimit të Piskos<sup>21</sup>, kurse shtojca e dytë përmban letra dhe raporte mbi Skënderbeun, ku ndër të tjera mund të përmendim letërkëmbimin e ndërmjet Skënderbeut dhe mbretit hungarez Vladislavi III<sup>22</sup> që autori e ka nxjerrë nga *Illyricum Sacrum* të Daniele Farlatit<sup>23</sup>. Ndërsa dokumentet




Fig. 1: Frontespici i veprës Skanderbeg të Piskos

<sup>15</sup> *Historia Byzantina duplici Commentario illustrata. Prior Familias ac Stemmata imperatorum Constantinopolitarum, cum corundem Augustorum Nomismatibus, & aliquod Iconibus; Præterea Familias Dalmaticas & Turcicas complectitur: Alter Descriptionem Urbis Constantinopolitanæ qualis extitit sub Imperatoribus Christianis. Auctore Carolo Du Fresne Domino Du Cange, Regi a Consiliis, Francæ pud ambianos Questore. Venetiis, Ex Typographiæ Bartolomæi Javarina M. DCC. XXIX.*

<sup>16</sup> *Historia Byzantina*, f. 270-271.

<sup>17</sup> Po aty, f. 162.

<sup>18</sup> Po aty, f. 140.

<sup>19</sup> Po aty, f. 268-269.

<sup>20</sup> Po aty, f. 271.

<sup>21</sup> J. Pisko, *Skanderbeg*, f. 115-129.

<sup>22</sup> Po aty, f. 134-137.

<sup>23</sup> *Illyrici Sacri. Tomus Septimus, Ecclesia Diocletiana, Antibarensis, Dyrrhachiensis et*

e tjera janë nxjerrë nga arkiva dhe biblioteka të ndryshme edhe këtu bie në sy veçanërisht Arkivi i qytetit të Milanos.<sup>24</sup> Në përgjithësi autori ndjek një anën e çmitizimit të figurës së Skënderbeut dhe përpiqet të japë fakte të sakta në lidhje me figurën e tij.

Për shembull: Në vepër, përsa i përket pengmarrjes së Skënderbeut, Pisko thotë që: “Shumë autorë më të hershëm shkruajnë, që Gjon Kastrioti ia kishte dorëzuar peng bijtë e tij sulltan Muratit II. Por meqenëse si kohë nënshtrimit Gjon Kastriotit ndaj sundimit osman mbahet viti 1413, këtu bie në sy një anakronizëm, sepse në atë vit sundonte akoma sultan Mehmeti I. Biemmi vë re në mënyrë të qartë, që meqenëse Skënderbeu shkoj në Kostandinopojë në moshën nëntë vjeç pra në vitin 1413, kjo duhet të ketë ndodhur në periudhën e sulltan Mehmetit I. Sipas të dhënave të tjera, Gjon Kastrioti duhet di ketë dërguar bijtë e tij për në Adrianopojë në vitin 1410, pas një lufte të pafat ndaj Evrenos Pashës.”<sup>25</sup> Me këtë Pisko edhe pse vë re pasaktësitë e shumta të autorëve të ndryshëm, prapë se prapë, beson një të dhënë të gabuar duke iu referuar Biemmit, ngaqë e çon Skënderbeun në Kostandinopojë në moshën nëntë vjeç dhe thotë që vëllezërit e tij u vranë nga Sulltan Murati, gjë që nuk është e saktë.<sup>26</sup> Përveç kësaj ka edhe pasaktësi të tjera, për shembull kur flet në lidhje me pushtimet e qyteteve. Ai e vendos pushtimin e Drishtit më 3 gusht 1477,<sup>27</sup> në fakt pushtimi i këtij qyteti ka ndodhur 1 shtator të vitit 1478.<sup>28</sup> Por nga ana tjetër, dhe këtë e përmend edhe Noli, i cili thotë që Pisko qe i pari që zbuloi datën e humbjes së madhe në Berat (1455).<sup>29</sup>

Interesant është edhe fjalimi që Skënderbeu mbajti në Lezhë përpara princave të mbledhur. Pisko e cilëson këtë fjalim si një dëshmi të qartë të zgjuarsisë së Skënderbeut si burrë shteti dhe si një orator i shkëlqyer, dhe për këtë arsye këtë fjalim po e japim më poshtë, në një mënyrë të përafërt sipas versionit që na ka sjellë sipas “Anonimi” të Biemmit:

---

*Sirmiensis, cum eorum suffraganeis.* Auctore Daniele Farlato, Presbytero Societatis Jesu, et Jacobo Coletto olim ejusdem Societatis alumno. Venetiis, MDCCCXVII. Aput Sebastianum Coleti. Superiorem permissu ac privilegio, f. 417. (Letërkëmbime të tjera midis Skënderbeut dhe papëve dhe të personave të tjerë shih: Po aty, f. 418-423).

<sup>24</sup> J. Pisko, *Skanderbeg*, f. 138-162.

<sup>25</sup> Po aty, f. 8, ref. 6.

<sup>26</sup> Po aty, f. 21.

<sup>27</sup> Po aty, f. 20, ref.

<sup>28</sup> Edmond Malaj, *Drishti. Historia dhe fizionomia e një qyteti mesjetar shqiptar*. Tiranë: Qendra e Studimeve Albanologjike 2015, f. 109.

<sup>29</sup> J. Pisko, *Skanderbeg*, f. 68.

*“Me siguri që është e tepërt që unë Juve, o Princa të shkëlqyer, t’ju rrëfej urrejtjen që kanë turqit ndaj besimtarëve të Zotit Tonë Jezus Krisht. Shumë plagë me të cilat është i mbuluar i gjithë krishterimi dhe vetë Arbëria, e dëshmojnë këtë mjaftueshëm. Edhe Ju, Princa të Arbërisë, e keni marrë vesh tashmë, që armiqtë tanë duan të pasurohen me pronat tona dhe duan të na shfarosin. Më lejoni në fillim të shpjegoj shkaqet e fatit të keq të deritanishëm, me qëllim që ne pastaj të këshillohemi për një zgjidhje efikase.*

*Me lot gjaku po i vajtojnë popujt e krishterë mosbashkimin e princave të tyre, sepse vetëm këta të fundit e kanë vetë fajin e mjerimit të përgjithshëm. Thërrasin qiellin si dëshmitar, që fuqia otomane do të mund të thyhej me forca të bashkuara.*

*Por unë nuk dua të ndalem tek fati i trishtë i princave të huaj, se vetë vëllezërit e mi janë vrarë në mënyrë të turpshme. Prandaj më lejoni të tregoj, se përse edhe vetë shtëpia ime u shkatërrua në mënyrë të mjerueshme.*

*Babai im, shoku Juaj, u sulmua nga sulltani turk me ushtri të shumta e të përgatitura mirë për luftë. Të fuqishmit në afërsi kishin qenë tashmë të detyruar të nënshtroheshin nga fuqia superiore. Askush nuk mund ti ndihmonte, dhe kështu ai që i detyruar të dorëzohej me kushte, të cilat ishin të barabarta me rënien e shtëpisë së tij. Ai vdiq, bijtë e tij u vranë, vetëm unë kam mbetur gjallë, se kështu e deshë Qielli, dhe shpresoj që Ai do të më lejoj që të marr hak për këto krime.*

*Babai im ra viktimë e mosbashkimit të princave shqiptar; unë po parashikoj edhe sot akoma të njëjtin fat edhe për mbretërinë time. Por edhe Ju, njësoj si unë, ndodheni tashmë buzë greminës! E ç’a mendoni Ji? Se turku po menduaka vallë vetëm për shkatërrimin tim dhe po përgatitet për luftë vetëm kundër meje? O Ju Trima! A nuk po i parandieni rreziqet e papara që po ju kërcënohen? E megjithatë sa me lehtësi do të kishit mundësi, që ngazëllimi juaj i fitores të jehojë shumë shpejt!*

*Planet dhe përpjekjet e turkut synojnë shkatërrimin e të gjithë neve, prej te i pari deri te i fundit. Nëse ai nuk do te mendonte kështu, nuk do të ishte më turk. Ligjet e tij, zakonet e tij, karakteri i tij, para së gjithash vullneti i profetit të tij Muhamed, e nxisin atë për të shkatërruar gjithçka që mban emrin e Krishtit.*

*Me sytë e shpirtit unë po shoh Muratin midis vezirëve, ndihmësve dhe nënshtetasve, duke nxjerrë shkumë nga goja prej zemërimit dhe hakmarrjes. Ai falënderon profetin e tij, që unë i kam dhënë shkas për të pushtuar Arbërinë, si shpërblim për humbjet që ai pësoi nga Hungaria dhe Serbia. Tani ai po u jep urdhra oficerëve të tij për të më asgjësuar dhe pas meje për të drejtuar armët kundër të gjithë princave të tjerë shqiptar; Ju të gjithë ai dëshiron t’ju shohë para vetes në vargonj!*

*Këto janë planet dhe përpjekjet e turkut; më besoni, besoni në përvojat e mija, në njohuritë e mia në lidhje me atë oborr dhe me zakonet e tij. Mendoni për ngjarjet e tmerrshme të kohërave të sotme dhe të kaluara.*

*Këto fjalë, o princa, që po duhet t'jua them juve janë shumë serioze, se vetëm unë i ngjas atij mjekut që i shpjegon të sëmurit rreziqet e vuajtjeve të tij, me qëllim që ky të vendosë për të bërë operacionin. – Vetëm të bashkuar ne mund të rezistojmë, dhe këtë bashkim e dëshiron vetë Zoti. Ju e vini re të Hungaria, Zibenbyrgeni, Bullgaria dhe Serbia, që më parë veç e veç ju nënshtruan turkut të gjithë me radhë. Por kur para një viti u bashkuan të gjithë princat e tyre, Qielli i bekoi armët e tyre, dhe kështu ata korrën fitoren e shkëlqyer, fitoren e Krishterimit!*

*Pra këtë shembull të mrekullueshëm ju e keni para vetes. Oh! Le të shkojmë pra dorë për dorë dhe mbrojtja hyjnore ka për të qenë e sigurt për ne!*

*A besoni ju se turku do të kishte nënshtruar Arbërinë në kohën e atit tim, nëse princat do të ishin bashkuar? Përçarja e atëhershme ka qenë shkaku i vetëm, që vendi ynë i bukur ra viktimë e pushtimit otoman. Na ndihmoftë pra për fitore bashkimi dhe harmonia midis jush, me qëllim që të triumfojmë njësoj si hungarezët mbi armikun e tmerrshëm.*

*Forcat e Arbërisë i ngjajnë përrenjve të vegjël që rrjedhin nga drejtime të ndryshme. Dhe kur këta bashkohen në një shtrat të vetëm, formojnë një lum të madh e të fuqishëm. Kjo rrethanë ngjall tek unë një besim të gëzueshëm dhe shpresën, për ta lidhë fitoren e lavdishme në armët arbërore, për ti dëshmuar kështu Krishterimit të Evropës vlerën e tyre. Unë vetë që kam jetuar për tridhjetë vjet në atë oborr dhe që njoh armët e tyre, mënyrën e tyre të luftimit, ushtritë e tyre, lejohem me të drejtë të shpresoj, se mund të dalim tani me sukses kundër tyre. Dhe kur unë si prijës ushtarak i tyre kam mposhtur armiqtë e tyre në shumë luftëra të përgjakshme, si mund të mos dal tani fitimtar, kur po mbroj atdheun tim, të mirën e shokëve të mi, të cilët më kanë besuar jetën, gjakun dhe pronat e tyre?*

*Mos u frikësoni nga thashethemet boshe në lidhje me fuqinë e armiqve tanë; para pak muajsh ata u goditën në kokë nga Huniadi dhe bërthama e trupave të tyre u asgjësua. Ajo çfarë ka mbetur ende tek ata, nuk është asgjë tjetër përveçse një grumbull njerëzish të këqij, frikacakë dhe barbarë, pa rregull e pa përvojë. Unë më tej po ju përmendi edhe një herë betejën më të fundit të zhvilluar në Moravë, ku Huniadi me një ushtri fare të vogël e bëri copash ushtrinë turke jashtëzakonisht në numër. Perëndia nuk pyet për numrin e armiqve, kur don tua japë fitoren besimtarëve të Vet. Më besoni, edhe sot turku i ka varur shpresat tek përçarja jonë, përndryshe ai as që guxon të na sulmojë, por edhe po guxoftë, kjo ka për ti kushtuar atij me siguri shumë shtrenjtë.*

*Ju e shihni pra, o princa te mençur, që shpëtimi ynë varet nga vetë ne. Nëse ne rrimë e shohim duarlidhur rënien e fqinjit tonë, nëse ne rrimë e presim porsiqingja të shtrirë, pa bërë asgjë, do të jemi të gjithë pre e ujkut. Nga ajo çfarë do bëjmë sot marrëveshje varet fati i Arbërisë. Unë ju shpjegova Juve në detaje rrezikun e përgjithshëm dhe mjetet për mënjanimin e tij; dhe vetëm prej Jush varet përmbushja e planeve të menduara mire nga unë; nëse ju i pranoni ato, Arbëria do të shpëtojë dhe brezat e ardhshëm do të luten me mirënjohje për shpirtin Tuaj.*

*Kështu shpresoj që Zoti i Gjithëfuqishëm, ti këshillojë për mirë princat e Arbërisë dhe vendostë në zemrat e tyre shpirtin e bashkimit, shpirtin e rezistencës kundër armikut të përbashkët!”<sup>30</sup>*

Këto pra ishin fjalët e Skënderbeut në Kuvendin e Lezhës, të cilat Biemmi ia vë atij në gojë dhe që Pisko i sjellë edhe në punimin e tij, për të nxjerrë në pah aspekte të figurës dhe të karakterit të heroit.

Datën e vdekjes së Skënderbeut Pisko çuditërisht e jep gabim. Në vend që të ishte viti 1468 ai vendos vitin 1467. Ja si e përshkruan Pisko vdekjen e Skënderbeut: “Para se ti mblidhte të gjithë pjesëtarët e ftuar në këtë këshill, e kapi atë një edhe e fortë dhe e gjithë shpresa për ta mbajtur në jetë u zhduk, dhe më 17 janar 1467 u nda nga jeta e lavdishme princi shqiptar që kishte mbrojtur për 24 vite me radhë me një sukses të pashembullt kombin e tij kundër forcave shumë të mëdha otomane.”<sup>31</sup>

Punimi i Piskos pati edhe kritikë. Sipas Nolit, një shkencëtar rumun Konstatin Marinesku<sup>32</sup> (Constantin Marinescu) e kishte quajtur me pa të drejtë punimin e Piskos një monografi gjysmë e plotë<sup>33</sup> megjithatë Noli është i mendimit që Marinesku është i saktë kur thotë që Pisko nuk tregon se disa dokumente që janë në shtojcë janë marrë nga vëllimet me dokumente “*Monumenta Historica Slavorum*”<sup>34</sup> të studiuesit rus Vikentnij Vasilijev Makushev, dhe kjo, thotë Noli më tej mund të ketë ndodhur për arsye politike, ngaqë Pisko ishte konsull

<sup>30</sup> Po aty, f. 21-23. (E përkthyer nga gjermanishtja nga Edmond Malaj.)

<sup>31</sup> Po aty, f. 108-109. (E përkthyer nga gjermanishtja nga Edmond Malaj.)

<sup>32</sup> Konstatin Marinesku është marrë vetë me historinë e Skënderbeut, në kuadër të marrëdhënieve të tij me Alfonsin e Napolit dhe ka shkruan në vitin 1923 një monografi me titull: Constantin Marinescu, *Alphonse V, Roi d' Aragon et de Naples, et l' Albanie de Scanderbeg, Paris, Qaraber, 1923. (Melanges de l' Ecole Roumaine en France. 8vo. [no.] 1)*

<sup>33</sup> F. Noli, *Skënderbeu*, f. 192.

<sup>34</sup> Vikentnij Vasilijev Makushev, *Monumenta Historica Slavorum Meridionalium Vicinorumque Populorum*. In Zwei Bänden. Band 1. Warschau: Učebnyj Okrug (Der Lernkreis) 1874; Band 2. Belgrad: Druckerei der serbischen Königlichen Regierung 1882. Zitiert aus: Po aty, f. 297.

*austriak.<sup>35</sup> Kjo mund të jetë, sipas Nolit e vetmi shkak përse Pisko nuk e përmend emrin e Makushevit as edhe në bibliografi, sepse nga ana tjetër Pisko jep të gjitha burimet dhe autorët e tjerë.<sup>36</sup> Me gjithë gabimet që mund të ketë, sepse gabime të shumta kanë edhe historianët modernë në lidhje me historinë e Skënderbeut, vepra ia vlen që të lexohet dhe të konsultohet dhe të citohet.*

## Përfundime

Si përfundim mund të thuhet që studimi i Piskos për historinë e Skënderbeut është një nga monografite më të rëndësishmet historiografisë gjermane, pas asaj të Oliver Jens Schmittit. Ajo qëndron shumë më lart se monografite e tjera mbi Skënderbeun, të cilat u botuan sidomos gjatë shekullit XIX. Krahas aftësive ushtarake dhe strategjike të Skënderbeut, autori Pisko e paraqet atë si burrë shteti me zgjuarsi të madhe dhe si një orator i shkëlqyer. Pisko thotë në hyrje të veprës së tij këto fjalë për Skënderbeun:

“Duket e pabesueshme që një burrë, i cili nën urdhrat e tij kurrë nuk pati më shumë se disa mijë luftëtarë të pastërvitur për luftë, u bëri rezistencë duke korrë fitore 24 vite me radhë ushtrive turke që ishin dhjetë a pesëmbëdhjetë herë më të mëdha në numër se ushtria e tij. E gjithë Evropa dridhet nga avancimi i pandalur fitimtar i kalifëve otoman, edhe në një qoshe të largët të botës thyhen të gjitha përpjekjet e atyre që përndryshe ishin të pathyeshëm, para vullnetit të hekurt të një burri, i cili vetëm me një vështrim i shndërron ushtarët e tij në heronj. Talenti i shkëlqyeshëm strategjik, gojëtaria e tij rrëmbyese, e gjithë magjepsja që dilte nga personaliteti i tij e vendosin atë me dinjitet përkrah heronjve më të rëndësishëm të të gjitha kohërave.”<sup>37</sup>

Në vepër ka edhe shumë të dhëna të tjera në lidhje me marrëdhëniet e Skënderbeut me sundimtarët e tjerë bashkëkohës. Kjo monografi synon që të japë një histori të plotë të heroit tonë kombëtar, duke u bazuar në punime më të hershme dhe në të dhëna dokumentare. Për këtë qëllim unë personalisht kam ndërmarrë përkthimin e kësaj vepre, e cila do të botohet nga Akademia e Studimeve Albanologjike dhe do të dalë në publik së shpejti, në kuadër të 550-vjetorit të vdekjes së heroit tonë kombëtar.

<sup>35</sup> F. Noli, *Skënderbeu*, f. 192.

<sup>36</sup> Po aty, f. 193; J. Pisko: *Skanderbeg*, f. 4-5.

<sup>37</sup> J. Pisko, *Skanderbeg*, f. 4-5. (pasazhi i përkthyer nga Edmond Malaj)

## Conclusions

Finally, I can say that Piskos' study of Skanderbeg's history is one of the most important monographs of German historiography, after that of Oliver Jens Schmitt. It stands far above the other monographs on Skanderbeg, which were published especially during the XIX century. In addition to Skanderbeg's military and strategic abilities, author Pisko presents him as a statesman with great wisdom and as an excellent speaker. Pisko says at the introduction of his work these words to Skanderbeg:

“It seems unbelievable that a man who never had more than a few thousand untrained warriors under his command had resisted the Turkish army, by winning victories 24 years long, against armies that were fifteen times larger in number than his army. The whole of Europe was shaken by the victorious advancements of the Ottoman caliphs. So in a distant corner of the world, breaks all the efforts of those to the will of a man who, with only one look, turns his soldiers to heroes. The brilliant strategic talent, its captivating vocal, all the fascination that emerged from his personality put him with dignity alongside the most important heroes of all time.”<sup>38</sup>

In this work, there are also many other details about Skanderbeg's relationship with other contemporary rulers. This monograph aims to give a complete history of our national hero, based on earlier works and documentary evidence. To this end, I have undertaken the translation of this work, which will be published by the Academy of Albanian Studies on the occasion of the 550<sup>th</sup> anniversary of the death of our national hero.

---

<sup>38</sup> J. Pisko, *Skanderbeg*, f. 4-5. (pasazhi i përkthyer nga Edmond Malaj)

## Lista e literaturës

- Agstner, Rudolf, *Des Kaisers Diplomaten und Konsuln auf Reisen und Reiseschlitterungen 1808-1918*. Wien/Berlin: LIT 2014, f. 128, 279.
- Agstner, Rudolf, *Handbuch des k. (u.) k. Konsulardienstes*. Die Konsulate der Donaumonarchie vom 18. Jh. bis 1918. Aus dem Nachlass herausgegeben vom Bundesministerium für Europa, Integration und Äußeres in Zusammenarbeit mit Gerhard Gonsa. Wien: new academic press 2018, f. 51.
- Deutsch, Engelbert, *Das k.(u.)k. Kultusprotektorat im albanischen Siedlungsgebiet in seinem kulturellen, politischen und wirtschaftlichen Umfeld*. Wien, Köln, Weimar: Böhlau 2009, f. 285, 540.
- Gostentschnigg, Kurt, *Wissenschaft im Spannungsfeld von Politik und Militär: Die österreichisch-ungarische Albanologie 1867-1918*. Wiesbaden: Springer 2018, f. 349.
- *Historia Byzantina duplici Commentario illustrata*. Prior Familias ac Stemmata imperatorum Constantinopolitarum, cum corundem Augustorum Nomismatibus, & aliquod Iconibus; Præterea Familias Dalmaticas & Turcicas complectitur: Alter Descriptionem Urbis Constantinopolitanæ qualis extitit sub Imperatoribus Christianis. Auctore Carolo Du Fresne Domino Du Cange, Regi a Consiliis, Françæ pud ambianos Questore. Venetiis, Ex Typographiæ Bartolomæi Javarina M. DCC. XXIX.
- *Illyrici Sacri. Tomus Septimus, Ecclesia Diocletiana, Antibarensis, Dyrrhachiensis et Sirmiensis, cum eorum suffraganeis*. Auctore Daniele Farlato, Presbytero Societatis Jesu, et Jacobo Coletto olim ejusdem Societatis alumno. Venetiis, MDCCCXVII. Aput Sebastianum Coleti. Superiorem permissu ac privilegio, f. 417. (Letërkëmbime të tjera midis Skënderbeut dhe papëve dhe të personave të tjerë shih: Po aty, f. 418-423)
- Makushev, Vikentnij Vasilijev, *Monumenta Historica Slavorum Meridionalium Vicinorumque Populorum*. In Zwei Bänden. Band 1. Warschau: Učebnyj Okrug (Der Lernkreis) 1874; Band 2. Belgrad: Druckerei der serbischen Königlichen Regierung 1882.
- Malaj, Edmond, *Drishti. Historia dhe fizionomia e një qyteti mesjetar shqiptar*. Tiranë: Qendra e Studimeve Albanologjike 2015, f. 109.
- Noli, Fan Stilian, *Gjergj Kastrioti Skënderbeu (1405-1468)*. Prej Peshkop Fan Stilian Nolit, Doktor i Shkencave Filozofike. Tiranë: “Naim Frashëri” 1967, f. 192.
- Pisko, Julius, *Berichte des commerciellen Fachberichterstatters des k. k. Handelsministeriums Julius Pisko, k. und k. Consul. (Vertraulich). III.*



Theil. (Schluss). Wien: Kaiserl.-Königl. Hof- u. Staatsdruckerei 1903.

- Pisko, Julius, *Kurzgefasstes Handbuch der Nordalbanesischen Sprache*. Wien: Alfred Hölder 1896.
- Pisko, Julius, *Skanderbeg, Historische Studie*. Wien: Frick 1894.

## Abstrakt

Julius Pisko ka qenë zëvendëskonsull i Konsullatës së Përgjithshme Austro-Hungareze në Janinë dhe përveç Studimit mbi Historinë e Skënderbeut ai ka hartuar edhe një libër mbi gramatikën shqipe të dialektit të veriut me titull “Doracak i shkurtër i gjuhës shqipe veriore” (*Kurzgefasstes Handbuch der Nordalbanesischen Sprache 1896*).

Monografia e Julius Piskos mban vitin e botimit 1894 dhe titulli i saj është i thjeshtë “*Skënderbeu. Një studim historik.*” (*Skanderbeg. Eine historische Studie*). Ajo vlerësohet nga Noli si biografia e parë e detajuar dhe shkencore për Skënderbeun, e shkruar nga historianët gjermanofonë. Në studimin e tij mbi Skënderbeun Pisko iu referua qoftë studimeve dhe veprave që ishin shkruar deri në atë kohë, qoftë burimeve arkivore, që kishte në dispozicion. Në fund të veprës, atij ju duk e rëndësishme që të vendoste edhe dy shtojca të cilat përbëhen nga disa dokumente të rëndësishme, ndonjë letër e Skënderbeut dhe pjesë nga studime të ndryshme që kanë një rëndësi të veçantë për historinë e Skënderbeut.

Këto fragmente dhe materiale dokumentare janë në gjuhën latine dhe italiane mesjetare dhe përbëjnë edhe sot akoma material të çmueshëm qoftë për historinë e Skënderbeut, qoftë për atë mesjetare. Edhe pse kjo monografi është mjaft e vlerësuar, ajo është pothuajse krejt e panjohur për lexuesin dhe studiuesin shqipfolës, pasi është botuar në vitin e largët 1894 dhe gjendet me vështirësi. Këtyre vështirësive u shtohet edhe ajo gjuhësore, pasi gjuha gjermane që përdor Pisko kërkon një nivel të lartë njohjeje nga lexuesi i huaj. Në kumtesën time do të përpiqem që të nxjerr në pah vlerat e kësaj vepre, por edhe disa nga mangësitë e saj.

**Prof.as. Dr. Lavdosh AHMETAJ**

## **TRAKTATI I GAETËS DHE VASALITETI I SKËNDERBEUT**

**(26 mars 1451)**

**(në trajtimet historiografike)**

### **Abstrakt**

Kongresi i Mantovës konfirmoi se anjë nga fuqitë katolike nuk ishte gatshme që të përfshihej në një përballje ushtarake anti-osmane, sepse shpirti i kryqëzatave kristiane ishte shuar në Europën Perëndimore.

Në një situatë të tillë, Alfonsi i Aragonës, për shkak të ambicieve për shtrirje influencë në lindje të pellgut të Mesdheut, shfaqet si sovrani evropian me fuqi ushtarake dhe politike të mjaftueshme për të rivalizuar Portën e Lartë në kontrollin e Ballkanit.

Mesdheu kryqëzonte interesa të rëndësishme tregtare ndërkontinentale. Përfitimet e mëdha të Republikës së Shën Markut, të siguruara pas Kryqëzatës së Katërt, kishin krijuar palë kundërshtarë, si Gjenerali, të cilat, për hir të këtyre interesave, ishin bërë aleate me Perandorinë Bizantine kundër Republikës tregtare të Venedikut. Ndërkohë, politika e Mehmetit në Mesdhe mbetej ekspansioniste dhe konsoliduese.

Në këtë kontekst gjeopolitik, interesi i Skënderbeut, i spikatur tashmë diplomatikisht, konvergjon me strategjinë e Alfonsit të Aragonës. Të dy gjejnë të përbashkët interesin për konsolidimin e shtetit të vet dhe pozicionimit të tij si faktor gjeopolitik, duke konkluduar natyrshëm në arritjen e një traktati.

Ky traktat, që shpreh edhe diplomacinë racionale të Skënderbeut, u formalizuar më 26 mars 1451 në Gaeta. Marrëdhënia u zgjerua me një aleancë midis Alfonsit dhe Skënderbeut, e cila kishte në bazë një gjëndje vasaliteti të shqiptarëve. Në Krujë u vendos një garnizon katalanas dhe ky qytet u bë seli e një mëkëmbësi aragonas të quajtur Ramon de Ortafa

Lidhur me këtë traktat dhe rrjedhojat e tij, mendimi i historianeve ndahet në dy pikëpamje. Pikepamja e parë e sheh Traktatin e Gaetës si një formalizim të vasalitetit de facto' të Skënderbeut ndaj Alfonsit. Pikepamja e dytë, përmes

logjikës anglo-saksone, e cila gërsheton në arsyetim aktin formal dhe kontekstin historik-politik-juridik të kohës, e sheh Skënderbeun në pozicionin e sovranit në zbatim të këtij traktati.

Ky studim e sheh Traktatin e Gaetës nën dritën e gërshetimit të historiografisë me trajtimin juridik. Në këtë përjasje, ai nuk shkëputet nga konteksti historik i kohës, në të cilën Skënderbeu vlerësoi faktorët sipas rëndësisë së tyre në përcaktimin e fateve të shtetit arbëror.

**Fjalë kyçe:** sovranitet, vasalitet, shtet, politike, historiografi, traktat, gjeopolitikë, ekspansion, atribut, haraç, pragmatik,

Vendosja e Skënderbeut në epiqëndër të vëmëndjes politike europiane dhe, në veçanti, të vet Papa Piut të II ka qene motivuar nga disa faktorë.

Nder ta, me i rëndësishmi ishte pozicionimi gjeografik i Arbërisë, qe e bënte ate te lakmuar për interesat gjepolitike të Europës kristiane. Nga ana tjetër, prirja e Skënderbeut per të formuar një shtet funksional i shkonte per shtat politikës globale duke u bere kështu bje tjetër faktor per te merituar vëmendjen e vecante te kësaj politike. Por, ambiciet politike të Skënderbeut ndiheshin të realizuara ne Europen katolike. Vizioni i tij shkonte drejt nje bashkimi të kombeve në një aleance të përbashkët ushtarake dhe politike në funksion të dëbimit të ushtrisë osman nga Arberia dhe gjithë kontinenti europian. Ky vizion ishte nje faktor tjetër qe e sillte Skenderbeun ne vëmendje te politikës europiane, e cila ndihej gjithashtu e kërcënuar, sidomos kulturalisht.

Këtyre faktorëve duhet t'ju shtojmë talentin prej lideri vizionar e strategjik, si dhe guximin e spikatur te Gjergj Kastriotit në betejat e organizuara ndaj ushtrisë turke, cilësi këto qe kishin merituar vëmendjen dhe interesin e vecante te vet Papes. Te gjithë këta faktorë, te marre sebashku, e vendosin shtetin e Skënderbeut, Arberine, në pozicion strategjik në hapësirën gjepolitike ballkaniko-mesdhetare.

Koncepti i bashkimit europian kishte kohë që ishte ravijezuar dhe idea e një beteje të përbashkët u hodh në kongresin e Mantovës në vitin 1459. Ajo i adresohet të gjitha monarkive europiane që kërcënoheshin direkt dhe indirekt nga invazioni ushtarak osman.

Kongresi i Mantovës<sup>1</sup> konkludoi se asnjë nga fuqitë katolike e veçuar nuk ishte e gatshme të përballlej me ushtrinë osmane. Kjo edhe për faktin se shpirti i Kryqëzatave ishte zvetënuar disi në Europën Perëndimore<sup>2</sup>.

Ndërkohe, lëvizjet e politikave në dy anët e pellgut të mesdheur dëshmonin

<sup>1</sup> - Gjon Keka, **Roli politik dhe ushtarak i shtetit të Skënderbeut**, Tiranë 2015, f. 86

<sup>2</sup> - At Giuzeppe Valentini, **Skënderbeu dhe Papati 1442-1467**, Tiranë 2013, f. 16

fuqizimin e Alfonsit të Aragonës, i cili po shfaqej më i interesuar për tu shtrirë në lindje të pellgut të Mesdheut. Alfonsi rezultonte një nga sovranët europian më të fuqishëm që mund t'i përgjigjej ambicieve politike dhe strategjike të liderit të ri të Arberise, që tashme kishte shfaqur ambicie për tu aleancuar me strategjinë Europiane<sup>3</sup>.

Nderkohe, Republika e Venedikut, pas ezaurimit të kryqëzatave, kishte arritur kontrollin e Mesdheut. Kjo i kishte sjellë asaj përfitime të mëdha, duke u bere kështu shkak për daljen në pah të kundërshtarëve, ndër të cilët mund të përmendim Republikën e Gjenevës. Kjo e fundit, për kete arsye, kishte bërë aleancë më Shtetin e Bizantit, i cili ishte kundër Republikës së Venedikut për shkak të natyrës tregëtare të kësaj të fundit.<sup>4</sup> Me ane tjetër, kemi osmanin Mehmet, i cili kishte shpalosur një politikë ekspansioniste për të konsoliduar influencën në Ballkan dhe në ishujt e Egjeut dhe Jonian.

Ky raport forcash ushtarake dhe shtetërore u studjua me kujdes nga Skënderbeu, i cili e gjen me vend t'i përgjigjet pozitivisht kërkeses së Alfonsit të Aragonës për të shtypur kryengritjet e shpërthyer nga Capitanata dhe në Kalabri, të cilat nxiteshin dhe frymëzoheshin nga Anzhuinët<sup>5</sup>. Në vitin 1450, Alfonsi dërgon në Shqipëri 800.000 babune me grurë si ndihme për luftën e Skënderbeut kundër Turqisë.<sup>6</sup> Angazhimi i politikës ndihmuese të Alfonsit vazhdon përmes marrjes përsipër të një borxhi që Skënderbeu kishte kontraktuar “me zotërinjtë raguzianë për të përballuar shpenzimet e luftës”<sup>7</sup>

Ky raport, sa politik po aq dhe gjeopolitik, bëhet më interesant për vëmendjen historike nëse i referohemi studjuesit Franc Pall, i cili thekson se i biri i sulltan Muratit, Mehmeti II, kishte një plan të gjerë pushtimesh, mes të cilave Shqipëria kishte një përparësi në dukje më të pakët<sup>8</sup>.

<sup>3</sup> - Ferdinand Schevill, **Ballkani**, Tiranë 2002, f. 170

<sup>4</sup> - Shiko, vep, cit. Schevill, Ballkani, Tiranë 2002, f. 173

<sup>5</sup> - Po aty.

U dërgua Demetrio Reres, që të kontribuoi me efikasitet për të rivendosur rendin, ndërsa dy djemtë e tij Gjergji (Georgio) dhe Bazili ishin në Sicili, në Kështjellën e Missirit, për të bërë roje kundër inkursioneve të mundshme të Anzhuinëve. Dihet se pikërisht në këtë epokë filloi themelimi i fshatrave të ndryshme shqiptare në Italinë jugore dhe në Sicili. Në vitin 1449, Alfonsi ia shpërbleu ndihmën e dhënë duke i dërguar 1200 burra dhe ushqime Skënderbeut, i cili ishte impenjuar në rimarrjen e fortesës së Sfetigradit. (At Giuseppe Valentini, **Skënderbeu dhe Papati** 1442-1467, Tiranë 2013, f. 16

<sup>6</sup> - Shiko, vep, cit. Valentini, **Skënderbeu dhe Papati** 1442-1467, Tiranë 2013, f. 19

<sup>7</sup> - Shiko, vep, cit. **Skënderbeu dhe Papati** 1442-1467, Tiranë 2001, f. 19

<sup>8</sup> - Sipas Franc Pall: Skanderbeg et Janco de Hunedoara (Janosh Huniadi), Deuxieme conference des etudes albanologiques, fq. 87-104, Tiranë 1968; dhe A. Gegaj: L'Albanie et l'invasion turque au XV-e siecle, Louvain 1937. (Murati i II përpykjet e tij më të mëdha i kishte rezervuar përtej

Ishte kjo situatë, e cila karakterizohej nga një qetësi relative, prej së cilës përfiton Skënderbeu duke hedhur një hap të qartë politik përmes martesës së tij me Andronikë Aranitin, bijën e Gjergjit<sup>9</sup>. Kjo beri të mundur një aleancë thelbësore për zgjerimin e territorit politik. Njëherazi me kete hap, ai rindërtoi fortesën në Dibër, ku vendin e Sfetigradit e zë kështjella e re e Modrisës, e ndërtuar pikërisht në këtë periudhë<sup>10</sup>.

Por Skënderbeu ishte në kërkim të një aleati dhe protektori të besueshëm, të cilin jo pa qëllim e kërkonte në Perëndimit europian, edhe pse ishte përballur me refuzimin e përsëritur venedikas. Dhe, mesa duket, fati behet me Skënderbeun, sepse në 3 shkurt të vitit 1451 vdes Sulltan Murati i II. Kjo ishte një kohë e pershtateshme për të avancuar në bisedimet me sovranin e Aragonës, pasi ishte shlyer moralisht dhe politikisht me Republikës së Venedikut, për të marrë Krujën nën mbrojtje<sup>11</sup>.

Kështu Skënderbeu në mesin e marsit 1451, nisi një dërgatë klerikësh nga Kruja për në Napoli, për të hartuar bashkëpunimin në fushën ushtarake dhe administrative me sovranin më të fuqishëm të gjithë pellgut të Mesdheut. Barleti tregon se, Alfonsi afroi një sasi të konsiderueshme ndihmash financiare, duke shtuar dhe 300 mijë shinikë gruri dhe elbi, sepse kishte marrë vesh që të mbjellat ishin penguar nga lufta me Turqinë. Ai dërgoi edhe shumë mjeshtra, me para të vetat, me qëllim që të rindërtonin muret e Krujës.<sup>12</sup>

Kjo aleancë u formalizua juridikisht më 26 mars 1451 duke u quajtur si Traktati i Gaetës. Me anë të këtij traktati, princi shqiptar njihte autoritetin e lartë të Alfonsit dhe ky i fundit, ne shkëmbim, premtonte ta mbështeste ushtarakisht dhe financiarisht në luftën kundër turqve, si dhe të dërgonte menjëherë një kontigjent trupash për të ndihmuar në mbrojtjen e Krujës si kryeqëndër shtetërore e Arbërisë. Kjo aleancë ishte në koherencë me ato marrëdhënje të ravijëzuara që nga viti 1447-1448. Rrjedhojë logjike të këtyre interesave sa pragmatiste po aq edhe strategjike ishte që Gjergj Kastrioti, në emrin e vet dhe një koalicioni të zotërinjve shqiptarë, në mënyrë të hapur, vuri Krujën nën mbrojtjen e Alfonsit<sup>13</sup>.

Në letërn e Alfonsit të V, drejtuar Papës më 25 mars 1451, tregohet për ndihmat që ishte duke i përgatitur për t'i dërguar në Krujë, 200 këmbësorë dhe një

---

ballkanit, kundrejt objektivave të tjera, si marrja e Kostandinopojës (1453), pushtimi i Serbisë (duke nisur nga viti 1454), rrethimi i Beogradit (1456)

<sup>9</sup> - Shiki, vep, cit. Pall, Skanderbeg et Janco de Hunedora (Janosh Huniadi) Deuxieme conference des etudes albanologiques, fq. 87-104, Tiranë 1968;

<sup>10</sup> - Po aty

<sup>11</sup> - Shiko, vep, cit. Historia e popullit shqiptar, Tiranë 2012, f. 407 "Konflikti me Venedikun"

<sup>12</sup> - Marin Barleti, Skënderbeu, Tiranë 1976, f. 284

<sup>13</sup> - Shiko, vep, cit. Francesco Pall, **Barlezio**, fq. 91 dhe G.M. Monti, vepër e cituar, fq. 278-279

sasi ushqimesh, për të plotësuar kështu lutjen “me lot në sy për ndihmë e përkrahje kundër turqve, të dërguarve të Skënderbeut i përndershmi At Stefani, episkop i Krujës, dhe rregullatori mjeshtër i Urdhërit Dominikan, frat Nikollë Berguci.

Letra i lutej e dhe Papës që të angazhohej edhe ai në ndihmën ndaj Skënderbeut.<sup>14</sup>

Ajo që na intereson thelbësisht, është e lidhur natyrën e raporteve politike dhe juridike të Skënderbeut me Alfonsin e V. Ajo që spikat juridikisht është e lidhur me klauzolën përkatëse, e cila theksonte se mbasi ai, “Madhëria” (Alfonsi), të jepte ndihmën dhe ta nxirrte Skënderbeun nga duartë e turqve, “Zoti Gjergj i sipërthënë do të vijë vetë të këmbët e Madhërisë dhe do të bëjë betimin dhe homazhin e besnikërisë e të vasalitetit, si akt juridik, i takon perspektivës”<sup>15</sup>. Kjo marrëveshje kushtëzohej nga zhvillimet e luftës kundër Turqisë dhe, pasi të dëboheshin turqit nga trevat e Kastriotit, “ai zoti Gjergj dhe farë e fis tij do të japin dhe do të paguajnë Madhërisë së sipërthënë (Alfonsit V) tributin ose haraçin që tani janë të detyruar t’ia japin Turkut të Madh, në atë kohë dhe në atë mënyrë si ia paguajnë Turkut të përmëndur”<sup>16</sup>. Në këtë traktat theksohet një haraç i përcaktuar prej 6000 dukatësh, i evidencuar edhe në kërkesën që Skënderbeu i kishte orfruar Shën Markut gjishtë muaj më parë. Kjo ofertë ka të bëjë me kohën kur Kruja ishte ende në rrethim nga Turqia<sup>17</sup>.

Kjo gjë ka qënë objekt diskutimesh mes historianëve duke u përpjekur të sqarojnë dy çështje: së pari, a kishte paguar vet Skënderbeu ndonjë haraç kundrejt Aragonës dhe, së dyti, nëse i pagoi ai ndonjë haraç Turqisë<sup>18</sup>.

Duke u perfshire në kete debat e duke u munduar të gjejmë të vertetën, po fokusohemi në një arsytim midis paragrafëve të Traktatit të Gaetës.

Aty, Madhëria e sipërthënë (Alfonsi i V), mbasi të marrë vendin e thënë (zotërimet e Skënderbeut), premtan se do të mbajë të gjitha privilegjet e Krujës e të gjithë arbërve, sikurse kanë bërë të gjithë mbretërit e Shqipërisë. Dhe do të njohë e do të mbajë të gjitha privilegjet e përmendura për të gjithë zotërinjtë”<sup>19</sup>.

Pra, jemi në kohën që qyteti i Krujës po kalonte në protektorin e një tjetër

<sup>14</sup> - Burime të zgjedhura, dok nr. 202 (J. Radonic, Gjuradaj Kastriot, 37)

<sup>15</sup> - Burime të zgjedhura, dok nr. 202 (J. Radonic, Gjuradaj Kastriot, 37)

<sup>16</sup> - Burime të zgjedhura, dok nr. 202 (J. Radonic, Gjuradaj Kastriot, 37)

<sup>17</sup> - Historia e popullit shqiptar, Tiranë 2002, f. 413-415. (A.SH.SH. Instituti i Historisë) “Kruja e rrethuar 1450”

<sup>18</sup> - Haraci si institucion juridik, nuk është i lidhur me personalitetin politik dhe ushtrak të Skënderbeut. Haraci është i lidhur me statusin juridik autonom të qytetit të Krujës, të cilën duhej ta respektonte si Alfonsi i V ashu edhe vasali Skënderbe. (Vep, cit. Kule, Kryqëtari i Fundit, Tiranë 2012, f. 169)

<sup>19</sup> - Burime të zgjedhura II, dokumenti nr. 203 (F.N, Skandërbeg 1947, shtonjca, nr. 11)

fuqie shtetërore, në këtë rast një sovran perëndimor. Kështu, në bazë të normave juridike të kohës,<sup>20</sup> duket se edhe vet Skëndebeu, por edhe Alfonsi i V, nuk mund të quheshin nga pikpamja juridike “Zotër të Krujës” në rast se nuk ishin në gjëndje në plotësonin kushtet juridike të njohjes së privilegjeve të administratës. Në këtë kontekst sa juridik por edhe administrativ, jemi përballë një marrëdhënje e përbërë prej dy nocionesh juridike autonomi/haraç<sup>21</sup>. Ky raport, nuk është i lidhur vetëm me qytetin e Krujës, por ka një histori të paktën tre shekullore që funksion në qytetet kryesorë të Europës perëndimore, duke mos përjashtuar edhe Krujën.<sup>22</sup>

Gjithashtu, duhet parë edhe ana tjetër e politikës së qytetit të Krujës, Durrësit dhe Petrelës, të cilat kanë qënë nën zotërimin e Topiajve duke filluar nga shekulli i XIII dhe, për pasojë, kanë pasur marrëdhënje preferenciale me Republikën e Venedikut. Kjo ka bërë të mundur që në qytet te kishte edhe një frymë tjetër, e cila ka lidhje me varësinë ndaj tregëtarëve të Venedikut, por duke qene me shume se tregëtare, pse jo edhe politike.

Fakti që Venediku e kishte refuzuar vasalitetin që i kishte afruar Skënderbeu më 24 nëntor 1450, shpjegon njëherash se influenza venedikase ishte pa ndikim të konsiderueshëm në Krujë.

Ndërsa çështjen e zotit të ligjshëm të Krujës, Muzakë Topisë,<sup>23</sup> Skënderbeu e kishte ezauruar përmes martesës së motrës së tij me Muzakë Topinë, të cilin disa vjen më parë e kishte ndarë nga e gruaja e tij, Zanfira, për t’i dhënë për grua të motrën. Ky mekanizëm kishte bërë të mundur te quante “fis” njërin prej “baronëve” palë të Traktatit të Gaetës, i cili konfirmonte juridikisht “... Gjergj Kastriotin, zot i qytetit të lartpërmëndur të Krujës dhe farë-e-fis të tij, baron në Shqipëri”.<sup>24</sup>

Është e qarte se dokumenti i Gaetës duhet vështruar si një garanci institucionale midis Alfonsit dhe Skënderbeut dhe, pas politikës së Alfonsit,

<sup>20</sup> - Normat Juridike Feudale qytet fe--Aurela Anastasi, Historia e institucioneve, Tiranë 2005

<sup>21</sup> - Historia e qeteteve shqiptare të bazuara në vetqeverisje, është e lidhur të paktën që nga viti 1153 nga Perandoria Bizantine, Emanuel Komneni, nëpërmejt një diplome të posacme. Ndërsa 100 vjet më pas, këto privilegje u rikonfirmuan nga perandori i Nikesë, Johan Duka Vataces, dhe më 1255 nga i biri i tij, Theodoros Laskaris. Është interesante se këtë rregull juridik e kishte pasuar edhe perandori bizantin Androniku i II Paleologu, I cili e konfirmon kwttw, duke lëshuar një diplomë me vulë të artë, kurse Car Stefan Dushani diplomën e tij për njohjen e privilegjeve e lëshoi në vitin 1343. Ndërsa, në vitin 1451, të njëjtin veprim juridik e kreu edhe Alfonsi i V. (L.A)

<sup>22</sup> - Shiko, vep, cit. Aurela Anastasi, **Historia e institucioneve**, Tiranë 2005

<sup>23</sup> - Qyteti i Krujës ka qënë që në fillim te shekullit të XIII nën zotërimin e Topiajve (Shiko, vep, cit. Kule, Kryqwtari I fundit, Tiranw 2012, f. 169)

<sup>24</sup> - Kjo është një gjetje e formës ose e formulës së Traktatit të Gaetës i mbajtur më 26 mars 1451 (L.A)



duhet parë politika e Papës, e cila kishte synime të qarta për ruajtjen e kulturës dhe qytetërimin kristian<sup>25</sup>.

Traktati përmban një lloj deklarimi vasaliteti të nënshkruar nga Skanderbegu në emër edhe të një koalicioni “baronësh” shqiptarë, dhe dispononte kushtet e një aksioni të përbashkët në funksion të mbrojtjes së asaj zone nevralgjike ballkanike që deri më atëherë princi, me angazhimin e tij kurajoz ushtarak, kishte arritur të shmangte që të bëhej pre e Turqisë. Sipas traktatit, në Krujë do të ishte prezent një administrator aragonez i shoqëruar nga një garnizon xhandarmërie, të cilët kishin si mision transformin e administratës dhe sistemit të mbledhjes së taksave. Për më tepër dërgimi i një garnizoni napolitan me qëndrim të përhershëm në Krujë sanksionoi nga pikpamja praktike Traktatin e Gaetës<sup>26</sup>

Kjo marrëveshje vasaliteti midis Skënderbeut dhe Alfonsit të Aragonës, duhet parë edhe në qëndrimin dyfaqësh të Venedikut, zyrtarisht armiqësor ndaj otomanëve, por gjithnjë i gatshëm të bjerë në ujdj me armikun për shpëtimin e trafiqeve të veta detare drejt Lindjes dhe të interesave të veta mbi “sterenë në Itali dhe në bregun dalmat”<sup>27</sup>. Situatat bëheshin edhe më të vështira për Skënderbeun, por sidomos për Alfonsin, i cili ishte në luftë me Republikën e Venedikut.

Skënderbeu nuk e shikonte të arsyeshme të besonte vetëm në ndihmën e qytetit lagunar edhe pse i ishte dhënë qytetaria venedikase<sup>28</sup>. Për më tepër, Republika e Venedikut e kishte refuzuar ofertën e vasalitetit që i ishte propozuar më parë prej Shqiptarit<sup>29</sup>, duke shtyre kështu atë të kapte oportunitetin që synonte Alfonsi.<sup>30</sup>

Ndërhyrja e Alfonsit nuk është aspak e painteres, siç do ta paraqishte edhe humanisti Pontano, që shkruan se “.. mori (Skanderbegu) ndihmën e Alfonsit, at i Ferdinandit, që duke dhënë prova të miqësisë së madhe i dha para dhe një garnizon ushtarak”<sup>31</sup>.

<sup>25</sup> - Sipas Franc Pall: **Skanderbeg et Janco de Hunedoara** (Janosh Huniadi), Deuxieme conference des etudes albanologiques, fq. 87-104, Tiranë 1968; dhe A. Gegaj: *L’Albanie et l’invasion turque au XV-e siecle*, Louvain 1937.)

<sup>26</sup> - Po aty

<sup>27</sup> - Shiko, vep, cit, punimi Giuseppe Schiro: **Albanesi e questione balkanika**, Npoli 1901

<sup>28</sup> - Shiko, vep, cit, punimi Giuseppe Schiro: **Albanesi e questione balkanika**, Npoli 1901

<sup>29</sup> - Po aty

<sup>30</sup> - Po aty

<sup>31</sup> - Po aty, Por, në një situatë të ngjashme në disa anëpamje me atë në të cilën u gjend Skanderbeu, arriti të gjendet edhe Ferdinandit, i biri i Alfonsit, pas vdekjes së të jatit. Ai gjendet i penguar të ngjitet në fron nga pretendentët anzhuinë. Mundja e rëndë e forcave napolitane në Sarno, në korrik 1460, i dha rast Skanderbegut të kthente borxhin e mirënjohjes që kishte gëzuar prej Alfonsit, duke vënë në dispozicion të Ferdinandit njerëzit e tij dhe vetveten, duke iu drejtuar obligimeve të vasalitetit që e lidhnin me Aragonezët (L.A)

Duhet pranuar se fluksi i përforcimeve vijoi në mënyrë pak të kënaqshme, pasi në vitin 1453 Skënderbeu e mendoj të përshtatshme të shkonte në Napoli për ta nxitur personalisht Alfonsin. Kjo lëvizje skënderbejane diçka arriti të fitonte, pasi Alfonsi u detyrua të jepte një kontribut për ndërtimin e Modrisës dhe të punimeve të tjera fortifikuese, si dhe në vitin 1455 rezultonte i pranishëm në Shqipëri një kontigjent napolitan prej 1000-2000 luftëtarësh<sup>32</sup>. Kjo ishte arsyeja që Skënderbeu u ndje i inkurajuar të merrte iniciativën ushtarake për të ngritur rrethimin e kështjellës së Beratit ku një rol të rëndësishëm kishte kontigjenti napolitan<sup>33</sup>.

Njekohesisht, Skanderbeu, për të vërtetuar funksionimin praktik të Traktatit, dërgoi në Napoli ipeshkvin Andrea, që në këtë rast arriti të merrte nga “Mbreti si dhuratë një veshje me vlerë prej shtatëdhjetedy dukatesh, përveçse njëzetepesë dukate për shpenzimet e kthimit<sup>34</sup>.

Duke iu referuar disa burimeve, të cilat i kemi shfrytëzuar në këtë hulumtim, mund të themi se traktati pati zbatim praktik. Me 31 maj 1451, Bernardo Vakuer, në cilësi të Komisarit të Mbretit të Napolitit, u nis për në Shqipëri, i shoqëruar nga njëqind këmbësorë dhe shumë furnizime, për të marrë në zotërim Krujën dhe kështjellën<sup>35</sup>.

Keto marrëdhënie ndihmuese vazhduan edhe me pas. Në maj të vitit 1453, pas disfatës së përgjakshme të Tilufit dhe të Hamza beut, Alfonsi, me anë të kavalier Raimonod D’Ortofa katalan, i dërgoi Skanderbeut si dhuratë një sasi flamujsh me ngjyrë të ndryshme<sup>36</sup>. Kurse në vitin 1454, për sipërmarrjen e Beratit, Kastrioti i kërkoi ndihma Mbretit Alfons me anë të letrës së dërguar nga Pal Kuçia, Nikollë Eriçi e Gjon Perlati, të cilët, sipas thënies së Sumonte, “përsëritën ofertat për të marrë sovranitetin e Shqipërisë, që kësaj here u mirëpritën me dëshirë<sup>37</sup>. Alfonsi u tregua i gatshëm që menjëherë të niseshin

<sup>32</sup> - Sipas Franc Pall: Skanderbeg et Janco de Hunedoara (Janosh Huniadi), Deuxieme conferenze des etudes albanologiques, fq. 87-104, Tiranë 1968; dhe A. Gegaj: **L’Albanie et l’invasion turque au XV-e siecle**, Louvain 1937.)

<sup>33</sup> - Po aty

<sup>34</sup> - Prof. F. Cerone, **Politika lindore e Alfonsit të Aragonës** (dalin nga Arkivi i Oborrit të Aragonës. (shih dokumenti 2) - Fakti megjithatë është se traktatet për të cilat bëhet fjalë u nënshkruan vërtet, dhe ne besojmë të bëjmë diçka të dobishme, duke i risjellë këtu nga vepra “Politika lindore e Alfonsit të Aragonës” e Prof. F. Cerone, që i bëri të dalin nga Arkivi i Oborrit të Aragonës. (shih dokumenti 2)

<sup>35</sup> - Prof. F. Cerone, **Politika lindore e Alfonsit të Aragonës** (dalin nga Arkivi i Oborrit të Aragonës. (shih dokumenti 2) edhe ai për herë të parë i vënë në dritë nga Cerone, që e transkriptoi nga **Arkivi i Oborrit të Aragonës**.

<sup>36</sup> - Prof. F. Cerone, **Politika lindore e Alfonsit të Aragonës**, (dalin nga Arkivi i Oborrit të Aragonës). (shih dokumenti 2)

<sup>37</sup> - Giuseppe Schiro: **Albanesi e questione balkanika**, Napoli 1901, f. 45

për në Shqipëri ndihmat e kërkuara<sup>38</sup>, në bazë të traktateve të sipër përmendura. Njerëzit e Skënderbeut, të cilët shkuan në Napoli, morën si dhuratë nga Alfonsi “pesë topa rrethimi të kalibrit më të madh të njohur asokohe, trembëdhjetë më të vegjël malorë, me municion përkatës dhe me numër të mjaftueshëm artilierësh, përveçse pajime, shuma të konsiderueshme parash dhe njëmijë këmbësorë, mes tyre arkibukierë dhe balestrierë, nën komandën e të sipërthënit Raimondo D’Ortofa, të cilit i qe dhënë titulli i mëkëmbësit në Shqipëri, me obligimin për t’i dhënë Skanderbegut një pagesë të majme vjetore<sup>39</sup>.

Ndihma jo më të pakta mori Gjergj Arianiti edhe për mbrojtjen e kështjellës së Krepakores<sup>40</sup>. Siç pohon Sumonte, “me këtë furnizime, ajo provincë u vu në gjendje të mirë mbrojtjeje, nën trimërinë e madhe të Skanderbegut, i cili i dha autoritetin Rajmondit të sipërthënë të mund të priste monedha në Krujë”<sup>41</sup>.

Është e rëndësishme të evidencojmë faktin që më 21 korrik 1455 Alberiko Maleta, këshilltar i Francesko Sforca, Dukë i Milanos, i shkruante nga Napoli zotërisë së tij se Mbreti Alfons ankohej dhe fliste mjaft keq për venedikasit, pasi e kishin “mashtuar dhe tradhëtuar dhe e kishin bërë të shpenzonte disa qindra mijëra dukate” dhe pasi përgjatë kësaj kohe ata i kishin “prerë lundrimin e një ngarkese furnizimesh me pajime”, të cilën “ai e dërgonte në Shqipëri në ndihmë të atyre tokave të Tij”<sup>42</sup>.

Më 28 gusht të po atij viti, mbreti i dorëzonte Gjon Katalanit flamuj dhe armë të Aragonës me anë të Xhovani Kiaveros, për t’i çuar në Shqipëri. Kështu, në bazë të dokumenteve të Arkivit historik të Napolit dhe pastaj të nxjerra në dritë në veprën e lëvduar të Cerones, jemi në gjendje të provojmë veç kësaj se, më 14 shkurt 1456, i jepeshin Gjon De Sotio, drejtues i balestrierëve, 208 dukate si pagë e tij dhe për trembëdhjetë balestrierë që militonin në trevat e Shqipërisë, ndërsa më 18 mars, 270 dukate të tjerë ishin paguar Gisberto Rafon, edhe ai drejtues balestrierësh, si pagë e tij dhe e pesëmbëdhjetë mercenarëve “për shërbimin që kryenin në zotërimet mbretërore në tokat e Shqipërisë” me qëllim edhe “për të rezistuar e bërë luftë Turkut të madh”<sup>43</sup>.

<sup>38</sup> - Arianit Topia Moisi Golemi, Gjergj Stresi dhe Gjon Muzaka, bashkëgjakës dy të fundit dhe vjehërr i pari i heroit,

<sup>39</sup> - Giuseppe Schiro: **Albanesi e questione balkanika**, Napoli 1901, f. 45

<sup>40</sup> - **Krepakores**, është një kështjellë, e cila zotërohej nga Arianiti, por ende nuk dihet vendi i kësaj kështjelle (L.A)

<sup>41</sup> - Prof. F. Cerone, **Politika lindore e Alfonsit të Aragonës** (dalin nga Arkivi i Oborrit të Aragonës). (shih dokumenti 2)

<sup>42</sup> - Prof. F. Cerone, **Politika lindore e Alfonsit të Aragonës** (dalin nga Arkivi i Oborrit të Aragonës). (shih dokumenti 2)

<sup>43</sup> - “Ndihma të tjera dërgonte Alfonsi në vitin 1457, dhe që më 22 prill iu dhanw Gjon de

Por, është e natyrshe të pyesim se çfarë ndoshi pas vdekjes së Alfonsit.

Për hir të së vërtetës Skënderbeu shfaqti edhe një herë virtuozeitetin e tij duke dërguar menjëherë në Napoli Tanush Topinë, Vladan Gjuricën dhe Engjëll Muzakën<sup>44</sup> për t'i paraqitur mbretit Ferdinand ngushëllimet e tij dhe, në të njëjtën kohë, për ta uruar për ardhjen e tij në fron. Natyrisht, qëllimi ishte për të konfirmuar dhe ripërforcuar marrëdhënjet që ekzistonin, duke u bazuar, në logjikën e traktatit të famshëm të Gaetës.

Kjo vërtetoi faktin që sistemi i vasalitetit, i ndërtuar me kujdes nga aktorët përkatës, funksionoi edhe mbas vdekjes së Alfonsit dhe mekanizmat juridik të vet Traktatit të Gaetës nuk bëjnë gjë tjetër veçse konfirmojnë natyrën e sistemit të vasalitetit European, i cili u zbatua përgjatë gjithë kohës së sistemit feudal.

Kjo tregon se edhe Arbëria ishte me të njëjtën natyrë politike dhe juridike si gjithë shtetet feudale të Europës perëndimore

Ekspedita e Skenderbeut në Napoli në mbrojtje të Ferdinandit, të birit të Alfonsit, në fakt përbën aktin e fundmë dhe më domethënës të një raporti vasaliteti të vendosur dhe të konsoliduar në kohën e Alfonsit<sup>45</sup>, kur projekti ambicioz i sovranit aragonez synoi të shtrinte ndikimin e vet mbi vargun jonik dhe adriatik deri në pjesën lindore të Mesdheut. Zotërimi i territoreve spanjolle dhe të atyre italiane prej Alfonsit bënin të mundur kontrollin e pellgut perëndimor prej tij. Por dëshira për të ndërtuar një pararojë të fuqishme prej së cilës të lëvizte për t'u shtyrë drejt lindjes dhe për të tentuar të ndërtonte një barrierë të fortë kundër avancimit turk, u puqën gjithashtu me nevojën e Gjergj Kastriotit për të kërkuar një aleat me peshë të përtejdetit, që ta mbronte nga ekspansionizmi i pandalshëm otoman<sup>46</sup>.

Tipologjia e kësaj marrëdhënie të mishëruar në Traktatin e Gaetes, vërtetohet edhe nga shprehja e At Gjergj Guxetes, humanist i shek.XVI, i cili në një letër drejtuar Karlit të III të Burbonëve<sup>47</sup>, duke ju lutur që të marre në mbrojtje fatet e shqiptareve, i sjell në vëmendje “të drejtën që kanë mbretërit e përndritur të Sicilisë mbi Shqipërinë, prej nga mund të titullohen mirë edhe mbretër e despotë, domethënë zotërinj të saj”<sup>48</sup>. Dukën, pra, ende lidhjet e ngushta të trashëguara

---

Agostinos arçierë dhe balestrierë “**en sou et servey de dit senyor Rey, per resistir e fer la guerra al Turch**”, për të shërbyer në zotërimet në Shqipëri”. Shiko, vep, cit. Giuseppe Schiro: **Albanesi e questione balkanika**, Napoli 1901

<sup>44</sup> - Giuseppe Schiro: **Albanesi e questione balkanika**, Napoli 1901!!!!

<sup>45</sup> - Sipas punimit të Giuseppe Schiro: **Albanesi e questione balkanika**, Napoli 1901

<sup>46</sup> - Shiko, vep, cit, punimi Giuseppe Schiro: **Albanesi e questione balkanika**, Napoli 1901

<sup>47</sup> - A. Gegaj: **L'Albanie et l'invasion turque au XV-e siecle**, Louvain 1937. (At Gjergj Guxeta jetoi 1682-1746) është themelues i Seminarit të Palermos dhe i institucioneve të tjera bamirëse në Piana.

<sup>48</sup> - Prof. F. Cerone, **Politika lindore e Alfonsit të Aragonës**, nga Arkivi i Oborrit të Aragonës.

nga Traktati i heroit shqiptar Skenderbeu dhe Oborrit aragonez të Napolit.

Ndërsa fjalët vijuese shprehin edhe më shumë : “Zotëri, ...vij t’iu shpreh falemnderimet e duhura për sa keni dashur me bujari të jepni në mbështetje dhe në përkrahje të Kombit tim Shqiptar. Unë jam një prift i varfër dhe i shkretë, i cili asgjë nuk dëshiron dhe nuk mundet; por ndërkohë vij t’iu ofroj ju Mbretërinë e Shqipërisë. Ja, o zotëri, ky shkrim i imi. Në të mund të lexoni disa dokumente të qarta, nga të cilat nxirret si rrjedhojë se ju iu përket Shqipëria dhe se ju jeni Zot legjitim dhe Sovran i saj”<sup>49</sup>

Si përfundim mund të themi se Traktati i 26 marsit 1451 përmbante një lloj deklarimi vasaliteti të nënshkruar nga Skanderbegu në emër edhe të një koalicioni “baronësh” shqiptarë, duke percaktuar kushtet e një aksioni të përbashkët në funksion të mbrojtjes së atij sektori nevralgjik ballkanik që deri më atëherë princi shqiptar kishte arritur ta shmange që të bëhej prë e turkut. Kjo marrëveshje vasaliteti midis Skënderbeut dhe Alfonsit të Aragonës duhet kuptuar në kontekstin e qëndrimit dyfaqësh të Venedikut.<sup>50</sup>

Situatat bëheshin edhe më të vështira për Skënderbeun, por edhe për Alfonsin, kur lëshimeve të Republikës së Venedikut, do t’i atribuohet në fakt zbarkimi i shpejtë i turqve në Otranto, në Mbretërinë e Napolit, e cila ishte atëhere në luftë me Republikën e Venedikut. Kjo tregonte një lidhje interesash midis Venedikut dhe ushtrisë osmane.

Ishte kjo lëvizje ushtarake që e beri Skënderbeun të mos besonte më në ndihmën e qytetit venedikas, mosbesim ky i materializuar edhe në refuzimet e përsëritura ndaj kërkesave të Skënderbeut.<sup>51</sup> Për rrjedhojë, nevoja për një garnizon napolitan me qëndrim të përhershëm në Krujë sanksionoi nga pikpamja praktike Traktatin e Gaetës<sup>52</sup>

Në një situatë të ngjashme me atë në të cilën u gjend Skënderbeu u gjend edhe Ferdinandi, i biri i Alfonsit, pas vdekjes së të jatit. Ai u pengua të ngjitej në fron nga pretendentët anzhuinë. Disfata e rëndë e forcave napolitane në Sarno, në korrik 1460, i dha rast Skënderbeut të kthente borxhin e mirënjohjes që kishte

---

(shih dokumenti 2) Interesant është fakti që “një dokument i tillë i që paraqitur **Karlit III të Burbonëve**, atëhere kur ky mbret bujar i jepte institucioneve arkiveshkvnore të Palermos, Monrealit dhe Girxhentit, të ardhura të bollshme për edukimin dhe për arsimimin e rinisë shqiptare të Sicilisë, dhe veçanërisht për formimin e priftërinjve kombëtarë, në shërbim të Kolonive dhe për misionet në Dheun-Amë”

<sup>49</sup> - “Politika lindore e Alfonsit të Aragonës” e **Prof. F. Cerone**, që i bëri të dalin nga Arkivi i Oborrit të Aragonës. (shih dokumenti 2)

<sup>50</sup> - Shiko, vep, cit, punimi Giuseppe Schiro: **Albanesi e questione balkanika**, Npoli 1901

<sup>51</sup> - Shiko, vep, cit, punimi Giuseppe Schiro: **Albanesi e questione balkanika**, Npoli 1901

<sup>52</sup> - Po aty

gëzuar prej Alfonsit, duke vënë në dispozicion të Ferdinandit njerëzit e tij dhe vetveten, duke iu drejtuar obligimeve të vasalitetit që e lidhnin me Aragonezët.

Nje arsytim midis paragrafëve të Traktatit të Gaetës, ku Alfonsi premton se mbasi të marrë nën zotërim vendin (zotërimet e Skënderbeut), “do të mbajë të gjitha privilegjet e Krujës e të gjithë arbërve, sikurse kanë bërë të gjithë mbretërit e Shqipërisë...”, duket se qyteti i Krujës po kalonte në protektorin e një tjetër fuqie shtetërore, në këtë rast një sovran perëndimor. Kështu, në bazë të normave juridike të kohës,<sup>53</sup> duket se edhe vet Skëndebeu, por edhe Alfonsi i V, nuk mund të quheshin nga pikpamja juridike “Zotër të Krujës” në rast se nuk ishin në gjëndje në plotësonin kushtet juridike të njohjes së privilegjeve të administratës. Në këtë kontekst sa juridik por edhe administrativ, jemi përballë një marrëdhënje e përbërë prej dy nocionesh juridike autonomi/haraç<sup>54</sup>. Ky raport, nuk është i lidhur vetëm me qytetin e Krujës, por ka një histori të paktën tre shekullore që funksion në qytetet kryesorë të Europës perëndimore, duke mos përjashtuar edhe Krujën.<sup>55</sup>

Fakti që Venediku e kishte refuzuar vasalitetin që i kishte afruar Skënderbeu më 24 nëntor 1450, shpjegon njëherash se influenza venedikase ishte pa ndikim të konsiderueshëm në Krujë.

Duke mos zbehur për asnjë cast rezistencën ushtarake të Skënderbeut, e cila është për t’u vlerësuar maksimalisht nga pikpamja strategjike, duhet te pranojmë se ajo, në pikëpamjen politike, nuk mund të arsyetohet pa u vendosur në kontekstin e vet sistemit politik ku funksiononte praktikisht Europa diplomatike.

## Conclusions

We can say that the Treaty of 26 March 1451 contained a kind of vassal declaration signed by Skanderbeg on behalf of an Albanian “baron” coalition, defining the terms of a joint action in the function of the defense of that Balkan neuralgic sector that until then the Albanian prince had managed to avoid becoming a Turk. This vassal agreement between Skanderbeg and Alfonso of

<sup>53</sup> - Normat Juridike Feudale qytet fe--Aurela Anastasi, Historia e institucioneve, Tiranë 2005

<sup>54</sup> - Historia e qeteteve shqiptare të bazuara në vetqeverisje, është e lidhur të paktën që nga viti 1153 nga Perandoria Bizantine, Emanuel Komneni, nëpërmejt një diplome të posacme. Ndërsa 100 vjet më pas, këto privilegje u rikonfirmuan nga perandori i Nikesë, Johan Duka Vataces, dhe më 1255 nga i biri i tij, Theodoros Laskaris. Është interesante se këtë rregull juridik e kishte pasuar edhe perandori bizantin Androniku i II Paleologu, i cili e konfirmon kwtw, duke lëshuar një diplomë me vulë të artë, kurse Car Stefan Dushani diplomën e tij për njohjen e privilegjeve e lëshoi në vitin 1343. Ndërsa, në vitin 1451, të njëjtin veprim juridik e kreu edhe Alfonsi i V. (L.A)

<sup>55</sup> - Shiko, vep, cit. Aurela Anastasi, **Historia e institucioneve**, Tiranë 2005

Aragon must be understood in the context of the two-sided presence of Venice. The situation became even more difficult for Skanderbeg as well as for Alfons when the Venetian factions in 1480 would be attributed in fact to the rapid deployment of the Turks in Otranto, in the Kingdom of Naples, which was then in war with the Republic of Venice. This showed a link between Venice and the Ottoman army.

It was this military move that made Skanderbeg not to believe in the assistance of the Venetian city, a distrust that materialized even in repeated refusals to Skanderbeg's demands. Consequently, the need for a Neapolitan garrison with a permanent residence in Kruja sanctioned from the practical point of view the Gaeta Treaty.

In a situation similar to that in which Scanderbeg was found, Ferdinand, son of Alfons, was found after the death of his father. He was prevented from ascending to the throne by the Anhui contenders. The severe defeat of the Neapolitan forces in Sarno in July 1460 allowed the Skanderbeg case to redeem the debt of gratitude enjoyed by Alfons by making Ferdinand available to his people and himself, by addressing the obligations of the ironmath that he related to Aragon. An excuse between the paragraphs of the Treaty of Gaeta, where Alfonso promises that after taking possession of the country (the possessions of Skanderbeg), "he will retain all the privileges of Kruja and all the Aries, as did all the kings of Albania ...", It seems that the city of Kruja was passing on to the protector of another state power, in this case a sovereign western. Thus, according to legal norms of the time, it seems that even Skënderbeu himself, but also Alfonso V, could not be called from the juridical point of view "Kruja's lord" in case they were not able to complete the administrative, we are facing a relationship consisting of two legal notions autonomy / tribute.

In this context of legality, this report is not only connected with the city of Kruja but has a history of at least three centuries that functions in the main cities of Western Europe, not excluding Kruja.

The fact that Venetian had rejected the ironworks that Skanderbeg had brought near on November 24, 1450, explains at one time that Venetian influence was without significant influence in Kruja.

Without casting any cast on Skanderbeg's military resistance, which is to be considered topically from a strategic point of view, we must admit that in political terms it can not be justified without being established in the context of the political system where it practically worked Europa.

## Bibliografi

- MONTI G. M., *La spedizione in Puglia di Giorgio Catriota Scanderbeg e i feudi pugliesi suoi, della vedova e del figlio*, në “Japigia”, X (1939), fash. 3.
- PALL F., *I rapporti italo-albanesi intorno alla metà del secolo XV. (Documenti inediti con introduzione e note storico-critiche)*, në “A.S.P.N.”, IV (1965).
- PONTANO G., *De bello Neapolitano*, in *Raccolta di tutti i più rinomati Scrittori dell’Istoria generale del Regno di Napoli*, V, Napoli, Gravier, 1769.,
- SUMMONTE P., *Dell’Historia della Città e Regno di Napoli*, III, Napoli 1675.
- DI COSTANZO A., *Storia del Regno di Napoli*, XX, Napoli 1839.
- NUNZIANTE E., *I primi anni di Ferdinando d’Aragona e l’invasione di Giovanni d’Angiò*, në “A.S.P.N.”, XX (1895).
- PONTIERI E., *Ferrante d’Aragona re di Napoli*, Napoli 1969.
- D’AGOSTINO G., *La capitale ambigua. Napoli dal 1458 al 1580*, Napoli 1979.
- COLAPIETRA R., *La storiografia napoletana del secondo Cinquecento*, në “Belfagor”, 1960.



**Prof.Asoc.Dr. Mois KAMBERI<sup>1</sup>**

## **ILJAZ PASHË DIBRA, KRYETAR I PARË I LIDHJES SHQIPTARE TË PRIZRENI**

### **Abstrakt**

Punimi “Iljaz Pashë Qoku(Dibra), Kryetar i parë Lidhjes Shqiptare të Prizrenit“ është frut i hulumtimeve disavjeçare për këtë figurë në periudhën e rëndësishme të Rilindjes sonë Kombëtare. Që në vitin 1993, në simpoziumin shkencor “ Dibra dhe etnokultura e saj”, kam hedhur për herë të parë mendimet rreth kësaj figure të haruar në tekstet e historisë deri në këtë kohë.

Figura e Iljazë Qokut është një figurë e patrajtuar gjerësisht deri më sot, në raport me rolin dhe aktivitetin e tij patriotik, që ka patur në Dibër dhe në ngjarjet e mëdha të historisë tonë kombëtare. Me qëllimin e mirë për të plotësuar sadopak boshësinë që ka historiografia shqiptare për rolin dhe kontributin e tij në periudhën e Rilindjes Kombëtare, kam trajtuar këtë figurë. Për të përgatitur këtë punim, për të nxjerrë në pah rolin vendimtarë që Iljazi ka luajtur në veprimtarinë e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, kam bërë kërkime intensive për të vjelur gjithçka që është shkruar dhe çdo dokument që ekziston për veprimtarinë patriotike të Iljaz Pashë Qokut në këtë periudhë historike të Dibrës dhe Shqipërisë. Dokumentat arkivorë, kujtimet dhe gjithë burimet që kam shfrytëzuar, më kanë mundësuar njohje të dokumentuar dhe të thellë të ngjarjeve me pjesëmarrje direkte të Iljaz pashë Qokut në Lidhjen Shqiptare të Prizrenit.

Burimi kryesor për përgatitjen e kësaj monografie janë dokumentat arkivore historike vendase dhe të huaja. Për këtë punim janë shfrytëzuar dokumentacioni i Arkivit Qëndror Shtetëror në Tiranë, dokumentacioni i huaj në Arkivin e Institutit të Historisë Tiranë, dokumentacioni i arkivit të Muzeut historik Dibër, arkivi i Bibliotekës Kombëtare Tiranë, fondet krahinore në bibliotekën e qytetit të Peshkopisë, fondet e folklorit vendas, kujtimeve e bashkëkohësve, vëzhgimet e drejtpërdrejta dhe intervistat në terren.

**Fjalë kyçe:** Lidhje Shqiptare, pashë, Rilindje Kombëtare, patriot, krahinë etj.

---

<sup>1</sup> Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës; [moiskamberi@yahoo.com](mailto:moiskamberi@yahoo.com).

## Iljaz pashë Dibra, Kryetar i parë i Lidhjes Shqiptare të Prizreni

Iljaz Qoku ishte nga Dibra e Sipërme. Iljaz pashë Dibra(Qoku), siç e quanin dibranët, lindi në Kllobçisht të Dibrës më 1812,<sup>2</sup> në një familje zejtarësh të vegjël. Nga fshati Kllobçisht familja e tij u vendos në qytetin e Dibrës së Madhe në lagjen e Bajram Begut. Nuk mund të lihet pa theksuar se në rritjen dhe formimin e Iljaz Pashë Dibrës si personalitet i nderuar dhe i respektuar, si një atdhetarë dhe patriotët më në zë të krahinës dhe të vendit, pa dyshim, ndikoi dhe mjedisi ku u rrit. Traditat e mira dhe të pasura të Dibrës dhe të familjes ku u rrit ai, lanë gjurmë të thella në jetën dhe veprimtarinë e tij atdhetare.<sup>3</sup>

Megjithatë si armik i Tanzimatit, ai vazhdoi të gëzonte simpatinë në masën e malësorëve dibranë. Ishin pikërisht këto lëvizje dhe veprimtaria e tij e shquar që i dhanë mundësinë Iljazë pashë Qoku të krijonte lidhje miqësore me personalitete të shquara të viseve të tjera shqiptare.

Pasi u kthye nga internimi Iljaz Qoku, zejtari i mëparshëm iu përvesh tregtisë, në të cilën, sipas njoftimeve që na jep J.G.Hahni, i cili e ka takuar personalisht, pati fat të merte informacionet e duhura për Dibrën. Në fillim u kap pas tregtisë së kripës, një tregti plot rreziqe, për shkak të pasigurisë së rrugëve, e cila, megjithatë i solli ati dy përfitime:

- i dha mundësi të grumbullonte një kapital monetar të konsiderueshëm dhe
- e dyta e lidhi ekonomikisht me malësorët, duke ua shpënë kripën aq të nevojshme për ta dhe bagëtitë e tyre në fshat.

Me kaptalet e grumbulluara, ai kaloi pastaj në operacione të mëdha financiare, deri sa u bë sipërmarrësi i taksave shtetërore në trevën dibrane.

Gjatë viteve 30-70 të shek.XIX, për të mos lejuar zbatimin e reformave të Tanzimatit, Dibra qe pjesëmarrëse në një varg kryengritjesh antiosmane jo vetëm për të mbrojtur trevat e saj, por edhe për të ndihmuar krahinat e tjera shqiptare për të mos lejuar zbatimin e reformave.

Gjatë kësaj periudhe në Dibër u zhvilluan rreth 13 kryengritje kundër pashallarëve osmanë. Qëndresë të organizuar kundër pashallarëve osmanë bënë dibranët në vitin 1844 kundër Hajredin Pashës, në vitin 1855 kundër Vezirit Hysni Pasha, në vitin 1860 kundër Abdi Pashës, në vitin 1872 kundër Demir Pashës e deri në betejat e vitit 1875 që shënonin dhe fundin e luftrave të popullit shqiptar kundër reformave të Tanzimatit

Një veteran i këtyre luftrave të armatosura që kishin zhvilluar shqiptarët gjatë dhjetëvjeçarëve të kaluar kundër tendencave Tanzimatiste të Stambollit

<sup>2</sup> Stërmilli Haki, “Dibra në prag të historisë”, Tiranë 1940.

<sup>3</sup> Xoxe. Koli, Xhelili Qazim, “Iljaz Pashë Dibra(Qoku)”, Kryetar i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit., Revista “Univers”, Horizonte Shqiptare, Tiranë 2005, f.147-155.

dhe kundër synimeve grabiqare të shteteve fqinjë ishte Iljaz pashë Qoku. Më 1838 Iljaz Qoku me djemtë dibranë kundërshtoi me armë përpjekjet e Portës së Lartë për të vendosur administratën e centralizuar në zonën e Dibrës. Dera e madhe e Qokëve kishte lidhje me shumë familje të mëdha në disa treva e qytete shqiptare.

Në shtator 1844, Iljaz agë Qoku shkoi në krye të vullnetarëve dibranë të esnafëve, së bashku me forca të tjera qytetare dhe fshatare, në grykën e Radikës për të kundërshtuar me armë, armatën osmane të Hajredin Pashës, e cila vinte nga Tetova për për të zbatuar Tanzimatin në trevën dibrane. Në 22 shtator 1844 gryka e Radikës, ushtoi nga krisma e armëve të qytetarëve dibranë. Por me gjithë trimërinë që treguan dibranët nuk e ndalën dot hyrjen e armatës osmane në qytetin e Dibrës.

Iljaz agë Qoku u nis në mbrojtje të trojeve shqiptare në sektorin e Çamërisë, të cilat më 1854 u përpoq që t'i aneksonte Greqia. Porta e Lartë, e cila ushtritë e saj i kishte gozhuar në Danub kundër armatave ruse, pranoi kërkesën e krerëve shqiptarë që ta mbronin Çamërinë me forcat e tyre vullnetare, por u vuri si kusht që të luftonin në të njëjtën kohë edhe për mbrojtjen e Thesalisë, e cila kërcënohej nga rreziku grek. Iljazë agë Qokut i takoi të nisej me forcat vullnetare dibrane në frontin e Thesalisë. Midis forcave shqiptare që u shkuan në këtë sektor ishte edhe Halid Frashëri me djalën e tij të madh Abdyl Frashërin, atëherë tepër i ri.

Kontributi dhe pjesëmarrja e tij në mbrojtje të trojeve shqiptare ishin të njohura në të gjitha qarqet patriotike brenda dhe jashtë atdheut. Iljazë agë Qoku në krye të forcave vullnetare dibrane zbraps forcat e armatosura të shovinistëve grekë. Iljaz agë Qoku, siç shkruan në kujtimet e tij Johan Georg von Hahn, konsulli austriak për Greqinë Lindore në vitin 1863, ishte një burrë me përmasa trupore pothuajse kolosale dhe në saj të trimërisë së tij personale kishte arritur të fitonte një influencë të madhe në Dibër si gjatë fushatave kundër krerëve grekë, të cilët kishin sulmuar në vitin 1855, Thesalinë dhe Epirin ashtu dhe kundër malazezëve.<sup>4</sup>

Beteja u zhvillua në Xixull të Martaneshit e pranverës së vitit 1860 u drejtuar nga <sup>5</sup> Sheh Fejza. Ai i plagosur në betejë arriti të shkonte për t'i shpëtuar ndjekjes në qytetin e Dibrës. Atje, Iljaz agë Qoku duke rrezikuar jetën mbante në shtëpinë e tij në Shehër Sheh Fejzën, udhëheqësin e malësorëve të Grykës së Madhe, që kërkohesh nga turqit.

Në vitin 1861, u vu në krye të forcave dibrane në sektorin e Shkodrës për të mbrojtur trojet shqiptare veriore nga rreziku i pushtimit malazez. Në verën

<sup>4</sup> Xoxe Koli, Xhelili Qazim, "Iljaz Pashë Dibra(Qoku)", Kryetar i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit., Revista "Univers", Horizonte Shqiptare, f.147-155, Tiranë 2005.

<sup>5</sup> MHD, "Dibra dhe etnokultura e saj", vëll.I, Dibër 1995, f.176.

e vitit 1876, kur sapo filloi lufta serbo-turke, ai u nis së bashku me vullnetarët dhe malësorët dibranë për të përballuar lakmitë shoviniste që ushqente Beogradi ndaj viseve shqiptare.<sup>6</sup>

Ai në verën e vitit 1877, sapo kishte filluar lufta ruso-turke, së bashku me vullnetarët e malësorët dibranë, besnikë të tij, shkuan në Nish, për të luftuar kundër lakmive shoviniste të Beogradit ndaj viseve shqiptare.

Iljaz pashë Qoku si një luftar dhe atdhetar i shquar hyri që në fillim në Komitetin e Stambollit i cili u formua në vitin 1877 nën kryesinë e Abdyl Frashërit. Ai qe ndër të parët që përqafoi idenë për formimin e Lidhjes Shqiptare. Iljazë pashë Qoku, u shqua edhe në fushatën që u zhvillua gjatë pranverës së vitit 1878 kundër vendimeve të Traktatit të Shën Stëfanit të cilat cënoni trojet shqiptare dhe sidomos ata dibrane.

Në prag të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, Dibra ishte një trevë me tradita të mëdha luftarake. Atdhetarët shqiptarë krijuan një komitet shqiptar më 18 dhjetor 1877, në Stamboll me emrin " Komiteti Qëndror për mbrojtjen e të drejtave të kombësisë shqiptare " i njohur shkurtimisht me emrin " Komiteti i Stambollit " me kryetar Abdyl Frashërin dhe anëtarë patriotët Pashko Vasa, Jani Vreto, Ymer Prizreni, Zija Prishtina, Sami Frashëri, Ahmet Koronica, Mihal Harito, Iljaz Dibra, Mehmet Ali Vrioni, Seid Toptani, Mustafa Nuri Vlora, Mane Tahiri etj <sup>7</sup>. Në themelimin e Komitetit të Stambollit dhe për hartimin e programit të tij, një kontribut të madh, krahas patriotëve të tjerë, dha dhe patrioti dibran Iljaz Dibra (Qoku). Aktiviteti i tij është i lidhur jo vetëm me Komitetin e Stambollit, por roli i Iljaz Dibrës do të jetë shumë përcaktues në Lëvizjen Kombëtare Shqiptare e sidomos në Themelimin e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit.

Kërkesat për të formuar një Lidhje të Përgjithshme, u bënë mjaft popullore. Rrymat e ndryshme në Lëvizjen Kombëtare e konceptonin ndryshe karakterin dhe programin që duhej të kishte Lidhja shqiptare. Në rrymën e moderuar spikatnin sidomos Ali bej Gucia, Iljaz pashë Dibra, Abedin pashë Dinoja, Mahmud pashë Biçaku, Omer pashë Vrioni etj, të cilët kërkonin që Lidhja e Përgjithshme Shqiptare të kishte karakter kombëtar<sup>8</sup>. Rolin kryesor dhe përcaktues në këtë grupim e luante patrioti dibran Iljaz pashë Dibra, figurë e njohur atdhetare, personalitet i mendjes, i luftës, i guximit që gëzonte respekt në të gjitha qarqet atdhetare.

Nismën për thirrjen e një Kuvendi të Përgjithshëm që do të themelonte Lidhjen shqiptare e mori Komiteti i Stambollit. Momenti historik kërkonte që

<sup>6</sup> Kamberi Mois, " Iljazë Pashë Qoku-atdhetar i shquar", Dibër e Madhe, Maqedoni, 1993

<sup>7</sup> *Histori e Popullit Shqiptar*, vëll.II,Tiranë : Toena, 2002, f .143.

<sup>8</sup> *Histori e Popullit Shqiptar*, vëll.II, Tiranë :Toena, 2002, f.150

në këtë Kuvend, i pari kuvend i gjithë shqiptarëve, të përfshiheshin popullsitë e të gjitha krahinave e të gjitha besimeve. Peshën kryesore për organizimin e kuvendit e mori përsipër një komision i ngushtë, siç e quan Lippich, i drejtuar nga Ymer Prizreni dhe Ahmet Koronica.

Porta e Lartë, në fund të majit 1878 thirri në kryeqytetin e Perandorisë Osmane shumë nga personalitetet shqiptare të Vilajeteve të Kosovës e Janinës. Ndër këto personalitete përmenden: Abdulla pashë Dreni, Ali bej Guçia, Iljaz pashë Dibra, Sheh Mustafa Tetova, Zija Prishtina, Mustafa pashë Vlora, Vesel bej Dino dhe plot atdhetarë të tjerë<sup>9</sup>. Ndër të gjithë personalitetet që u thirrën në Stamboll, spikat për qëndrimin e tij Iljaz pashë Dibra. Porta e Lartë, u përpoq t'i mbante në Stamboll për t'i penguar të merrnin pjesë në Kuvendin e Përgjithshëm të Prizrenit.

Kuvendi Kombëtar i hapi pununimet më 10 qershor 1878 ndonëse nuk kishin arritur akoma të gjithë delegatet e krahinave shqiptare. Nga të dhënat e derisotme, nuk njihen të gjithë emrat e delegateve që morën pjesë në Kuvendin Kombëtar të Prizrenit. Njihen rreth 110 emra, shumica e të cilëve nga Vilajeti i Kosovës. Ndër figurat më të shquara që merrnin pjesë në Kuvendin e Përgjithshëm njihen: Ali bej Guçia, Iljaz pashë Dibra, Hasan pashë Tetova, Ymer Prizreni, Abdulla pashë Dreni, Ahmet Koronica, Zija bej Prishtina, Jashar bej Shkupi, Shaban bej Peja, Filip Doda, Sulejman Vokshi, Shuaip Spahiu, Ali Ibra, Abdyl Frashëri etj<sup>10</sup>.

Ndërsa konsulli Lippich, ndër figurat më të shquara që merrnin pjesë në Kuvendin e Përgjithshëm numëronte Ali bej Guçinë, Iljaz pashë Dibrën, Hasan pashë Tetovën, Abdulla pashë Drenin dhe Ahmet Koronicën, gjykatësin e Gjakovës<sup>11</sup>. Në të gjitha informacionet dhe burimet që kemi për themelimin dhe veprimtarinë e Kuvendit të Lidhjes, ndër të gjithë figurat atdhetare shqiptare spikat veprimtaria patriotike e dibranit Iljaz pashë Dibra. Krahas patriotit Abdyl Frashëri, Iljaz pashë Dibra u bë figurë qendrore e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit që po themelohej dhe një personalitet me mjaft influencë gjatë gjithë veprimtarisë së saj. ”Ky burrë i famshëm, me cilsinat e nalta fisnike e me karakterin e fortë e me mendjen e kthjelltë dhe me ndjesinat e tija kombëtare, u ba krahu i djathtë i Abdyl Frashërit të pavdekshëm dhe do të ketë nderin e madh me kryesue kuvendin historik që vu bazat e Rilindjes Kombëtare<sup>12</sup>.

Kryetar i kuvendit u zgjodh patrioti dibran Iljaz pashë Dibra, personalitet me

<sup>9</sup> *Histori e Popullit Shqiptar*, vëll.II, Tiranë : Toena, 2002, f.154

<sup>10</sup> *Histori e Popullit Shqiptar*, vëll.II, Tiranë : Toena, 2002, f.154.

<sup>11</sup> A.I.H, *Arkivi i Vjenës*, Lippich, *Raport nr.58*, Shkodër, 22 qershor 1878

<sup>12</sup> Llazar Siljani, Rekë, “*Të cilët janë shqiptarët e sotshëm dhe gjuha e tyre*”, Sofje, 1910.

influcencë në qarqet patriotike shqiptare. Në raportin e konsullit Lippich theksohet: “Mbledhjen e drejtoi delegati më i moshuar në Kuvendin e Përgjithshëm, Iljaz pashë Dibra apo Iljaz pashë Qoku, siç e quanin dibranët”<sup>13</sup>. Iljaz pashë Dibra u zgjodh kryetar i Kuvendit sepse:

- Ai ishte nga Dibra dhe Dibra kishte patur e kishte rol përcaktues në ngjarje madhore të historisë kombëtare shqiptare,
- Iljaz pashë Dibra ishte veteran dhe udhëheqës i luftërave të armatosura kundër reformave të Tanzimatit dhe kundër synimeve aneksioniste të vendeve fqinjë,
- Gëzonte shumë popullaritet në rrethet shoqërore të asaj kohe dhe Abdyl Frashëri gjeti tek ai gatishmëri për organizimin e Lidhjes shqiptare.
- Ndhmoi edhe financiarisht për organizimin, themelimin dhe zhvillimin e veprimtarisë së Lidhjes në mbrojtje të çështjes shqiptare <sup>14</sup>.

Më 10 qershor 1878, të gjithë delegatet e pranishëm dhanë pëlqimin e tyre për të formuar një besëlidhje të përgjithshme me karakter politik e ushtarak me emrin Lidhja Shqiptare e Prizrenit. Menjëherë pas themelimit të Lidhjes shqiptare, u formuan organet e larta të Lidhjes. Në krye të Lidhjes shqiptare qëndronte Këshilli i Përgjithshëm me funksione legjislative dhe me seli në Prizren. Nga ky Këshill do të vareshin degët që do të krijoheshin në krahinat shqiptare. Kryetar i saj u zgjodh dibrani Iljaz pashë Dibra.

Kuvendi i Përgjithshëm u mbledh në Prizren më 1 korrik 1878. Kuvendi i Përgjithshëm miratoi më 2 korrik 1878 një Kanun të Ri për Lidhjen e Prizrenit. Kanuni e shpalli organizatën e formuar në Prizren, Lidhje Shqiptare dhe zgjodhi organet e larta të Lidhjes shqiptare: Këshillin e Përgjithshëm ose Këshillin Qëndror dhe Komitetin Kombëtar ose Komitetin për Shpëtimin publik<sup>15</sup>. Në Këshillin e Përgjithshëm u zgjodhën 56 anëtarë. Shumicën dërmuese të Këshillit të Përgjithshëm tani e përbënin patriotët e rrymës të moderuar të cilët përfaqësoheshin nga Iljaz pashë Dibra, Ali pashë Gucia, Sheh Mustafa Tetova, Ali pashë Draga, Hasan pashë Draga, Haxhi Sadik Tetova, Hysen bej Gjilani, Ali bej Tirana, Qazim bej Gjirokastra, Mustafa Nuri Vlora, Shaban bej Peja etj. Patriotët radikalë përfaqësoheshin kryesisht nga Abdyl Frashëri, Ymer Prizreni, Sulejman Vokshi, Haxhi Zeka, Ahmet Koronica, Haxhi Shabani, Ali Ibra etj, kurse sulltanistët përfaqësoheshin nga Abdulla pashë Dreni, Osman Myfti Prishtina, Sadik pashë Hoxholli, Abedin pashë Dino etj <sup>16</sup>.

Për vetë rolin, kontributin, ndikimin e popullaritetin që gëzonin Iljaz pashë

<sup>13</sup> A.I.H, *Arkivi i Vjenës*, Lippich, *Raport nr.58*, Shkodër, më 22 qershor 1878

<sup>14</sup> M.H.D, *Kumtesë*, Mojs Kamberi, “*Iljaz pashë Dibra, Kryetar i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit*”, f. 4; “*Dibra dhe etnokultura e saj*”, vëll.II, Dibër, 1995, f. 227-228

<sup>15</sup> Kristo Frashëri, “*Lidhja Shqiptare e Prizrenit*”, Tiranë : Toena, 1997, f. 108.

<sup>16</sup> *Histori e Popullit Shqiptar*, vëll.II, Tiranë : Toena, 2002, f. 156

Dibra dhe delegatët e Dibrës në Lidhjen Shqiptare të Prizrenit, Iljaz pashë Dibra, që ishte kryetar i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, u zgjodh edhe kryetar i Këshillit të Përgjithshëm. Nën kryetar i Lidhjes Shqiptare u zgjodh Sheh Mustafa Tetova<sup>17</sup>.

Në Dibër, dega e Lidhjes Shqiptare u ngrit menjëherë pas Kuvendit. Udhëheqësit e Lidhjes Shqiptare gjetën mbështetjen e plotë të Dibrës dhe të dibranëve. Inisiativën për krijimin e degëve të Lidhjes Shqiptare në krahinat e tjera e morën përsipër Kryetari i Lidhjes Shqiptare, Iljaz pashë Dibra dhe Abdyl Frashëri. Gjatë takimeve me krerë dhe malësorë të Maleve të Dibrës, Abdyl Frashëri dhe Iljaz pashë Dibra, u munduan që të sheshonin mosmarrëveshjet ndërmjet krerëve sepse kontradiktat pengonin bashkimin e krahinave të Dibrës me Lidhjen.

Mbështetja e fuqishme që Abdyl Frashëri gjeti në Dibër, energjitë e pashtershme të Dibrës, besimi që dibranët kishin tek Iljaz pashë Dibra, kryetari i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, e bënë Dibrën në këtë periudhë një qendër të dytë të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Dibra, duke zënë një vend të rëndësishëm në Lëvizjen Kombëtare, u përcaktua dhe si vendi ku do të organizoheshin shumë Kuvende të Lidhjes me shumë rëndësi për fatet e Shqipërisë si: Kuvendi i korrikut 1878 në fushën e Qernanicës, Kuvendi i 14 tetorit 1878, Kuvendi i 1 nëntorit 1878, Kuvendi i 8 nëntorit 1878 dhe Kuvendi i 20 tetorit 1880.

## Përfundime

Nga materialet e shfrytëzuara, kam përfituar të dhëna me shumë interes që vërtetojnë aktivitetin patriotik të Iljazë pashë Dibrës. Punimet e studiuesve, kujtimshkruesve për këtë figurë të historisë së Dibrës dhe Shqipërisë, më kanë ndihmuar për pasurimin me fakte dhe zgjerimin e spektrit informativ të punimit për tu dhënë përgjigje disa pyetjeve:

- Ngatërohen apo dublohen kryetari i kuvendit themelues të lidhjes me kryetarin e lidhjes?
- Kryetari i Lidhjes me kryetarin e qeverisë së përkohshme?
- Vihen në qarkullim figura, që nuk kanë pasur lidhje me këtë veprimtari?
- Ai karakterizohet si veprimtar i Lëvizjes Kombëtare dhe një nga drejtuesit e Lidhjes Shqiptare dhe jo si kryetari i saj?
- Nuk theksohen kontributi i tij në themelimin e Lidhjes dhe ndihmesa e tij vendimtare për zbatimin dhe realizimin e programit të saj kombëtar?
- Nuk bëhet dallimi që ka ai me mijëra veprimtarë të Lidhjes dhe dhjetra drejtues të Lidhjes se:

<sup>17</sup> Kristo Frashëri, “*Lidhja Shqiptare e Prizrenit*”, Tiranë : Toena, 1997, f.108.

- Iljazi është njëri nga organizatorët kryesorë të Kuvendit themelues të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit.
- Është kryetari parë i këtij kuvendi i zgjedhur në unanimitet nga të gjithë delegatët.
- U zgjodh në krye të Këshillit të Përgjithshëm të lidhjes, dhe formuloi programin autonomist të shqiptarëve.
- Është bashkëhartuesi i “Kushtetutës së Lidhjes”, 15 qershorit 1878.
- Është fimëtari kyesor i kuvendeve kryesore të Lidhjes në realizim programit të Lidhjes.

I pajisur me vetëdije të re politike, në pranverë të vitit 1878, u vu në ballë për realizimin e programit të autonomisë administrative kombëtare të vilajeteve të bashkuara shqiptare. Pavarësisht moshës punoi energjikisht për bashkimin e viseve të tjera rreth programit kombëtar të Lidhjes duke drejtuar kuvendet shqiptare të Dibrës: 14 tetor 1878, 1 nëntor 1878, 8 nëntor 1878, 20 tetor 1880. Ai nuk qëndroi i tërhequr në çifligjet dhe sipërmarrjet e tij, por u vu në ballë të luftës trevjeçare të popullit të vet në këto momente jetike për fatet e tij.

Të gjitha sa thamë më sipër i vërtetojnë dokumentet programatike të Lidhjes Shqiptare, në të cilat Iljaz pashë Qoku është kryefimëtari i tyre dhe kryetari i tre kuvendeve më të rëndësishme të Lidhjes në të cilat ato janë miratuar dhe konfirmuar. (qershor -tetor 1878 dhe tetor- nëntor 1880).

Më 15 qershor 1878, 43 delegatë të Kuvendit të Prizrenit të mbledhur në Bajrakxhaminë e Prizrenit” për mbrojtjen e të drejtave të Shqipërisë” vendosën njëzëri nën kryesinë e Iljaz pashë Dibrës në emër të gjithë krahinave formimin e organizatës kombëtare, Lidhjen e Prizrenit. Kryetar të saj zgjodhën Iljaz pashën (figura e të cilit është lënë në hije, edhe sot e kësaj dite), Omer Prizreni ( edhe nëse del të ketë qenë i pranishëm në Kuvend, ndikimi i tij ishte i vogël).

Që në fillimet e vitit 1880 në Prizren dhe në Dibër pushteti fiskal dhe ai gjyqësor po kalonin në duart e degëve të Lidhjes Shqiptare. Aksioni po shërbente si shtysë për realizimin në mbarë Shqipërinë të kërkesës së parashtruar në Dibër rreth dy vjet më pare për krijimin e Vilajetit autonom shqiptar. Sigurisht që marrja e një vendimi të tillë në kohën kur bëheshin keto përpjekje nuk ishte e lehtë. Qendër e këtyre debateve jo rastësisht u bë qyteti i Dibrës, jo vetëm për pozicionin strategjik të rajonit, por dhe për rolin e degës së Lidhjes në këtë qytet dhe të autoritetit të njerit prej themeluesve të Lidhjes dhe deri vonë kryetari i saj, Iljaz pashë Dibrës. Në kryesinë e Iljaz pashës në Kuvendin e Dibrës shumica e delegatëve të kuvendit u shpreh me vendosmëri për mbrojtjen e Ulqinit në kundërshtim me urdhërin e sulltanit për dorëzimin e tij.

Çifligari dhe sipërmarrësi i madh i taksave Iljaz pashë Qoku qëndroi në radhët e para të udhëheqësve më të përparuar dhe më të vendosur të luftës së



popullit shqiptar në vitet 1878-1881. Në krye të Lidhjes ai së bashku me Pashko Vasën, Ali pashë Gucinë, pasuesin e tij në krye të Lidhjes, Omer Prizrenin, Abdyl bej Frashërin, Daut Boriçin, Hodo Sokolin e dhjetra dhjetra të tjerë në ballë të Lidhjes dhe të degëve e të forcave luftarake dhe më së fundi dhe të organeve të qeverisë së saj, të kryesuar nga Omer effendi Prizreni, vunë gurin qoshes në themelet e Pavarësisë.

Në prag të themelimit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, Dibra, e udhëhequr nga personalitetet e saj politike, e sidomos kryetari i saj, Iljaz pashë Dibra, hyri në vitet e stuhishme të Lidhjes Shqiptare si një krahinë mjaft luftarake në mbrojtje të trojeve shqiptare nga copëtimi dhe mbështetëse e sigurtë e platformës politike të Lidhjes.

## Conclusions

The resources that I have consulted and referred to reveal some very interesting data and findings related to the patriotic activity of Iljaz Pasha of Dibra. The works of several scholars, memoirists who have written on this historical figure of Dibra and Albania have helped me to enrich all the factual knowledge and information needed to give an answer to some questions raised in this paper as follows:

- Is the genealogy of the Qoku family and that of Gropaj family confused with one another or is it simply duplicated consisting of variants of one and the same name?
- Is the Chairman of the Constituent Assembly of the League and the Chairman of the League the same thing or are they distinct and therefore confused?
- Is the Chairman of the League and the Head of the Interim Government confused, too?
- Are there figures who have not contributed or have not had any particular connection with this activity?
- Is Iljaz characterized as an activist of the National Movement and one of the leaders of the Albanian League and not as its chairman?
- Does his contribution count for the establishment of the League and the implementation of its national program and does this fact get emphasized in the documents or is it left apart and unmentioned?
- Is there any reference that Iljaz and thousands of League activists and dozens of League leaders contributed all to the developments of the League?

In search of the answers to these questions, we could find that:

- Iliazi is one of the main organizers of the founding Assembly of the Albanian

League of Prizreni.

- He is the chairman of this Assembly and the first Chairman of the League elected unanimously by all the delegates.
- He was elected the Chairman of the General Council of the League, and drafted the program for autonomy for all Albanians.
- He was one of the draftsmen who drafted the “Constitution of the League” on June 15, 1878.
- He was the key member in the Assembly of the League who attended and signed the main meetings and records for the implementation of the League’s program.

Equipped with some modern political consciousness, he was upfront and at the front about the realization of the program for the national administrative autonomy of the united Albanian vilayets in the spring of 1878.

Despite his age, he worked vigorously for making other areas join the national program of the League by leading the meetings in the Albanian Assembly of Dibra in October 14, 1878; November 1, 1878, November 8, 1878 and October 20, 1880. He never withdrew to his land and property, but was at the forefront of his people’s three-year war which were really existential to his being.

All that is said above is supported by the documents on the program of the Albanian League, in which Iljaz Pasha Qoku was the chairman of the three most important meetings of the League’s Assembly and the most important member to sign all the minutes on the decisions taken and approved in June -October 1878 and October - November 1880.

On June 15, 1878, 43 delegates of the Assembly of Prizreni gathered in Bajrakxhamia of Prizren “for the protection of the rights of Albania” and unanimously decided under the chairmanship of Iljaz Pasha Dibra on behalf of all the provinces about the formation of the national organization known as the League of Prizreni. Iljaz Pasha was chosen as its chairperson (this historical figure is rendered obscure even today). Although Omer Prizreni is proved to have been present in the Assembly, his influence was comparatively insignificant.

The first document approved by the delegates of the Prizreni’s Assembly headed by Iljaz Pasha Qoku was a protest against the Treaty of St. Stephan and any possible project for the partition of the Albanian-inhabited territories by Berlin’s Congress.

Ilijaz Pasha and his followers showed strong determination not to allow the partition of Albanian native territories and lands demonstrating great feelings of Albanian patriotism:

“Cursed be the ones who follow egoistic interests at this time when our

homeland calls us to service. In our League, we decided to leave religion apart and try to show that above all we are Albanians.”

Representatives of Albanians from Northern, Northeastern and Eastern territories, led by Iljaz Pasha Dibra went to the Assembly of Prizreni holding firmly to the idea and cause of the national unity of all Albanians despite their religious beliefs or regional origin.

In the Program for Albanian Autonomy, June 15, 1878, they demanded:

The establishment of an autonomous administration under the name of “the united vilayets” with its center in Manastiri and the assignment of Gazi Ahmet Muhtar Pasha as the chairman of the United Vilayets (the founders of the League had many hopes in the hero of the Russian-Turkish War, but it did not take long to prove that he failed their faith with his attitude towards their demands and needs);

Great commitment for the establishment of the Councils of the League whose task was spreading the its objective for autonomy in the large centers such as Manastiri, Bitola, Skopje, Pristina;

Levying taxes for ash and rice, livestock and property on behalf of the United Vilayets and establishing the gendarmerie. Finally, the establishment of a military militia for the protection of the territory within “the United Vilayets” was urgently needed.

These requests and demands presented by Iljaz Dibra proved that he, but he was not the only one, had embraced the most advanced views of the most forward-looking Renaissance representatives in those hard times so critical for the fate of their homeland,.

Iljaz showed great maturity and determination and contributed not only for the approval of the “Constitution of the League “ but even for making it the very working program of the League led by him for nearly two years. Even when he was no longer officially in charge of the League, he firmly pursued this struggle for the realization of this program.

He considered The League’s Program for Autonomy, (with his first publisher Sylejman Kylçe), unequivocally “the Constitution of the League”. It was, in fact, that the Constitution of the United Vilayets and the Draft-Constitution of the Albanian Autonomous Vilayet.

The League of Prizreni program was strongly supported through strong arguments and in a complete version in the Assembly of Dibra, headed by Iljaz Pasha, on October 14, 1878.

The southern provinces of Albania joined the program for autonomy, approved in Dibra in those days, for the establishment of the Albanian vilayet through the Albanian League for Toskëria represented by Abdyl Frashëri. Their active participation in the Assembly of Dibra bore witness and consolidated

the character of the League as an Albanian political organization once again. According to the documentation found in the Archives of Istanbul, Iljaz Pasha signed the same five demands set forth, together with Abdul Frashëri on November 2, 1878. In addition to the five points, this is what is emphasized at the end of this resolution:

“Until all these demands and requirements be met, which interest our nation and state, all the territories of Albania will stand fast, firm and united and will unequivocally hold to this great cause and make use of any means, at any cost.

Since the beginning of 1880, the fiscal and judicial powers were passing on the hands of the branches of the Albanian League in Prizreni and Dibra. The actions taken were encouraging the implementation of the demands presented in Dibra about two years ago across the whole territories of Albania, so that the establishment of the Albanian autonomous Vilajet could be rendered possible. Taking such a decision at that time and all the efforts put on that was certainly no easy task. The center of these debates was not by chance the city of Dibra, due to its strategic location and the role played by the branch of the League set in this city and the authority of one of the founders of the League operating till recently, its chairman Iljaz Pasha Dibra. Under the chairmanship of Iljaz Pasha at the Assembly of Dibra, most of the delegates of the assembly expressed their determination to protect Ulcinj going against the Sultan’s order for his surrender.

After the Assembly’s workings on 4 November 1880 ended, Iljaz Pasha’s son, Xhemal Bey, left for Istanbul “with a project requiring sanctions, which certainly will not be accepted by the sultan “as the British consul from Thessaloniki known as Blant reported. Despite the hopes of Albanians that the Sublime Porte would not reject the request for autonomy, both resolutions received no answer.

The great landowner and the entrepreneur on taxes, Iljaz Pasha Qoku stood at the front of the most modern and determined Albanian leaders heading the war of the Albanian people in the years 1878-1881. Leading the League for many years, Iljaz together with Pashko Vasa, Ali Pasha Gucci, his successor in leading the League, Omer Prizreni, Abdyl Bej Frasheri, Daut Boriçi, Hodo Sokoli and dozens more operating in the League and military forces and most recently in many governmental organs, headed by Omer Effendi Prizreni, laid the cornerstone for the foundation of the most wanted Independence.

On the eve of the establishment of the Albanian League of Prizreni, the region of Dibra, led by its political personalities, and especially its chairman, Iljaz Pasha Dibra, entered the stormy days that the Albanian League was mostly characterized as a very warlike province in defense of Albanian territories against their fragmentation and as a devoted supporter to the political platform drafted by the League.

## **Bibliografia**

- A.I.H, *Arkivi i Vjenës*, Lippich, *Raport nr.58*, Shkodër, më 22 qershor 1878
- A.I.H, *Arkivi i Vjenës*, Lippich, *Raport nr.58*, Shkodër, 22 qershor 1878
- ” *Dibra dhe etnokultura e saj* “, vëll.II, Dibër, 1995
- *Gazetën Drita*, dhjetor 1938,
- *Histori e Popullit Shqiptar*, vëll.II,Tiranë : Toena, 2002
- Joan Georg Hahni, “*Studime shqiptare*” , 1854 në 3 vëllime.
- Llazar Siljani, Rekë, “*Të cilët janë shqiptarët e sotshëm dhe gjuha e tyre*”, Sofje, 1910.
- Kamberi Mois, “ *Iljazë Pashë Qoku-atdhetar i shquar*”, Dibër e Madhe, Maqedoni, 1993
- Kristo Frashëri, “*Lidhja Shqiptare e Prizrenit*”,Tiranë : Toena, 1997
- MHD, ”*Dibra dhe etnokultura e saj*”, vëll.I, Dibër 1995
- M.H.D, *Referat*, Masar Kodra,“*Dibra në rrethinë në periudhën e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit* “, Dibër 1978
- Stërmilli Haki, “ *Dibra në prag të historisë*”, Tiranë 1940.
- Xoxe. Koli, Xhelili Qazim, “*Iljaz Pashë Dibra(Qoku)*”, Kryetar i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit., Revista
- “*Univers*”, Horizonte Shqiptare, Tiranë 2005,

Prof.as.dr Eva Hyskaj TAFILI<sup>1</sup>

## GJERGJ KASTRIOTI-SKËNDERBEU NË HISTORIOGRAFINË E SHEKULLIT XIX

*“Ajo për çfarë ka nevojë Shqipëria është një frymë kombëtare me mentalitet kozmopolit dhe jo një frymë kozmopolite me mentalitet kombëtar”*

*Anete Laborej*

E nis këtë relacion mbi historiografinë e shekullit të XX për Skënderbeun, pikërisht me fjalët e një studiueseje tjetër, për të përcaktuar lidhjen mes realitetit të sotëm shqiptar dhe ngjarjeve të së kaluarës historike. Mbi to hedhin dritë mjaft studiues, (ne do përpiqemi të bëjmë të njëjtën gjë sot )ne përpjekje për të shpjeguar paradoksin e sotëm të realitetit shqiptar, ku “pandryshueshmëria kombëtare” duket se shtyn turma njerëzish ta lënë këtë vend dite pas dite, në kërkim të një shprese dhe një jete më të mirë.

E gjithë kjo “pandryshueshmëri kombëtare”, që nga koha e Skënderbeut e deri më tani, i gjithë ky qerthull i mbyllur, na bind se bota ku jetojmë, ajo e fillimit të shekullit të 21-të, ecën me vrap, pra është një botë që vrapon, - siç do ta përcaktonte Entëni Gidëns, - e brenda saj ne jemi gjithmonë në përpjekje dhe shpresa për ta arritur, pa ia shmangur vetes pyetjen: “po çdo të thotë sot të jesh shqiptar? Pra rëndësi ka që, duke gërvishtur pak mbulesën e retorikave pseudopatriotike, të arrijmë të identifikojmë rrënjët që vazhdojnë të na mbajnë gjallë brenda kontinentit, të cilit historikisht i përkasim në trungun evropian. Duket se një parakusht të shkëlqyer na e jep dukuria Gjergj Kastrioti (do ta quaja kështu pa asnjë rezervë). Në morinë e biografive të shkruara për heroin tonë kombëtar, e para në radhë është ajo që na ka lënë të shkruar në gjuhën latine Marin Barleti. Barleti ka qenë bashkëkohës i Kastriotit, kësisoj ka pasur mundësinë të hedhë në letër jo vetëm çka vjelë nga arkivat Venedikut, kur vajti atje pasi osmanët pushtuan vendlindjen e tij, Shkodrën, por edhe tregimet gojore të prijësve që ishin bashkëlufëtarë të Skënderbeut.

*“Historia de vita et gestis Scanderbegi, epiratorum principis”*, siç titullohet

---

<sup>1</sup> Departamenti i Historisë; Fakulteti Histori-Filogji, Universiteti i Tiranës

“Historia e Skënderbeut” në origjinal, botimin e parë e ka pasur në fillimin e shekullit XVI, në qytetin e Romës. Në të, për herë të parë Barleti e shtjellon këtë figurë me tezat e humanizmit evropian, të ringjalljes së tipareve të heroit të antikitetit, të frymës së lirisë e të besimit te forcat e njeriut. Për më tepër, – siç thotë Zhorzh Petroviç – “pothuajse të gjitha veprat e botuara për Skënderbeun ose janë përkthime të origjinalit latin, ose autorët e tyre kanë marrë nga vepra e Barletit”.<sup>2</sup> Edhe Noli është i të njëjtit mendim, kur thotë se “ky libër ka qenë burimi i morisë së veprave të botuara për Skënderbeun, qysh prej shekullit XVI, deri në shekullin XX”.<sup>3</sup>

Nga këto rrethana, Nadin “rremon” në mesin e protagonistëve venedikas të kulturës dhe artit, të gjysmës së parë të shekullit të 16-të, në një këndvështrim “ridhënieje” ndaj asaj Shqipërie që, duke u bërë pjesë gjeopolitike e historisë osmane, humbiste lidhjet e ngushta që prej shekujsh kishte pasur me atë çka ndodhte në Perëndim: ishin lidhje mjaft mirë të dokumentuara nga statutet të qyteteve të saja mesjetare, duke filluar veçanërisht me atë të shekullit të katërmëdhjetë të Shkodrës, teksti i të cilit dihej se ekzistonte, por që kishte humbur me rënien e shtetit venedikas, e që u gjet në vitin 1995 në Muzeun Korror të Venecias, pikërisht nga studiuesja veneciane.

Duke përfituar nga një përvojë e gjatë dhe e konsoliduar në studimin e teksteve letrare të periudhës midis Mesjetës dhe Rilindjes, autorja rindërton veprimtarinë e Bernardino (de) Vitalit, botuesit të humanistit të hershëm shqiptar, Marin Barletit. Vitali ishte aktiv në Venedik, që nga dy dekadat e fundit të shekullit të 15-të, deri në vitet dyzetë të shekullit të gjashtëmëdhjetë, pikërisht në periudhën kur Venediku ishte kryeqyteti evropian i shtypit. Në fillim të veprimtarisë botuese Bernardino dhe i vëllai, Mateo, nënshkruanin: “de Vitalibus vulo albanesoti” (shqiptarët e thjeshtë Vitali), duke paraqitur qartë origjinën e tyre; më pas, me krenarinë që kishin arritur shtetësinë, ata gjithmonë do të nënshkruanin “venedikas”.

Do të duhej të kalonte një shekull që Xhanmaria Biemi, një prift nga Breshia, të shkruante librin e titulluar “Historia e Gjegje Kastriotit të quajtur Skënderbe” (*Breshia, 1742*). Në shënimet e këtij libri, ky autor i referohet një anonimi nga Tivari, dorëshkrimin e të cilit, që daton në vitin 1480, e kishte gjetur duke

<sup>2</sup> Stefan Prifti - Bëhet fjalë për veprën e Zhorzh Petroviç “Skënderbeu (Gjergj Kastrioti). Ese e bibliografisë së arsyetuar”, Paris 1881, ribotim i Trofenik, Mynih 1967. Marrë nga “Historia e Skënderbeut”, faqe 17, botimi i III, tiranë, 1982.

<sup>3</sup> Fan S. Noli – “George Castriote Scanderbeg”, New York, 1947, faqe 79.

rrëmuar nëpër arkiva.<sup>4</sup> Në fakt ky dorëshkrim është zhdukur pa lënë gjurmë.

Edhe Gjini Muzaka, njëri prej pinjollëve të familjes që sundonte Beratin, na ka lënë tjetër dëshmi të jetës së Skënderbeut. Ai ka pasur fatin të luftonte krahas Gjergj Kastriotit, duke jetuar në Arbëri edhe 11 vjet pas vdekjes së kryeheroit, përpara se të transferohej në Napoli, ku shkroi librin “Historia dhe trashëgimia brez mbas brezi e familjes së Muzakajve”, tek i cili ai tregon të gjitha ngjarjet ku ka qenë dëshmitar i drejtpërdrejtë.<sup>5</sup>

Në shekullin XVIII kemi veprën e historianit dhe filozofit danez Ludvig Holberg “Historitë e heronjve I”. Ky autor e përshkruan Gjergj Kastriotin si një hero të paarritshëm, duke e dalluar nga të gjithë heronjtë e tjerë më parë. “Mund të thuhet për këtë – shkruan Holberg – se ai ishte heroi më i madh në histori, dhe askush, as në historinë e vjetër dhe as në atë të re, nuk mund të krahasohet me të, pasi asgjë nuk është më madhështore sesa të shohësh një princ të vogël, me një grusht njerëzish, të drejtojë luftën kundër dy monarkëve, nga të cilët u drodhën dhe u tmerruan Persia, Egjipti dhe gjithë Evropa.”<sup>6</sup> Holberg e mbyll atë pjesë të veprës së tij që i dedikohet Kastriotit, me një përcaktim shumë miklues për ndjesitë e shqiptarëve, duke thënë: **“Ai ishte luftëtari, prijësi dhe njëkohësisht heroi më i madh në histori.”**<sup>7</sup>

Në këtë shekull do të veçojmë edhe historianin e famshëm Eduard Gibën, që duke gërshetuar iluminizmin, me të ashtuquajturin “hulumtim të antikes”, pra mënyrën e shfrytëzimit të kujtesës historike, nxori në dritë veprën e tij “Historia e dështimit dhe rënies së Perandorisë Romake” (1776-1788), ku, në faqet 401 – 406 të vëll.5, bën një përshkrim të jetës dhe veprës së heroit tonë, duke përdorur një sens kritik ndaj tij. Për këtë detaj Gibën do të shkruante: “Nëse Skënderbeu e kishte mbajtur fshehur prej kohësh besimin e tij tek Krishti, si dhe qëllimin për t’u revoltuar, një mendje e shëndoshë duhet ta dënojë këtë veprim që mund t’i shërbejë vetëm tradhtisë dhe shkeljes së besimit, si dhe që mund t’i bashkëngjitet vrullshëm humbjes së kohës dhe të shpirtrave të disa mijëra bashkëluftëtarëve të tij të pakënaqur. A mundim ne të shprehim admirim për korrespondencën e fshehtë me Huniadin, në një kohë kur ai kryesonte pararojën e ushtrisë turke? A mundim ne ta shfajësojmë një dezertim të këtij lloji, një dezertim pasi u shkel besa dhe u la fitorja në duart e armikut të bamirësit të tij? Në rrokopujën e humbjes, vështrimi i Skënderbeut ishte përqendruar tek Reis Efendiu, apo sekretari kryesor. Duke ia vënë kamën në gjoks, ai i rrëmbëu këtij

<sup>4</sup> Fan S. Noli – “George Castriote Scanderbeg”, New York, 1947.

<sup>5</sup> Tajar Zavalani - “Historia e Shqipnis”, Londër, 1967.

<sup>6</sup> Ludvig Holberg - “Historitë e heronjve I”, 1864.

<sup>7</sup> Po aty.



një ferman për të qeverisur Arbërinë; më pas, vrasja e shkruesit të pafajshëm dhe zhdërvjelltësia e tij parandaluan zbulimin e menjëhershëm të këtij fakti.”<sup>8</sup>

Pavarësisht sensit kritik, bëmat e heroit e detyrojnë Gibënin të pranojë kontributin e tij në mbrojtje të pavarësisë kombëtare. Sipas tij, Murati u tërhoq me turpin e humbjes nga muret e Krujës, që ishte kështjella dhe vendbanimi i Kastriotëve. Gjatë marshimit, rrethimit dhe tërheqjes ai kishte pasur ngacmimin e një kundërshtari shqetësues, pothuaj të padukshëm, çka bëri që hidhërimi të shtohet dhe ndofta të shkurtonte ditët e sulltanit. Madje, në kulmin e betejës Mehmeti II u kishte lejuar vartësve të tij të bisedonin për një armëpushim, kështu princi shqiptar me të drejtë vlerësohet si një mbrojtës trim dhe i aftë i pavarësisë kombëtare.<sup>9</sup> Ndër të tjera, ky autor nuk tregohet entuziast për përmasat e bëmave të Kastriotit, kur shkruan se: “Entuziazmi i princërve dhe i krerëve fetarë e ka vënë emrin e tij krahas emrave të Aleksandrit të Madh dhe të Pirros. Nën dritën e këtij entuziazmi, nëse do të niseshim nga përmasat e principatës së tij dhe nga numri i pakët i forcave ushtarake që kishte në zotërim, ai mund të renditej fare pak më poshtë se heronjtë e antikitetit, të cilët triumfuan kundër Lindjes dhe legjioneve romake. Arritjet e tija madhështore, pashallarët me të cilët u ndesh, ushtritë që theu dhe tremijë turqit që vrau me dorën e tij, duhen parë brenda kuadrit të një kriticizmi dyshues.”<sup>10</sup>

Në fakt, gjykimi që u bën Gibën veprimeve të Skënderbeut mbështetet tek parimet morale të shekullit XVIII, duke iu shmangur faktit që tre shekuj më parë bëhej një luftë e pakompromis ndërmjet dy koncepteve të papajtueshme të moralitetit dhe marrëdhënieve njerëzore. “Me këtë mënyrë gjykimi ai duhet të kishte dënuar, gjithashtu, edhe mbretin Vladislav IV të Polonisë dhe Hungarisë, i cili, i shtyrë nga Nunci Apostolik, Kardinal Çezarini, shkeli armëpushimin që kishte nënshkruar me Sulltanin më 1444, në qytetin Segedin.”<sup>11</sup>

Këtu vlen të theksohet fakti që kjo vepër, e cila rezervonte një vend edhe për Gjergj Kastriotin, krijoi një standard në shkrimin e historisë. Gjithashtu, kjo vepër bëri të mundur që figura e Skënderbeut të popullarizohej, duke u bërë e njohur për shtresat e ndryshme të shoqërisë britanike. Ka shumë gjasë që kjo vepër, e cila ishte shumë e lexuar në Anglinë e shekullit XIX, të ketë frymëzuar edhe Lord Bajronin, që më pas do të shkruante “Pelegrinazhin e Çaild Hajroldit” (1812-1819), ku përmenden Shqipëria dhe Skënderbeu, si dhe Benxhamin

<sup>8</sup> Robert Elsie – “The novel The Rise of Iskander (1833) as a contribution to Britain’s literary discovery of Albania, <http://www.elsie.com>.

<sup>9</sup> Robert Elsie – “The novel The Rise of Iskander (1833) as a contribution to Britain’s literary discovery of Albania”, <http://www.elsie.com>.

<sup>10</sup> Po aty.

<sup>11</sup> Tajar Zavalani - “Historia e Shqipnis”, Londër, 1967.

Dizraelin, i cili në vitin 1833 do të shkruante romanin e shkurtër “Ngritja e Skënderbeut”, si dëshmi që vepra e heroit shqiptar shihej me kërshëri edhe nga shtresat e larta të kësaj shoqërie. Në fakt, kjo vepër e Dizraelit (*i quajtur edhe Lordi Bikënsfeld*) nuk ka ndonjë vlerë në aspektin historik, pasi bëhet fjalë për një roman të ngjizur me shumë të pavërteta rreth figurës së heroit, madje edhe në kuptimin letrar sot e ka humbur interesin e publikut; interesi i vetëm qëndron në faktin se është e para vepër që tregon marrëdhëniet letrare dhe kulturore anglo-shqiptare, si dhe faktin që figura titanike e Kastriotit ishte bërë objekt frymëzimi edhe për një shkrimtar mjaft të lexuar në epokën e Mbretëreshës Viktoria, me romane dhe tregime të shkruara me shijen e kohës, i cili do të shërbente si kryeministri i Anglisë dhe përfaqësues i Britanisë së Madhe në Kongresin e Berlinit, në korrik të vitit 1878.<sup>12</sup>

Historianët e shekullit XIX ishin promotorët e një transformimi intelektual dhe profesional. Rrethanat kulturore ishin të favorshme, pasi industrializimi dhe urbanizimi i shpejtë ngjallën një interesim të ri popullor ndaj të shkuarës, bazuar tek nostalgjia për çka ishte lënë pas, i shprehur ky interesim nëpërmjet dëshirës për ta krijuar të shkuarën në mënyrë imagjinare. Kjo gjë pasqyrohej në arkeologji, në studimin e artit e të arkitekturës, si dhe me shtimin e veprave historike.

Pozicionimi intelektual i historianëve u intensifikua nga prirja e tyre për ta shkruar historinë të zhveshur nga emocionet dhe në mënyrë objektive, duke pasur parasysh faktin që historianët nuk i mbajnë anën askujt dhe që nuk duhet të bëjnë propagandë me të shkuarën, sepse detyra e tyre ishte veçanërisht ajo e “rindërtimit”. Në këtë përfaqëse me të kaluarën na vjen në ndihmë “historicismi”, që s’është tjetër, veçse respektimi i karakterit të së shkuarës dhe i hendekut që na ndan me të.

Në këtë kuptim, në shekullin XIX, studiues të ndryshëm nga të gjitha vendet i lanë mënjane veprat e dy shekujve të mëparshëm, që lidheshin me figurën e Kastriotit, të cilat ishin përzierje e gojëdhënave me dokumentet arkivorë, dhe iu përveshën burimeve origjinale të ruajtura në arkivat e Vatikanit, Venedikut, Raguzës dhe Stambollit. Zbulimi i këtyre dokumenteve bëri që jeta dhe vepra e Gjergj Kastriotit Skënderbeut të shihej nën një dritë tjetër. Në veprat e tyre voluminoze, disa prej këtyre studiuesve e përmendin Kastriotin kur bëjnë fjalë për periudhën gjatë së cilës osmanët sundonin Ballkanin, ndërsa të tjerët, siç janë Jani Baila, me veprën “Përmbledhje e historisë së Gjergj Kastriotit, të mbiquajtur Skënderbe, Mbret i Arbërisë”, të botuar në greqisht (*Moskë, 1812*) {*vepër e botuar edhe në italisht nga A. Papadopulo-Vreto (Napoli, 1820)*}, anglezi Klement

<sup>12</sup> Robert Elsi - Romani ngritja e Skënderbeut i Benxhamin Dizraeli, një zbulim i ri albanologjik, Hylli i Dritës, Tiranë, 2-3, 1993.

Klark Muur, me veprën “Gjergj Kastrioti, i mbiquajtur Skënderbeu, Mbret i Arbërisë” (*Appelton, Nju-Jork 1850*), francezi Kamil Paganel, me “Historia e Skënderbeut, apo turqit dhe të krishterët e shekullit XV” (*Didier, Paris 1855*) dhe gjermani Julius Pisko, me “Skënderbeu, studime historike” (*Frick, Vjenë 1894*), kanë shkruar biografi të gjata për Gjergj Kastriotin. Gjithashtu, në këtë kohë kemi edhe veprat e Jozef Fon Hamer, me “Geschichte des osmanischen Reiches” (*Historia e Perandorisë Osmane*), 10 vëllime, (*Pest, 1827-1835*)<sup>13</sup>; të Karl Hopf, me “Chroniques Greco-Romanes inedites” (*Kronika të pabotuara greko-romake*) (*Berlin, 1873*)<sup>14</sup>; si dhe J. W. Cinkajzen, me “Geschichte des Osmanischen Reiches in Europa” (*Historia e Perandorisë Osmane në Evropë*), 7 vëllime, (*Hamburg, 1840-1863*)<sup>15</sup>.

“Kapiteni i jeniçerëve. Një histori e kohërave të Skënderbeut dhe rënia e Kostandinopojës” (*Nju-Jork, 1886*), ishte një tjetër libër i frymëzuar nga Gjergj Kastrioti, i shkruar nga Xhejms Miker Lادلou, i cili padyshim ishte i ndikuar nga vepra e Klement Klark Muur, e botuar në vitin 1850. Nuk mund të mos përmendet këtu vepra e shkruar nga Karlo Padiljone “Përmbledhje e historisë së Gjergj Kastriotit, të mbiquajtur Skënderbeu, dhe pasardhësit e tij” (*Napoli, 1879*), si dhe Zhorzh Petroviç me “Skënderbeu (*Gjergj Kastrioti*). Ese e bibliografisë së arsyetuar” (*Paris, 1881. Ribotar nga Trofenik, Mynih, 1967*), e cila përmban 185 vepra historike, filozofike dhe letrare mbi Skënderbeun.<sup>16</sup> Në fakt, kjo e fundit është një vepër bibliografike, ku përmbledhen të gjitha veprat e botuara për Gjergj Kastriotin në disa prej gjuhëve evropiane, përveç gjuhëve sllave.

Edhe vepra e Edit Durhamit, “Brenga e Ballkanit” (*Nelson, Londër, 1904*) mund t’i bashkëngjitet grupit të veprave të mësipërme, pasi kur flet për Gjergj Kastriotin është thellësisht e ndikuar nga tiparet dalluese të historiografisë së shekullit XIX. Duke e filluar përshkrimin me rininë e tij, kur ai tregoi aftësi të mëdha, derisa mori emrin Iskander Bej, Durhami na paraqet një Skënderbe të mahnitur nga fitoret e Janosh Huniadit kundër turqve, të cilat e frymëzojnë atë me idenë e të luftuarit për kombin e tij.<sup>17</sup> Gjithashtu, ajo na e paraqet heroin si dinak dhe oportunist të zotin, kur përshkruan momentin që nga largimi i tij prej fushëbetejës, deri kur mbërriti në Krujë. “Pa iu dhënë turqve shkak që të kuptonin se do t’i tradhtonte – shkruan Durham – ai u shfaq para sekretarit

<sup>13</sup> B. B. Ashcom – Notes on the Development of the Scanderbeg Theme, Comparative Literature, Vol.5, No.1 (Winter, 1953), 16-29.

<sup>14</sup> Po aty.

<sup>15</sup> Po aty.

<sup>16</sup> Antonina Zheljaskova – [http://www.omda.bg/imir/studiues/alban\\_id11.html](http://www.omda.bg/imir/studiues/alban_id11.html).

<sup>17</sup> Mary Edith Durham – The burden of the Balkans, London, 1905, ff 48-49, <http://www.hti.umich.edu/cgi/t/text/text-idx?c=bosnia; idno=ANS3900.0001.001>.

të sulltanit, duke i kërkuar këtij që në emër të sulltanit t'i jepej posti i Zotit të Krujës. Ai kishte mbështetjen e ushtarëve shqiptarë, kësisoj sekretarit nuk i mbetej tjetër veç të nënshkruante ose të vdiste. Sekretari nuk bëri tjetër, por e nënshkroi fermanin.

Në Dibër Kastrioti u prit me gëzim nga sundimtari, Moisi Golemi, i cili bashkua me të. Me të mbërritur në Krujë së bashku me trupat e tij, Gjergji i paraqiti letrën zyrtare administratorit turk (*kajmekamit*), i cili menjëherë ia dorëzoi postin. Atë natë ai e çdo turk në qytet u vranë dhe Gjergji e shpalli veten kampionin e krishterimit dhe të Arbërisë së lirë. Kjo ndodhi në vitin 1443.<sup>18</sup>

Në shkrimet filozofike dhe historike të shekullit XIX, Gjergj Kastrioti-Skënderbeu na shfaqet si një përfaqësues i absolutizmit iluminist. Ai paraqitet relativisht si një mbret filozof, i cili u ngrit mbi ndarjet që ekzistonin ndër arbërorët dhe ishte më shumë një mësues sesa një sundimtar tradicional.<sup>19</sup> Kjo gjë ilustron shumë mirë me rëndësinë që i jepet faktit sesi në Kuvendin e Lezhës princat shqiptarë u bashkuan rreth Skënderbeut, në luftën kundër turqve.

Pavarësisht frymës për ta shkruar historinë të zhveshur nga emocionet dhe në mënyrë objektive, edhe pse tashmë në një masë më të vogël, sërish vërehet fakti që figura e Skënderbeut vijon të trajtohet jo vetëm duke u mbështetur tek materialet arkivorë, të cilët dokumentonin ngjarjet e kohës, por edhe tek bëmat mitike të kësaj figure madhështore, të përcjella nëpërmjet eposit popullor apo të marra nga veprat e mëparshme, duke u shfaqur si një figurë që mishëron simbiozën midis njerëzores dhe hyjnore, me anët mira dhe të këqija të saj.

Të gjithë autorët ngrenë lart aftësinë drejtuese të këtij strategu ushtarak, i cili, me një ushtri disa herë më të vogël në numër, për 25 vjet u bëri ballë ushtrive të Muratit dhe Mehmetit II, dhe që me pragmatizmin e tij arrinte t'i mbulonte mjaft mirë vështirësitë financiare dhe mungesat në ushtarë, nëpërmjet marrëdhënieve me Vatikanin, Republikën e Venedikut dhe Mbretërinë e Napolit, duke u shfaqur edhe si një diplomat i shkëlqyer.

Ky luftëtar i pashoq, jo vetëm që u kthye në pikën e referimit përsa i përket frenimit të osmanëve që vinin nga Ballkani drejt Evropës së krishterë, por fama e tij bëri që dy prej papëve – Eugjenit IV dhe Piu II – t'u kalonte nëpër kokë ideja e një kryqëzate tjetër kundër Islamit, duke vënë në krye të ushtrisë së krishterë Gjergj Kastriotin. Se ç' vend zinte kontributi i heroit tonë kombëtar në mbrojtjen e krishterimit, e tregon më së miri titulli "Athleta Cristi" (*Luftëtar i Krishtit*), me të cilin Papa Kalisti III vlerësoi Skënderbeun.

Në shekullin XIX, të mbiquajtur shekulli i "revolucioneve kombëtare",

<sup>18</sup> Po aty.

<sup>19</sup> Antonina Zheljaskova – [http://www.omda.bg/imir/studiues/alban\\_id11.html](http://www.omda.bg/imir/studiues/alban_id11.html).

lartësimi i figurës së Gjergj Kastriotit dhe i rolit të tij si mburoja e Evropës në luftën kundër Perandorisë Osmane, do të shërbente si nxitje për ndërgjegjësimin e shqiptarëve, në lidhje me identitetin e tyre, si dhe në orvatjet e tyre për t'u organizuar, me qëllim që të luftonin për të arritur pavarësinë nga Turqia osmane, asht siç kishin bërë popuj të tjerë në Ballkan.

Në kohën e Rilindjes Kombëtare Shqiptare, emri i Gjergj Kastriotit bë emblema e frymëzimit të shqiptarëve në luftën kundër pushtuesit osman. Përpos Jeronim De Radës, i cili e përdori emrin e Skënderbeut me synimin që të zgjonte nga letargjia kancelaritë kryesore evropiane, në lidhje me çështjen e popullit shqiptar, duke kërkuar atyre të vepronin për ta ndihmuar këtë popull që të çlirohej nga osmanët, një kontribut vigan në lartësimin e emrit të kryeheroit ka dhënë edhe Naim Frashëri, me poemën e tij “Istoria e Skënderbeut”.

“Istoria e Skënderbeut” ka qenë vepra më e përhapur dhe ajo më me ndikim në kohë. Në përshkrimin e kësaj figure, Naimi është ndikuar dukshëm nga Barleti, pasi përsëriti pothuaj të njëjtat ide: lashtësia e kombit shqiptar, origjina e tij prej epirotëve e maqedonasve, si dhe paraqitja e Skënderbeut si pasardhës i Pirros së Epirit dhe Aleksandrit të Maqedonisë.

Në rastin e Naim Frashërit, që i përkiste besimit të sektit të bektashinjve, veprën e tij duhet ta shohim brenda rrethanave të shekullit XIX, një shekull i revolucioneve kombëtare në Ballkan, por edhe i romantizmit. Në atë kohë ishte e pamundur që shqiptarët të hidheshin njëzëri në luftë kundër osmanëve myslimanë, për të mbrojtur krishterimin, siç ndodhte me popujt e krishterë të Ballkanit, sepse pjesa dërrmuese e tyre ishte e besimit mysliman. Kësisoj, për sa i përket faktorit fetar kishim të bënim me një popull të ndarë dhe në këtë kuptim nuk mund të thuhet se ndjenja patriotike tek shqiptarët ishte në lartësinë e fqinjëve, që kishin homogjenitet në aspektin e besimit fetar. Në rastin e Naimit kemi të bëjmë me një mysliman që lartësonte figurën e një të krishteri, pa kurrfarë kompleksi të karakterit fetar, duke dashur të lëshonte tharmin për bashkimin e shqiptarëve; dhe më mirë se çdo gjë këtë tharim mund ta simbolizonte figura e Skënderbeut.

“Turqizmi i qindra mijëra shqiptarëve, greqizmi i një pjese tjetër, ngatërimi i përkatësisë fetare me atë kombëtare – siç thotë Kadareja – dëshmonte se ndjenja patriotike e një pjese të shqiptarëve ka qenë jo aq e fortë siç paraqitej.”<sup>20</sup> Pra, rilindësit do ta lartësonin figurën e Gjergj Kastriotit, me qëllim që të ndiznin zjarrin patriotik në zemrat e të gjithë shqiptarëve, pavarësisht nga besimi i tyre fetar, duke bërë që edhe ata të besimit mysliman të gjenin frymëzim në figurën mitike të Skënderbeut. Kësisoj, rilindësit formësuan një Skënderbe simbol të

<sup>20</sup> Zef Mirdita - Gjergj Kastrioti-Skënderbeu, mbrojtës i qytetërimit evropian, Gazeta “55”, nr.2232, 7 mars 2005.

bashkimit, duke e thirrur atë nga historia, pikërisht në kohën kur po përgatitej pavarësia e Shqipërisë.

Duke e mbyllur, për figurën e kryetrimt do të përmendja atë çka kanë thënë për të albanologu i shquar Milan Shufflai dhe historiani më i madh kroat i gjysmës së dytë të shekullit XIX dhe i fillimit të shekullit XX, Ferdo Shishiç. Shufflai, i cili ka qenë i ndikuar dukshëm nga fryma që ka mbizotëruar historiografinë e shekullit të “revolucioneve kombëtare”, duke e ngritur lart personalitetin e Gjergj Kastriotit-Skënderbeut, ndër të tjera ka thënë: “Nën udhëheqjen e Skënderbeut e tërë bujaria shqiptare u bashkua tok në luftë kundër turqve. U krijua shteti i parë shqiptar, pas rënies së Kostandinopojës, Serbisë dhe Bosnjës, shteti i fundit i madh i krishterë në Ballkan.”<sup>21</sup> Ndërsa Shishiç, në një dorëshkrim që ruhet në Arkivin e Akademisë Kroate të Shkencave dhe Arteve, në Zagreb, të titulluar “Gjergj Kastrioti-Skënderbeu dhe koha e tij”, shkruan që në fillim: “Ç’është në mesin e poetëve Shekspiri, ç’është në mesin e oratorëve Çarls Xhejms Foksi (*burrë shteti dhe orator britanik; 1749-1806*), ç’është në mesin e udhëheqësve ushtarakë Napoloni, është Skënderbeu në mesin e trimave: është trim i vërtetë.” Shishiç vazhdon më tej, duke thënë: “Në kohën kur kalorësit evropianë trembeshin nga fytyrat e jeniçerëve, të skuqura nga zemërimi, korrte fitore.” Në një botë që sa vjen e bëhet më e vogël dhe më e përbashkët, dukuri si Gjergj Kastrioti mbeten pika referimi për një frymë kombëtare me mentalitet kozmopolit, aq të nevojshëm për t’u identifikuar në radhën e vendeve evropiane, ku synojmë të jemi.

## PËRFUNDIME

1. Ajo çka deduktohet nga trajtimi që i bën Gjergj Kastriotit Skënderbeut historiografia e shekullit XIX është se jo vetëm në epokën e tij, por edhe pas vdekjes, ai ka qenë pika e referimit për popujt e lirë, të cilët në udhën e gjatë të historisë e kanë pasur si thesar gjeninë e tij. Figura e tij nuk ka qenë burim frymëzimi vetëm për shqiptarët, por ai ka qenë frymëzim edhe për popujt e tjerë që luftonin për çlirimin kombëtar e shpirtëror nga zgjedha turke.
2. Ndonëse ndaj figurës së Skënderbeut jo të gjithë autorët kanë pasur një qëndrim krejtësisht entuziast, çka ndonjëherë ishte i pajustificueshëm, pasi qëndrimi i tyre bazohej tek parimet morale të shekullit XVIII, duke iu shmangur faktit që tre shekuj para tij bëhej një luftë e pakompromis ndërmjet dy koncepteve të papajtueshme të moralitetit dhe marrëdhënieve njerëzore, vihet re se edhe ata që kanë përdorur një sens kritik për aspekte

<sup>21</sup> Zef Mirdita - Gjergj Kastrioti-Skënderbeu, mbrojtës i qytetërimit evropian, Gazeta “55”, nr.2232, 7 mars 2005.

të veçanta të jetës dhe veprimtarisë së tij, në fund të fundit kanë qenë të shtrënguar të pranojnë kontributin e tij në mbrojtje të pavarësisë kombëtare, gjë që i zhvlerëson kritikën, pasi në çdo rast mjetet justifikohen nga qëllimi për të shpëtuar popullin e tij nga zgjedha e pushtuesit.

3. Vepra e heroit kombëtar të shqiptarëve ka shumë gjasë të ketë frymëzuar edhe Lord Bajronin, që më pas do të shkruante “Pelegrinazhin e Çaild Hajroldit” (1812-1819), ku përmenden Shqipëria dhe Skënderbeu, si dhe Benxhamin Dizraelin, i cili në vitin 1833 do të shkruante romanin e shkurtër “Ngritja e Skënderbeut”, një dëshmi që vepra e heroit shqiptar shihej me kërshtëri edhe nga shtresat e larta të asaj shoqërie. E gjitha kjo falë shkrimit të Eduard Gibënit, “Historia e dështimit dhe rënies së Perandorisë Romake”, që jo vetëm krijoi një standard në shkrimin e historisë, por bëri të mundur edhe që figura e Skënderbeut të popullarizohej, duke u bërë e njohur për shtresat e ndryshme të shoqërisë britanike.
4. Në shekullin XIX historianët ishin promotorët e një transformimi intelektual dhe profesional. Pozicionimi intelektual i tyre u intensifikua nga prirja për ta shkruar historinë të zhveshur nga emocionet dhe në mënyrë objektive, duke pasur parasysh faktin që historianët nuk i mbajnë anën askujt dhe që nuk duhet të bëjnë propagandë me të shkuarën, sepse detyra e tyre ishte veçanërisht ajo e “rindërtimit”. Në këtë kuptim, në shekullin XIX, studiues të ndryshëm nga të gjitha vendet i lanë mënjanë veprat e dy shekujve të mëparshëm, që lidheshin me figurën e Kastriotit, të cilat ishin përzierje e gojëdhënave me dokumentet arkivorë, dhe iu përveshën burimeve origjinale të ruajtura në arkivat e Vatikanit, Venedikut, Raguzës dhe Stambollit. Zbulimi i këtyre dokumenteve bëri që jeta dhe vepra e Gjergj Kastriotit Skënderbeut të shihej nën një dritë tjetër. Në veprat e tyre voluminoze, disa prej këtyre studiuesve e përmendin Kastriotin kur bëjnë fjalë për periudhën gjatë së cilës osmanët sundonin Ballkanin, ndërsa të tjerët kanë shkruar biografi të gjata për Gjergj Kastriotin.
5. Në shkrimet filozofike dhe historike të shekullit XIX, Gjergj Kastrioti-Skënderbeu na shfaqet si një përfaqësues i absolutizmit iluminist. Ai paraqitet relativisht si një mbret filozof, i cili u ngrit mbi ndarjet që ekzistonin ndër arbërorët dhe ishte më shumë një mësues sesa një sundimtar tradicional. Kjo gjë ilustron shumë mirë me rëndësinë që i jepet faktit sesi në Kuvendin e Lezhës princat shqiptarë u bashkuan rreth Skënderbeut, në luftën kundër turqve. Po ashtu, po thuaj të gjithë autorët ngrenë lart aftësinë drejtuese të këtij strategu ushtarak, i cili, me një ushtri disa herë më të vogël në numër, për 25 vjet u bëri ballë ushtrive të Muratit dhe Mehmetit II, dhe që me pragmatizmin e tij arrinte t’i mbulonte mjaft mirë vështirësitë financiare dhe

mungesat në ushtarë, nëpërmjet marrëdhënieve me Vatikanin, Republikën e Venedikut dhe Mbretërinë e Napolit, duke u shfaqur edhe si një diplomat i shkëlqyer.

6. Në shekullin XIX, të mbiquajtur shekulli i “revolucioneve kombëtare”, lartësimi i figurës së Gjergj Kastriotit dhe i rolit të tij si mburoja e Evropës në luftën kundër Perandorisë Osmane, do të shërbente si nxitje për ndërgjegjësimin e shqiptarëve, në lidhje me identitetin e tyre, si dhe në orvatjet e tyre për t’u organizuar, me qëllim që të luftonin për të arritur pavarësinë nga Turqia osmane, asht siç kishin bërë popuj të tjerë në Ballkan.

## CONCLUSIONS

1. What can be deduced from the way nineteenth-century historiography treats George Castriota Scanderbeg, is the fact that not only in his time, but also after his death, he has been the point of reference for free peoples, who have treasured by his genius during the long road of history. His figure was not only an inspiration for the Albanians, but also for other peoples who fought for national and spiritual liberation from the Turkish rule.
2. Although not all authors have a totally enthusiastic attitude towards Scanderbeg, sometimes unjustifiable, since their attitude was based on the moral principles of the eighteenth century, avoiding the fact that three centuries before there was an uncompromising struggle between the concept of morality and that of human relations, fundamentally two incompatible concepts, we note that even those who have used a critical sense of the particular aspects of his life and activities have been ultimately reluctant to accept his contribution to the defence of national independence, which invalidates the criticisms, because in any case the means are justified by the intention to save his people from the yoke of the invaders.
3. The activity of the Albanian national hero is likely to have inspired Lord Byron, who later wrote “Childe Harold’s Pilgrimage” (1812-1819), where he mentioned Albania and Skanderbeg, as well as Benjamin Disraeli who in 1833 he would write the short story “Skanderbeg’s Rise”, a proof that the work of the Albanian hero was seen with great interest also by the upper classes of British society. All this thanks to the writing of Edward Gibbon “The History of the Decline and Fall of the Roman Empire”, which not only created a standard in history writing, but also made it possible for Skanderbeg’s figure to become popular and known to the different strata of British society.
4. In the 19<sup>th</sup> century historians were promoters of an intellectual and



professional transformation. Their intellectual positioning was intensified by the tendency to write history without emotions and objectively, given the fact that historians do not hold anyone's side and should not propagate with the past, because their task was especially that of "reconstruction". In this sense, nineteenth's century scholars from all over the world set aside the works of the previous two centuries related to the figure of Castriota, which were a mixture between legend and archival documents, and turned to the original sources preserved in archives of the Vatican, Venice, Ragusa and Istanbul. The discovery of these documents made possible that George Castriota Skanderbeg's life and work to be seen under another light. In their voluminous works, some of these scholars mentioned Castriota when they wrote about the period of Ottoman rule in the Balkans, while others have written a long biography of George Castriota.

5. In the philosophical and historical writings of the nineteenth century, George Castriota Skanderbeg appears to us as a representative of the enlightened absolutism. He seems relatively similar to a philosopher king, who rose up above the divisions that existed among the Albanians and was more a teacher than a traditional ruler. This is very well illustrated by the importance given to the fact that during the League of Lezha the Albanian princes joined Skanderbeg in their intent to fight against the Turks. Likewise, all the authors underline the leadership ability of this military strategist who for 25 years, commanding a much smaller army, opposed the armies of Murad and Mehmed II. With his pragmatism, he managed to cover the financial difficulties and the shortage of the soldiers well enough, through his relations with the Vatican, the Republic of Venice and the Kingdom of Naples, manifesting himself as an excellent diplomat. Likewise, all the authors underline the leadership ability of this military strategist who for 25 years, commanding a much smaller army, opposed the armies of Murad and Mehmed II. With his pragmatism, he managed to cover well enough the financial difficulties and the shortage of the soldiers, through his relations with the Vatican, the Republic of Venice and the Kingdom of Naples, manifesting himself as an excellent diplomat.
6. In the nineteenth century, dubbed the century of "national revolutions", the glorification of the figure of George Castriota and his role as a shield for Europe in the struggle against the Ottoman Empire served as an incentive for the awareness of the identity of the Albanians, as well as in their attempts to get organized in order to obtain independence from Ottoman Turkey, as the other peoples of the Balkans did.

**Prof. As. Dr. Esilda LUKU<sup>1</sup>**

## **KËNDVËSHTRIME MBI FIGURËN E GJERGJ KASTRIOTIT – SKËNDERBEUT NË MONOGRAFINË E HISTORIANIT OLIVER JENS SCHMITT**

### **Abstrakt**

Punimi ka për qëllim të analizojë pikëpamjet e prezantuara nga historiani O. J. Schmitt në monografinë e tij mbi periudhën çerekshekullore të luftërave të Skënderbeut kundër sulltanëve osmane. Ai synon t'i japë përgjigje disa çështjeve të ngritura në komunitetin e historianëve shqiptare mbi interpretimet e Schmitt-it për përdorimin e onomastikës sllave kur i referohet babait dhe të birit të Skënderbeut; motivin personal të kryengritjes; ngjyresën fetare të luftërave; ekzistencën ose jo të një strukture shtetërore në periudhën e Kastriotit, si dhe qëndrimin pro apo kundër mitizimit të Skënderbeut. Bazuar në metodën historike deskriptive dhe atë të analizës kritike, punimi synon të paraqesë figurën e Skënderbeut dhe veprimtarinë e tij politike dhe ushtarake në optikën e Schmitt-it.

**Fjalë kyçe:** Skënderbeu, anatomia e kryengritjeve, figurë historike apo mit, risi faktologjike.

### **Hyrje**

Fondit të pasur të literaturës historiografike vendase dhe të huaj mbi personalitetin e rëndësishëm të historisë kombëtare të shqiptarëve, Gjergj Kastriotit – Skënderbeut, i shtohet edhe botimi i monografisë me titull: “Skënderbeu” i historianit Oliver Jens Schmitt, aktualisht në detyrën e Presidentit të Sektorit të Shkencave Humane dhe Sociale dhe njëkohësisht anëtar i Kryesisë së Akademisë Austriake të Shkencave.<sup>2</sup> Vepra u shqipërua nga Ardian Klosi dhe

---

<sup>1</sup> Fakulteti i Shkencave Politike-Juridike, Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës

<sup>2</sup> Ben Andoni, “Oliver Jens Schmitt: Kurrë nuk shkrova se Skënderbeu është me origjinë të pastër serbe”, *Gazeta Shqiptare*, 4.02.2018, <http://www.gsh.al/2018/02/04/ekskluzive-oliver->

u publikua nga shtëpia botuese “K&B”, më 2008, me mbështetjen financiare të Agjencisë Zviceriane për Zhvillim dhe Bashkëpunim, duke i paraprirë botimit origjinal në gjuhën gjermane.<sup>3</sup>

Për shkrimin e biografisë së Skënderbeut, autori ndjek shembullin e librit të R.R.Davies mbi heroin kombëtar të Uellsit, Owain Glyn Dŵr, që luftoi kundër kurorës angleze rreth viteve 1400. Historitë e dy heronjve i bashkon lufta kundër një fuqie superiore, përçarja e brendshme politike, roli i institucioneve kishtarë, taktikat e luftës guerrile që shfrytëzon relievin dhe kushtet klimaterike, ndërkombëtarizimi i konflikteve falë kërkesave për ndihmë, udhëheqja nga liderë karizmatikë që u fetishizuan që kur ishin gjallë dhe janë pjesë e memories kolektive disashekullore.<sup>4</sup> Duke marrë si pikë referimi këtë vepër, historiani O. J. Schmitt e organizon monografinë e tij mbi Skënderbeun në pesë pjesë, që përfshin një analizë shumëpërmasore të figurës së Gjergj Kastriotit, duke nisur me prejardhjen, vitet e fëmijërisë e të rinisë dhe karrierën e tij ushtarake; për të vijuar me anatominë e kryengritjeve, angazhimin e tij në skenën politike të Italisë së Rilindjes dhe bilancin e luftës totale; si dhe për të përfunduar me fama perennis (famën e përjetshme, E. L) që la lufta e tij 25-vjeçare dhe një analizë së bibliografisë kryesore të shfrytëzuar.

Monografia voluminoze prej 583 faqesh e historianit O. J. Schmitt është fryt i një pune kërkimore disavjeçare në arkivat europiane dhe osmane, si dhe i analizës shkencore të burimeve sekondare të dijetarëve të njohur, duke filluar nga klasikët e medievalistikës së Arbërisë nga ish-Perandoria Austro-Hungareze, si: Konstantin Jireček, Ludvig von Thalloczy, Milan von Šufflay; për të vazhduar me historianin e Mehmetit II, Franz Babinger; rumunët Constantin Marinescu dhe Francisc Pall; albanologun italian Giuseppe Valentini; hulumtuesit serbë të shek.XV Ivan Božić dhe Momčilo Spremić e deri tek osmanistët Halil Inalcik, Selami Pulaha, Hasan Kaleshi, Ferid Duka, Dritan Egro etj.<sup>5</sup>

## Metodologjia

Punimi bazohet në metodën historike deskriptive, që synon të paraqesë në mënyrë sa më objektive përmbajtjen e monografisë “Skënderbeu” të historianit O. J. Schmitt, duke përshkruar argumentet kryesore që përdor autori për t’iu

---

[jens-schmitt-kurre-nuk-shkrova-se-skenderbeu-eshte-origjine-te-paster-serbe/](#)

<sup>3</sup> Michael Schmidt-Neke, “Robër të Skënderbeut: mbi debatin rreth Heroit Kombëtar shqiptar”, *Përpjekja* 28-29, Tiranë, pranverë-vjeshtë 2012, f. 8

<sup>4</sup> Oliver Jens Schmitt. *Skënderbeu*. Tiranë: K&B, 2009, f. 535

<sup>5</sup> O. J. Schmitt, *op.cit.*, f. 537-538

përgjigjur hipotezave të ngritura. Gjithashtu, ai mbështet në analizën kritike të veprës në lidhje me respektimin e kriterëve shkencorë historike, qasjen krahasuese në raport me botimet e tjera për të njëjtën tematikë, si dhe prezantimin e risive dhe çështjeve të debatuar në komunitetin e historianëve dhe opinionin e gjerë publik.

## Pikëpamje të debatueshme mbi veprën “Skënderbeu” të Schmitt

### *a) Përdorimi i emrit Ivan për të atin dhe të birin e Skënderbeut*

Biografinë e tij mbi Skënderbeun, autori, e nis me përshkrimin e preardhjes nga Dibra të familjes Kastrioti, një tezë e pranuar gjerësisht nga shkenca historiografike shqiptare.<sup>6</sup> Jo vetëm në prezantimin e trugut gjenealogjik, por edhe të zotërimeve, aktivitetit luftarak dhe veprimtarisë ekonomike të të atit të Skënderbeut, historiani Schmitt, në shumicën e rasteve, përdor në vend të emrit “Gjon” trajtën sllave “Ivan”, duke e argumentuar me dominimin e këtij versioni në burimet arkivore të hulumtuara. Emrin “Ivan” autori e përdor edhe kur i drejtohet të birit të Skënderbeut. Në intervistën dhënë për revistën “Përpyekja”, nr. 28-29, më 2012, Oliver J. Schmitt arsyeton se emri në mesjetë nuk identifikon përkatësinë etnike dhe gjuhësore, por mund të diktojë influencat kulturore mbizotëruese për kohën, si ajo latine dhe sllavo-bizantine.<sup>7</sup> Duke përkrahur arsyetimin e autorit që emri Ivan nuk nënkupton detyrimisht origjinën serbe të babait të Skënderbeut, e konsiderojmë të domosdoshme zbatimin e një standardi gjuhësor të unifikuar në lidhje me onomastikën e përdorur në tekst, pavarësisht larmisë së dokumentacionit të shfrytëzuar.

### *b) Motivi i hakmarrjes për fillimin e kryengritjes së vitit 1443*

Pas lajmit për vrasjen e të atit, Skënderbeu “do të mendonte për hakmarrje. Po të kemi parasysh se e drejta zakonore e arbërve gjëllonte qysh në mesjetë, ai s’kishte tjetër rrugë përveç se të ruante nderin e tij. I duhej të merrte gjak nga ajo familje që kishte derdhur gjak: kjo ishte dera e Osmanëve”.<sup>8</sup> Kështu e shpjegon autori i monografisë zanafillën e kryengritjes antiosmane të vjeshtës 1443. Një arsyetim i tillë bazuar kryesisht në motivin personal të gjakmarrjes ngjalli reagimin kundërshtues të historianit Kristo Frashëri, që i atribuon luftrave të

<sup>6</sup> Fatos Daçi, “Dibrani Gjergj Kastrioti nuk mund të jetë një serb. Simbioza e shoqërisë pa standard”, 23.1.2009, [http://www.zemrashqiptare.net/news/id\\_6538/Fatos-Daci:-Dibrani-Gjergji-Kastrioti-nuk-mund-t%C3%AB-jet%C3%AB-nj%C3%AB-serb.html](http://www.zemrashqiptare.net/news/id_6538/Fatos-Daci:-Dibrani-Gjergji-Kastrioti-nuk-mund-t%C3%AB-jet%C3%AB-nj%C3%AB-serb.html)

<sup>7</sup> “Skënderbeu i kërkimit shkencor”, Intervistë me Oliver Jens Schmitt, *Përpyekja* 28-29, Tiranë, pranverë-vjeshtë 2012, f. 54

<sup>8</sup> O. J. Schmitt, *op.cit.*, f. 58

Skënderbeut dhe pasuesve të tij qëllime patriotike.<sup>9</sup> Për të sqaruar komunitetin e studiuesve dhe opinionin publik, Oliver J. Schmitt thekson se urrejta personale ishte vetëm motivacioni fillestar i kryengritjes, e cila ishte rrjedhojë e një kombinimi të ndërlikuar faktorësh, si: ruajtja e autonomisë lokale, rezistenca kundër sistemit fiskal dhe drejtësisë osmane.<sup>10</sup> Ndërsa, studiuesi Artan Puto shton se motivi personal mund të shërbejë për shpërthimin e një rebelimi, por ai nuk duhet ngatërruar me luftën për sundim vetjak dhe përpjekjet për ruajtjen e tij që karakterizoi fushatat ushtarake çerekshekullore të Skënderbeut.<sup>11</sup>

*c) Ngjyresa fetare e luftërave të Skënderbeut*

Në dallim nga qëndrimi zyrtar i historiografisë shqiptare se Skënderbeu dhe ndjekësit e tij luftuan për lirinë e atdheut të tyre kundër invazionit osman, duke shërbyer si mburojë edhe për qytetërimin evropian,<sup>12</sup> autori i monografisë, Schmitt, analizon nga perspektiva të ndryshme karakterin fetar të kryengritjeve të udhëhequra nga Skënderbeu. Sipas tij, përqafimi i besimit kristian nga prijësi i kryengritjes dhe konvertimi masiv i renegatëve në të krishterë është një sinjal i fortë i dallimit dhe i rezistencës kundër një perandorie që e lidhnin me fenë islame.<sup>13</sup> E tillë është edhe zgjedhja si emblemë e shqiponjës dykrenare, simbol i Perandorisë Bizantine dhe i kishës ortodokse, çka dëshmon për kujtesën e sundimit të krishterë kundër atij të sulltanit.<sup>14</sup> Gjithashtu, aktiviteti politik i Skënderbeut në dekadën e fundit u dominua nga retorika e krishterë, që ishte rezultat jo vetëm i ndikimit të këshilltarëve të tij, klerikëve katolikë nga Drishti dhe nga Durrësi, por edhe i marrëdhënieve miqësore që kishte veçanërisht me Papa Kaliksin III dhe Piu II.<sup>15</sup> Nga ana tjetër, diskursi politik i vendeve katolike anë Adriatikut, si: Dubrovniku e Napoli, dhe sidomos ligjërimi i Papatit krijoi përshtypjen se Skënderbeu përfaqësonte luftëtarin mbrojtës të Krishtërit. Konkretisht, më 11 shtator 1457, kancelaria papnore harton një letër në të cilën

<sup>9</sup> Kristo Frashëri. *Skënderbeu i shpërfytyruar nga një historian zvicerian dhe disa analistë shqiptarë*. Tiranë: Dudaj, 2009, f. 67

<sup>10</sup> Ben Andoni, “Studimi i tij për Skënderbeun ngjalli reagime/ Historiani flet për kërcënimet: Trashëgimia helmuese e kohës së Enverit ruan ende ndikim te njerëzit” *Panorama*, 4.2.2018, <http://www.panorama.com.al/studimi-i-tij-per-skenderbeun-ngjalli-reagime-historiani-flet-per-kercenimet-trashegimia-helmuese-e-kohes-se-enverit-ruan-ende-ndikim-te-for-te-njerezit8/>

<sup>11</sup> Artan Puto, “Nga Skënderbeu mitik në atë historik”, *Përpjekja* 28-29, Tiranë, pranverë-vjeshtë 2012, f. 21

<sup>12</sup> Akademia e Shkencave e Shqipërisë. Instituti i Historisë. *Historia e popullit shqiptar, vëll. 1*. Tiranë: Toena, 2002, f. 483-485

<sup>13</sup> O. J. Schmitt, *op.cit.*, f. 80

<sup>14</sup> *Ibid.*, f. 128

<sup>15</sup> *Ibid.*, f. 460

evidenton aftësitë ushtarake të Skënderbeut dhe kontributin e tij për fenë, si vijon: “Po dëgjojmë se je shquar mbi gjithë sundimtarët katolikë falë zotësisë tënde të lartë dhe veprave që ke kryer për besimin e krishterë dhe për fenë. Ji përherë trim dhe mos u jep. ... Askush nuk mund të jetë aq i paditur saqë të mos të ngrejë lart me lavdërimet më të mëdha e të mos flasë për fisnikërinë tënde si për atë të një atleti e një luftëtari të emrit të krishterë”.<sup>16</sup> Kështu, sipas O. J. Schmitt, imazhi i kalorësit të pamposhtur dhe atlet i Krishtit i krijuar për Skënderbeun nga Kaliksi III dhe Piu II përputhen në një masë të madhe me botëkuptimin kristian të prijësit dhe kryengritësve shqiptarë.

*ç) Strukturë shtetërore apo hapësirë veprimi*

Në librin “Historia e shtetit dhe e së drejtës në Shqipëri” botuar nga një grup autorësh të fushës së jurisprudencës, më 2005, flitet për shtetin e përqendruar shqiptar nën udhëheqjen e Skënderbeut dhe organizimin e pushtetit qendror dhe lokal; ekzistencën e legjislacionit me në bazë të drejtën zakonore; sistemin financiar, ushtrinë e përhershme, kancelarinë, organet e punëve të jashtme, si dhe flamurin, stemën dhe vulën zyrtare të Skënderbeut.<sup>17</sup> Ndërsa, historiani Schmitt argumenton se sundimi i Skënderbeut ushtrohej në radhë të parë mbi njerëzit se sa mbi një territor me kufij të përcaktuar qartë. Hapësira nën kontrollin e tij zgjerohej apo ngushtohej në varësi të rezultatit të luftimeve kundër ushtrisë osmane, si dhe përfshirjes në konfliktet midis shteteve italiane. Ndaj “Kastrioti nuk ndërtoi ndonjë shtet me struktura të ngulitura administrative, por një sistem të lëvizshëm e të zhdërvjellët pushteti, i cili u përshtatej kërkesave të kohës me ndryshimet e veta të gjendjes ushtarake”.<sup>18</sup>

*d) Debati mbi nevojën ose jo të çmitizimit të Skënderbeut*

Disa historianë, shkrimtarë dhe publicistë kritikojnë autorin e monografisë, Oliver J. Schmitt, për përpjekjet e tij për çmitizimin e Skënderbeut nga historiografia shqiptare. Këta kritikë mbështesin shkollën e mitologjisë së cilës i përket edhe studiuesi George Schopflin, të cilët e konsiderojnë mitin një aspekt të pashmangshëm të përvojës kolektive.<sup>19</sup> Sipas tyre, miti nënkupton tërësinë e ideve me përmbajtje morale që përcillet brez pas brezi në formë tregimi, bazuar ose jo në një të vërtetë historike, ndonëse ata që e transmetojnë e vlerësojnë si të tillë. Përgjithësisht miti është formë e organizimit të një periudhe historike në mënyrë që ajo të ketë kuptim për një komunitet të caktuar. Ndaj tentativat

<sup>16</sup> *Ibid.*, f. 329-330

<sup>17</sup> *Historia e shtetit dhe e së drejtës në Shqipëri*. Tiranë: Luarasi, 2005, f. 129-190

<sup>18</sup> O. J. Schmitt, *op.cit.*, f. 139

<sup>19</sup> Stephanie Schwandner-Sievers, “Narratives of Power, capacities of myth in Albania”, *Albanian Identities: Myth and History*, ed. by S. Schwandner-Sievers, Indiana Univ. Press, 2002, p. 4

për të çmontuar një mit vështirë se mund të kuptohen nga komuniteti si një hap pozitiv për të dalluar të pavërtetën. Komuniteti nuk do të reflektojë ndryshime në mënyrën e sjelljes dhe të jetesës; madje, sulmin ndaj mitit do ta etiketojë si një kërcënim për vetë ekzistencën e bashkësisë, sepse miti ngulit idenë e një bashkësie të qëndrueshme dhe të vazhdimësisë në të ardhmen. Ai ndikon në krijimin e identitetit, ruajtjen e kohezionit social, ushtrimin e pushtetit etj.<sup>20</sup>

Në intervistën e tij për suplementin “Milosao” të gazetës “Panorama”, botuar më 04.02.2018, historiani Schmitt sqaron se synimi i librit të tij është rindërtimi i figurës së Skënderbeut në Mesjetë dhe jo dekonstruktimi i mitit historik, ndonëse e konsideron me vlerë debatin e rihapur për mitet kombëtare, me qëllim forcimin e kulturës demokratike në Shqipëri.<sup>21</sup> Autori shkruan në monografinë e tij se imazhi i ndërtuar për Skënderbeun si hero kombëtar shpesh nuk përkon me figurën e vërtetë historike. Megjithatë, shoqëritë kanë nevojë për heronj dhe i krijojnë ata më shumë që t’i shërbejnë dëshirave dhe idealeve të tyre se sa bazuar në atë që dëshmohet përmes burimeve historike dhe kërkimit shkencor. Schmitt i referohet studiuesit R.R.Davies kur përmend dallimin e madh midis perceptimit të historisë nga shoqëria dhe njohjes së saj nga historianët, duke shtuar se gjithë dituritë e historianëve shpesh nuk mjaftojnë për të ndryshuar imazhet e rrënjosura thellë në memorien kolektive. Por, sipas autorit, është detyrë e shkencës që të hulumtojë se si lindi imazhi i heroit kombëtar, kushtet dhe arsyet e vijmësisë së ekzistencës së tij.<sup>22</sup> Këtë pikëpamje ndan edhe Fatos Lubonja kur analizon “se tjetër gjë është historia si shkencë dhe tjetër gjë janë konstruktet identitare, mitet e ndërtuara mbi historinë me frymën e një ideologjie të caktuar”<sup>23</sup>, dhe thekson nevojën për të kuptuar ndërtimin e mitit, që nuk nuk do të thotë detyrimisht dekonstruktim i tij. Sipas Lubonjës, çmontimi i mitit të Skënderbeut nuk përkon me njohjen e historisë së shek. XV, por me të kuptuarit e procesit identitet ndërtues në shek. XIX, që e nxori Skënderbeun nga historia dhe e ktheu në mit e simbol. Një proces i tillë i shërben frymës së kohës në të cilën jetojmë.<sup>24</sup>

<sup>20</sup> George Schopflin, “Natyra e mitit: disa aspekte teorike”, *Përpyekja 15-16*, Tiranë, janar-dhjetor 1999, f. 9

<sup>21</sup> B. Andoni, “Studimi i tij për Skënderbeun ...”, <http://www.panorama.com.al/studimi-i-tij-per-skenderbeun-ngjalli-reagime-historiani-flet-per-kercenimet-trashegimia-helmuese-e-kohes-se-enverit-ruan-ende-ndikim-te-for-te-njerezit8/>

<sup>22</sup> O. J. Schmitt, *op.cit.*, f. 7-8

<sup>23</sup> Fatos Lubonja, “Nga Nacional-Komunizmi në Nacional-evropianizëm”, *Përpyekja 28-29*, Tiranë, pranverë-vjeshtë 2012, f. 31

<sup>24</sup> Fatos Lubonja, “Bëhu i ditur të jesh i lirë”, *Përpyekja 28-29*, Tiranë, pranverë-vjeshtë 2012, f. 26-28

Në veprën e tij, autori Schmitt analizon, nga perspektiva historike, trajektoren jo lineare që ndoqi miti i Skënderbeut. Sipas tij, Kastrioti u mbështoll nga legjenda qysh kur ishte gjallë dhe u bë i njohur për Perëndimin nga refugjatët arbër. Ndërsa në Europë, ai vlerësohej si simbol i kundërshtisë kristiane-islamike, kujtimi i tij u zbeh me përhapjen e fesë islame në Arbëri, me përjashtim të ruajtjes së paprekur të imazhit të tij në memorien e katolikëve të veriut. Pas vitit 1800, kur u zbeh rreziku osman për Perëndimin, ra interesi për Kastriotin në qytetërimin europian, por simboli i tij u rimor nga popujt e krishterë të Ballkanit, që synonin të çliroheshin nga zgjedha e sulltanit.<sup>25</sup> Vetëm në fund të shek. XIX, aktivistët e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare evokuan fuqishëm figurën e Skënderbeut, për të mobilizuar dhe bashkuar popullin, me synim çlirimin nga sundimi osman dhe themelimin e shtetit të pavarur.<sup>26</sup> Sipas O. Schmitt, rilindasit propaganduan një ndjenjë kombëtare shqiptare që qëndron mbi besimet fetare, e cila sintetizohet në shprehjen e Pashko Vasës “Feja e shqyptarit është Shqyptaria”, që pasqyrore një objektiv dhe jo realitetin shoqëror-kulturor të kohës. Në këtë këndvështrim, kryengritja e Skënderbeut kundër ushtrisë osmane u riinterpretua e zhveshur nga çdo ngjyresë fetare. Kjo i shërbente mitit të unitetit përtej feve që veprimtarët nacionalistë shqiptarë të periudhës së Rilindjes e përdorën për të kapërcyer ndarjet fetare midis shqiptarëve, por u huazua edhe nga monarkia zogiste për të krijuar shtetin laik, si dhe nga regjimi komunist i E. Hoxhës për të legjitimuar ateizmin.<sup>27</sup> Historiani Schmitt gjithashtu arsyeton se zgjedhja e Skënderbeut mishëronte vijimësinë kulturore dhe sidomos orientimin kah Perëndimi të shqiptarëve me shumicë myslimane. Rizbulimi i Kastriotit u përdor për të sinjalizuar rikthimin në Europë të shqiptarëve të shkëputur nga sundimi pesëshekullor osman. Kështu, Skënderbeu u prezantua si mbrojtës i qytetërimit europian, që luftoi për shpëtimin e Renesancës Italiane. Atij i vishet miti i sakrifikimit për Europën, e cila duhej t’ia shpërblej me mbështetje politike.

Nga ana tjetër, përdorimi në mënyrë selektive dhe manipulimi i miteve dhe i kujtesës historike në periudhën e shtetit shqiptar shërbeu si instrument për legjitimimin e politikave dhe pushtetit të udhëheqësve.<sup>28</sup> Figura e Skënderbeut shihej si pararendës dhe legjitimues i diktaturës autoritare mbretërore të Ahmet Zogut, dhe u plotësua me dimensione të reja si pasojë e ndryshimeve në orientimin e regjimit komunist të Hoxhës. Në sistemin monopartiak, imazhi i

<sup>25</sup> O. J. Schmitt, *op.cit.*, f. 423

<sup>26</sup> Ferit Duka, “Historiografia, miti dhe politika”, *Politika dhe Historia*, Tiranë: UET, 2012, f. 213-214

<sup>27</sup> A. Puto, *op.cit.*, f. 19

<sup>28</sup> Piro Misha, “Fenomeni nacionalizëm dhe kriza shqiptare”, *Përpyekja 15-16*, Tiranë, janar-dhjetor 1999, f. 27



Skënderbeut u riformësua jo vetëm si revolucionar shoqëror dhe udhëheqës i masave, por u kthye në simbol të vetizolimit të Shqipërisë përballë sulmeve të imperializmit dhe revizionizmit. Ndërsa, tranzicioni demokratik e interpretoi Kastriotin si pararendës të Europës së bashkuar të krishterë, duke theksuar tezën e përkatësisë europiane të popullit shqiptar.<sup>29</sup>

## **Risitë e monografisë “Skënderbeu” të historianit O. J. Schmitt**

*1) Mungesa e dominimit të paradigmës militare në trajtimin e periudhës së Skënderbeut*

Në biografinë e tij mbi Skënderbeun, historiani Schmitt i shmanget mbizotërimit të paradigmës militare në përshkrimin e luftërave 25-vjeçare kundër pushtimit osman, në atë masë që ngjarje të caktuara në fushën e betejës të glorifikohen aq sa të kthehen në instrumente për shpjegim racional.<sup>30</sup> Autori e analizon konfliktin 25-vjeçar të Skënderbeut kundër sulltanëve osmanë në mënyrë shterruese dhe gjithëpërfshirëse. Ai mbështetet në analizën e detajuar të shtrirjes gjeografike të kryengritjeve, forcave shoqërore pjesëmarrëse, strategjisë politike dhe ushtarake, bilancit të luftës njëçerekshekullore.

Sipas O. J. Schmitt, kryengritja e Skënderbeut e fragmentarizoi hapësirën midis Adriatikut dhe maleve të Pologut në përkrahës dhe kundërshtarë të rendit osman në Ballkan. Kryengritësit kontrollonin një hapësirë të ngushtë territoriale përreth Krujës, në luginën e Matit dhe në Dibër si dhe në pjesën veriore të Arbërisë së mesme, në brendatokën e Durrësit dhe përgjatë lumit të Shkumbinit.<sup>31</sup> Pasuesit e Skënderbeut ishin: së pari, të rinj nga radhët e familjeve fisnike që kishin humbur pushtet ose që rrezikoheshin direkt nga sundimi osman; së dyti, fshatarë dhe barinj që largoheshin nga zonat e tyre të varfra për ekspedita grabitëse në ultësirat e pasura dhe së treti, priftërinj ortodoksë të fshatrave të Krujës, Matit e Dibrës, si dhe klerikë katolikë të Arbërisë së mesme dhe veriore që ndihmuan Skënderbeun të bëhej pjesë e qarqeve politike të Europës së Rilindjes. Ndërsa banorët e qyteteve dhe paritë e fshatrave, me qëllim që të ruanin të pandryshuar pozitën e tyre social-ekonomike, refuzuan fisnikërinë vendase duke pranuar administratën venedikase dhe atë osmane. Shpura e Skënderbeut numëronte rreth 2000-3000 veta, të cilët i shpërblente me plaçkë, të ardhurat nga aktiviteti tregtar dhe ndihmën në të holla nga Italia. Megjithatë, ajo nuk përfaqësonte një

<sup>29</sup> O. J. Schmitt, *op.cit.*, f. 444-453

<sup>30</sup> Emilija Simoska, “General problems in the History textbooks of the Balkans”, *Teaching the History of Southeastern Europe*, Center for Democracy and Reconciliation in southeast Europe, Thessaloniki, 2001, f. 99

<sup>31</sup> O. J. Schmitt, *op.cit.*, f. 457-458

bashkësi homogjene dhe stabile, veçanërisht për shkak të rivalitetit në gjirin e aleatëve fisnikë që kërkonin të ruanin sundimin në zotërimet e tyre.<sup>32</sup>

Po ashtu, historiani Schmitt argumenton se lufta e Skënderbeut nuk kishte karakter njëpërmasor. Ajo u karakterizua jo vetëm nga konflikti kundër ushtrisë osmane, por edhe nga përlasja me fisnikët vendas dhe me qytetarët e Arbërisë veriore për kullota e arra. Për më tepër, Skënderbeu u përfshi edhe në rivalitetin mes Republikës së Shën Markut dhe Napolit për hegjemoni në Adriatik. Ai nënshkroi Traktatin e Gaetës me mbretin Alfons V të Napolit, më 26 mars 1451, dhe u angazhua në luftën kundër Venedikut. Armiqësia me Signorian që arriti të mënjanonte napolitanët nga Arbëria e mesme, më 1467, i dha një goditje prijësit të kryengritjes.<sup>33</sup>

Ndonëse, ekzistonte një disproporcion i madh midis ushtrisë së sulltanit dhe trupës së vogël të luftëtarëve fshatarë dhe blegtorë arbër, kjo nuk e pengoi Skënderbeun të zgjidhte ofensivën si strategji ushtarake, duke shmangur sa më shumë pozitat mbrojtëse. Sulmet e shpurës së tij më 1444, më 1448 dhe më 1464 kundër ushtrisë osmane dështuan, për arsye të mos harmonizimit në kohë të trupave aleate nga Europa dhe Azia e Vogël.<sup>34</sup> Edhe betejat e suksesshme, si mbrojtja e Krujës gjatë rrethimit të parë (korrik – tetor 1450) u shoqërua me shkatërrime të mëdha dhe cilësohet një fitore si e Pirros. Gjithashtu, tërheqja e forcave osmane para Danjës, më 23 mars 1466, nuk kaloi pa shkretuar vendin rreth e rrotull. Madje, ajo u pasua nga fenomeni i emigracionit masiv të arbërve drejt brigjeve të Italisë së Jugut, aq sa përfaqësuesi milanez në Venedik shkruante, më 8 maj 1466, se “krejt Arbëria po arratiset drejt Puljes me gjithë familje e katandi”. Po ashtu, sipas autorit O. J. Schmitt, një pjesë e popullsisë arbëre u vendos në zona të thella malore, si masë mbrojtëse ndaj sulmeve osmane nën sulltan Mehmetin II, duke kontribuar në forcimin e shoqërisë fisnore.<sup>35</sup> Në këtë këndvështrim, luftërat 25-vjeçare të Skënderbeut shënonin një varg fitoresh dhe humbjesh të rënda, ku pasojat më të mëdha i pagoi me jetë dhe me rrënim ekonomik në radhë të parë fshatarësia.<sup>36</sup> Një pikëpamje e tillë që ngarkon me përgjegjësi strategjinë ushtarake të Skënderbeut për shkatërrimin e vendit kundërshtohet nga Prof. Kristo Frashëri, me argumentin se lufta e Kastriotit kishte karakter mbrojtës dhe jo pushtues njësoj si Janosh Huniadi dhe Jan Sobjeksi, të cilët në rezistencën e tyre kundër invazionit osman nuk mund të shmangnin humbjet njerëzore dhe

<sup>32</sup> *Ibid.*, f. 463

<sup>33</sup> O. J. Schmitt, *op.cit.*, f. 464

<sup>34</sup> *Ibid.*, f. 470

<sup>35</sup> *Ibid.*, f. 377-378

<sup>36</sup> M. Schmidt-Neke, *op.cit.*, f. 9

shkatërrimet materiale.<sup>37</sup> Në fakt, historiani Schmitt në monografinë e tij nuk kufizohet vetëm në narrativën politike dhe militare të periudhës së Skënderbeut që dominon në historiografinë shqiptare, por përpiket të paraqesë edhe historinë ekonomike të Arbërisë në Mesjetë.

2) *Devijimi nga qasja autoreferenciale në analizën e figurës së Skënderbeut*

Historiani O. J. Schmitt e trajton personalitetin e Skënderbeut në përputhje me kontekstin politik, ekonomik e social të kohës. Autori mënjanohet nga rrëfimi autoreferencial, që e paraqet Skënderbeun si aktorin kryesor të ngjarjeve, por e sheh atë si një produkt të konjunkturës politike rajonale dhe europiane. Ai i kushton vëmendje marrëdhënieve të prijësit me shtetet italiane, raportit me sulltanin, sistemit të aleancave, vasalitetit etj. Schmitt thekson aftësitë politike të Skënderbeut që duke njohur situatën e vështirë ekonomike-shoqërore në viset e kontrolluara prej tij dhe rrezikun eminent të një sulmi të ri osman nënshkroi marrëveshjen me mbretin Alfons V të Napolit, në mars 1451, që e vendosi Skënderbeun në pozitën e vasalit. Sipas studiuesit Artan Puto, i ashtuquajtur i “status inferior i Skënderbeut” ndaj shteteve italiane tregon përpjekjet për mbijetesë të një sundimtari të vogël arbër nëpërmjet aleancave rrethimore afatgjata, i ndërgjegjshëm për mjetet e kufizuara ushtarake që dispononte përballë makinës luftarake osmane.<sup>38</sup>

Autori i monografisë trajton edhe marrëdhënien delikate të sulltanëve me Skënderbeun që karakterizohet sa nga besimi i ngritur fale bashkëjetesës disavjeçare brenda sistemit shtetëror osman, aq edhe nga interesat kontradiktore, të luftës për ekzistencë të Kastriotit dhe etjes për fitore të osmanëve. Për sulltan Muratin II dhe të birin e tij, Mehmetin II, Skënderbeu ishte një kundërshtar i veçantë që duhej, ose të likujdohej sepse modeli i tij mund të tundonte princat e tjerë të krishterë që shërbenin tek osmanët, ose të përfshihej në gjirin e tyre duke u bërë kreu i një principate vasale, si fqinji i tij Gjergj Brankoviq. Kastrioti e refuzoi një propozim të tillë edhe pse herë pas here detyrohej t’i paguante haraç sulltanit. Ai u vlerësua lart për qëndrimin e tij të palëkundur pavarësisht dhuratave dhe premtimeve të shumta të osmanëve.<sup>39</sup>

Logjikën jo autoreferenciale të analizës, historiani Schmitt e ndjek po ashtu kur trajton fundin e luftës njëçerekshekullore të Skënderbeut. Ai arsyeton se disfata e thellë e Kastriotit ishte rrjedhojë jo vetëm e fuqisë ushtarake të sulltanit dhe e akteve të tradhtisë e përçarjes në radhët e fisnikërisë arbëre, por edhe i

<sup>37</sup> K. Frashëri, *op.cit.*, f. 17

<sup>38</sup> A. Puto, *op.cit.*, f. 21-22

<sup>39</sup> O. J. Schmitt, *op.cit.*, f. 227-234

varësisë së tij prej politikës së Papatit, Napolit dhe Venedikut.<sup>40</sup>

### 3) *Analizë e figurës historike të Skënderbeut, larg mitizimit*

Autori Schmitt thekson se qëllimi i veprës së tij është rindërtimi i figurës së heroit kombëtar të shqiptarëve në mesjetë.<sup>41</sup> Për të kuptuar zgjatjen 25-vjeçare të kryengritjes së të krishterëve, duhet analizuar karakteri dhe vepra e Skënderbeut. Ai u dallua për trimërinë dhe guximin vetjak, dinakërinë dhe shkathësinë e veçantë, ndjenjën e krenarisë në marrëdhënie me sulltanin dhe me fqinjët e Adriatikut. Kastrioti u shqua si udhëheqës karizmatik, që u ofronte besueshmëri të lartë ndjekësve të tij; zotëronte disa gjuhë të huaja, si dhe u falte besnikëri të pakushtëzuar aleatëve të tij. I tillë ishte raporti me derën e Aragonëve, ku luajjaliteti i kapërcente kufijtë e Traktatit të Gaetës (1451). Skënderbeu vijoi t'i qëndronte besnik edhe të birit të Alfonsit V, mbretit Ferrante të Napolit. Për të dëshmuar këtë tipar të personalitetit të Kastriotit, historiani Schmitt i referohet një teksti të një diplomati milanez. Sipas tij, kur Skënderbeu ndodhej në Itali më 1461, ai takon një aristokrat italian në një fushë të hapur dhe përpiqet ta bindë të ndalë tradhtinë ndaj mbretit Ferrante. Meqënëse aristokrati refuzon në mënyrë të përsëritur, Skënderbeu e zë rob dhe e dërgon në kampin e mbretit.<sup>42</sup>

Përpos ndjenjës së besnikërisë, autori ndalet në monografinë e tij tek shqyrtimi i përkatësisë fetare të Kastriotit. I lindur si i krishterë ortodoks, i konvertuar në mysliman nga dervishët; më 1443, Skënderbeu u kthye në fenë e të parëve. Gjatë fazës së parë të kryengritjes, ai adaptoi simbolin ortodoks të shqiponjës dykrenare, ndërsa pas vitit 1450, Kastrioti u afrua me botën katolike nisur nga kërkesa për ndihmë prej kishës romane dhe vasalitetit napolitan.<sup>43</sup>

Për bashkëkohësit, Skënderbeu mishëronte idealin heroik të banorëve të malësisë. Ai nuk shquhej vetëm për aftësitë e tij ushtarake, por edhe për mendimin e qartë strategjik në fushën e betejës. Kastriotin e favorizonte njohja e kundërshtarit, familjariteti me mentalitetin e pasuesve të vet dhe relievin e vendit. Ai personifikonte prijësin guerrilas ballkanik që konsideronte si aleatë besnikë klimën dhe natyrën. Skënderbeu me luftëtarët e tij u shmangej betejave në fushë dhe rrethimeve në kështjella për arsye të inferioritetit numerik dhe mungesës së armatimeve të rënda në krahasim me makinën ushtarake osmane.

<sup>40</sup> *Ibid.*, f. 383

<sup>41</sup> B. Andoni, "Oliver Jens Schmitt: Kurrë nuk shkrova se ...", <http://www.gsh.al/2018/02/04/ekskluzive-oliver-jens-schmitt-kurre-nuk-shkrova-se-skenderbeu-eshte-origjine-te-paster-serbe/>

<sup>42</sup> Erald Dushku, Selver Islamaj, "Skënderbeu", prezantim i tensionuar në Vjenë", *Panorama*, <http://shllapashtica.beepworld.de/oliver.htm>

<sup>43</sup> O. J. Schmitt, *op.cit.*, f. 471

Për klasën politike italiane të Rilindjes, me figurën e Skënderbeut lidhej karriera ekzotike e një princi që vihej në vijë të parë të luftës; zgjidhte forcën në vend të bisedimeve, drejtonte një shpurrë të zymtë, ku lufta ishte thjesht një përlëshje për mbijetesë. Në aspektin politik, rigjallërimi i historisë antike i shërbeu retorikës së Kastriotit, kur përmendte kontributin e dhënë nga Pirro i Epirit për fitoren e princit të Tarantos në luftë kundër romakëve në Italinë e Jugut. Duke e paraqitur veten si pasardhës të Aleksandrit të Madh dhe Pirros, kulti i antikitetit dominoi mendimin e tij humanist në periudhën e Rilindjes Italiane.<sup>44</sup>

Merita e Schmitt-it konsiston në kthimin e Skënderbeut në realitetin e tij historik.<sup>45</sup> Sipas autorit, jeta e Kastriotit nuk ishte një marshim triumfal, por një luftë e vazhdueshmë për ekzistencë, e mbushur me vështirësi ekonomike dhe disfata. Historiani Schmitt analizon burimet e të ardhurave të prijësit që mbartnin rëndësi vendimtare për të mobilizuar forcat dhe për të korrur fitore në luftën kundër ushtrisë osmane. Ato përbëheshin nga fitimet e siguruara prej pasurive natyrore të sundimit të Skënderbeut, si druri dhe drithët; nga paratë që nxirreshin prej karvanëve që përshkonin malet e tij; nga pajtimi i doganave, veprimtaria tregtare dhe ndihma monetare prej shteteve italiane. Kastrioti posedonte një depozitë prej afro 2400 dukatesh në bankën raguziane. Të hollat që zotëronte i përdorte për të paguar pasuesit dhe mjeshtrit në ndërtimin e kështjellave dhe të anijeve; për të rekrutuar mercenarë; për të blerë armë dhe për të gostisur miqtë. Për më tepër, kalorësit malësorë të shpurrës së tij shfrytëzonin edhe ekspeditat grabitëse për të furnizuar familjet e tyre.<sup>46</sup> Këtij realiteti i shtohet po ashtu qëndrimi pragmatist i Skënderbeut teksa negocionte çështjen e azilit në rast disfate përfundimtare kundër osmanëve. Ai ishte i ndërgjegjshëm se si dezertor nuk mund të sigurote falje prej sulltanit, ndaj i kushtoi vëmendje garantimit të strehimit për familjen dhe pasuesit e tij në territoret raguziane, napolitane dhe venedikase.<sup>47</sup> Një qasje më humane e autorit përshkruan gjithashtu vetminë e Skënderbeut në ditët e agonisë së tij. Fati tragjik i Kastriotit nuk përkonte me imazhin e projektuar në Perëndim të heroit ngadhënjimtar në luftën kundër Perandorisë Osmane. Në të vërtetë, Skënderbeu jetoi në kultura të ndryshme në një periudhë ndërrimi epokash.<sup>48</sup>

<sup>44</sup> O. J. Schmitt, *op.cit.*, f. 473-474

<sup>45</sup> Abdi Baleta, "Riformatim demagogjik dhe mistik i imazhit të Skënderbeut", 22Gusht 2009, <http://www.zeriislam.com/artikulli.php?id=686>

<sup>46</sup> O. J. Schmitt, *op.cit.*, f. 154-159

<sup>47</sup> *Ibid.*, f. 272-274

<sup>48</sup> *Ibid.*, f. 478

4) *Risi metodike dhe faktologjike në veprën e O. J. Schmitt*

Në vazhden e botimeve të shumta të zhanreve të ndryshme mbi figurën e fisnikut nga Arbëria e mesme del në shtyp edhe biografia e Skënderbeut e historianit Schmitt. Risia e këtij punimi qëndron në interpretimin e ri të aktivitetit politik dhe ushtarak të Kastriotit në dritën e dokumenteve të zbuluara në arkivat europiane që dallon nga imazhi klasik i përfutur prej historiografisë shqiptare dhe asaj ndërkombëtare të deritanishme. I tillë është prezantimi i motivit personal të kryengritjes së Skënderbeut që ngjalli diskutime të ashpra në gjirin e studiuesve dhe opinionin publik shqiptar. Këtij debati autori i përgjigjet me shqyrtimin e gjinisë së tekstit dhe besueshmërisë së dokumentit të shfrytëzuar, që i përket një lloj burimi të quajtur “dispacci” ose raporteve diplomatike të ambasadorëve, të cilat kanë rëndësi të veçantë për studimin e Italisë së Rilindjes. Dokumenti në fjalë përshkruan audiencën e ambasadorit të Skënderbeut në Romë, i cili kërkoi ndihmë për të Zotin që nuk lufton për fenë e krishterë, por për “odio personale”, që mund ta përkthejmë “hakmarje”. Sipas O. J. Schmitt, diplomatët milanezë nuk kishin arsye ta sajnin këtë histori. Ata e kishin më të lehtë të raportnin për një princ ballkanik që kërkonte mbështetje në një luftë fetare kundër Perandorisë Osmane myslimane, argument që përputhej me idetë e Papës Nikolla V dhe klimën politike të Italisë së kohës, sesa të një fisniku që ishte përfshirë në një konflikt personal me sulltanin. Strategjinë e sigurimit të ndihmës falë paraqitjes si kampion i krishtërimit, Skënderbeu e përqafoi shumë shpejt, ide që u elaborua fuqishëm një vit më vonë nga Papa Kaliksi III.<sup>49</sup>

Krahas zbulimit të burimeve të reja dokumentare, autori zgjedh metodën historike të ndërthurrjes së analizës së tekstit dhe njohjes së terrenit ku jetoi dhe luftoi Skënderbeu. Në publikimet e derisotme, burimet historike kanë qenë përgjithësisht të ndara nga studimi i terrenit. Nga njëra anë, disa dijetarë të fushës kanë shkruar pa vizituar krahinën e Dibrës dhe të Matit dhe, nga ana tjetër, vëzhgues të mirë të këtyre viseve si oficeri britanik i shërbimeve të fshehta, H. Hodgkinson, nuk ndërmorën kërkime shkencore nëpër arkiva. Për më tepër, historiografia skënderbejane ndahet mes qasjes Perëndimore, që bazohet në hulumtimin e arkivave europiane dhe asaj Lindore, që mbështetet kryesisht në materialet osmane. Autori përpiqet të rrok sa diskursin oksidental, aq edhe atë oriental, për të rindërtuar në mënyrë sa më objektive figurën e Skënderbeut.<sup>50</sup>

<sup>49</sup> “Skënderbeu i kërkimit shkencor” ..., f. 51-52

<sup>50</sup> O. J. Schmitt, *op.cit.*, f. 534

## Përfundime

Botimi i monografisë “Skënderbeu” i historianit Oliver Jens Schmitt përbën një vlerë të shtuar për historiografinë shqiptare, për disa arsye: së pari, vepra e kapërcen qasjen autoreferenciale, sipas së cilës Kastrioti shihet si aktori kryesor i zhvillimeve politike dhe ushtarake, por e trajton atë në përputhje me dinamikën politike rajonale dhe evropiane. Së dyti, autori e tejkalon paradigmën politike dhe militare që dominon rëndom historiografinë skënderbejane, por përpiket ta paraqesë Kastriotin në kontekstin ekonomik e social të periudhës kur jetoi e luftoi. Së treti, multiperspektiviteti mbizotëron në trajtimin e figurës së Skënderbeut, si dhe të aktivitetit politik dhe ushtarak të tij. Historiani Schmitt bën një analizë të detajuar të personalitetit të Kastriotit, si kusht *sine qua non* për të shpjeguar anatominë e kryengritjeve, aleancat politike, strategjinë ushtarake dhe bilancin e luftës 25-vjeçare. Së katërti, në monografinë e Schmitt mungon njëanshmëria faktografike në përshkrimin e epokës së Skënderbeut, sepse autori bazohet jo vetëm në burime primare të shfrytëzuara në arkivat evropiane dhe ato osmane, por ballafaqon edhe tërësinë e interpretimeve, si: kristiane, evropianiste, orientale, islamike, nacional-romantike, liberale etj., për rindërtimin e figurës historike të Kastriotit në Arbërinë e mesjetës.

## Summary

The publication of the monograph “Scanderbeg” by the historian Oliver Jens Schmitt makes a valuable contribution to the enrichment of the Albanian historiography, for several reasons: at first, the study overcomes the autoreferential approach, according to which Castriot is seen as the main actor of the political and military developments but treats him with regard to the regional and European political dynamics. Secondly, the author goes beyond the political and military paradigm that dominates Scanderbeg historiography, but tries to present Castriot in the economic and social context of the historical period when he lived and fought. Thirdly, multiperspectivity prevails when dealing with Scanderbeg’s figure, as well as his political and military activity. The author Schmitt analyzes in detail the personality of Castriot as a *sine qua non* condition to explain the anatomy of uprisings, political alliances, military strategy, and the examination of the 25-year war. Fourthly, the monograph of Schmitt lacks the biased factography when describing the Scanderbeg era because the author utilizes not only the primary sources gathered at the European and Ottoman archives, but also faces the rich set of interpretations, such as: Christian, European, Oriental, Islamic, national-romantic, liberal, etc., aiming to give a new approach to the historical figure of Castriot in the medieval Arbëria.

## Bibliografia

- Akademia e Shkencave e Shqipërisë. Instituti i Historisë. *Historia e popullit shqiptar; vëll. 1*. Tiranë: Toena, 2002
- Andoni, B., “Oliver Jens Schmitt: Kurrë nuk shkrova se Skënderbeu është me origjinë të pastër serbe”, *Gazeta Shqiptare*, 4.02.2018, <http://www.gsh.al/2018/02/04/ekskluzive-oliver-jens-schmitt-kurre-nuk-shkrova-se-skenderbeu-eshte-origjine-te-paster-serbe/>
- Andoni, B., “Studimi i tij për Skënderbeun ngjalli reagime/ Historiani flet për kërcënimet: Trashëgimia helmuese e kohës së Enverit ruan ende ndikim te njerëzit” *Panorama*, 4.2.2018, <http://www.panorama.com.al/studimi-i-tij-per-skenderbeun-ngjalli-reagime-historiani-flet-per-kercenimet-trashegimia-helmuese-e-kohes-se-enverit-ruan-ende-ndikim-te-for-te-te-njerezit8/>
- Baleta, A., “Riformatim demagogjik dhe mistik i imazhit të Skënderbeut”, 22Gusht 2009, <http://www.zeriislam.com/artikulli.php?id=686>
- Daçi, F., “Dibrani Gjergj Kastrioti nuk mund të jetë një serb. Simbioza e shoqërisë pa standard”, 23.1.2009, [http://www.zemrashqiptare.net/news/id\\_6538/Fatos-Daci:-Dibrani-Gjergj-Kastrioti-nuk-mund-t%C3%AB-jet%C3%AB-nj%C3%AB-serb.html](http://www.zemrashqiptare.net/news/id_6538/Fatos-Daci:-Dibrani-Gjergj-Kastrioti-nuk-mund-t%C3%AB-jet%C3%AB-nj%C3%AB-serb.html)
- Duka, F., “Historiografia, miti dhe politika”, *Politika dhe Historia*, Tiranë: UET, 2012
- Dushku, E., & Islamaj, S., “Skënderbeu”, prezantim i tensionuar në Vjenë”, *Panorama*, <http://shllapashtica.beepworld.de/oliver.htm>
- Frashëri, K., *Skënderbeu i shpërfytyruar nga një historian zvicerian dhe disa analistë shqiptarë*. Tiranë: Dudaj, 2009
- *Historia e shtetit dhe e së drejtës në Shqipëri*. Tiranë: Luarasi, 2005
- Lubonja, F., “Bëhu i ditur të jesh i lirë”, *Përpyjekja 28-29*, Tiranë, pranverë-vjeshtë 2012
- Lubonja, F., “Nga Nacional-Komunizmi në Nacional-evropianizëm”, *Përpyjekja 28-29*, Tiranë, pranverë-vjeshtë 2012
- Misha, P., “Fenomeni nacionalizëm dhe kriza shqiptare”, *Përpyjekja 15-16*, Tiranë, janar- dhjetor 1999
- Puto, A., “Nga Skënderbeu mitik në atë historik”, *Përpyjekja 28-29*, Tiranë, pranverë-vjeshtë 2012
- Schmitt, O. J., *Skënderbeu*. Tiranë: K&B, 2009
- Schmidt-Neke, M., “Robër të Skënderbeut: mbi debatin rreth Heroit Kombëtar shqiptar”, *Përpyjekja 28-29*, Tiranë, pranverë-vjeshtë 2012
- Schopflin, G., “Natyra e mitit: disa aspekte teorike”, *Përpyjekja 15-16*,



Tiranë, janar- dhjetor 1999

- Schwandner-Sievers, S., “Narratives of Power, capacities of myth in Albania”, *Albanian Identities: Myth and History*, ed. by S. Schwandner-Sievers, Indiana Univ. Press, 2002
- “Skënderbeu i kërkimit shkencor”, Intervistë me Oliver Jens Schmitt, *Përpyekja 28-29*, Tiranë, pranverë-vjeshtë 2012
- Simoska, E., “General problems in the History textbooks of the Balkans”, *Teaching the History of Southeastern Europe*, Center for Democracy and Reconciliation in southeast Europe, Thessaloniki, 2001

**Prof. asoc. Dr. Fadil GRAJÇEVCI<sup>1</sup>**

## **KONCEPTI I DYANSHËM I BARLETIT PËR HISTORINË**

Në dy veprat e tij, monumentale të kulturës shqiptare: *Rrethimi i Shkodrës* (1504) dhe *Historia e jetës dhe e veprave të Skënderbeut, princit të epirotëve* (1508-1510), Marin Barleti, krenar për të kaluarën e popullit që i përkiste, qoftë ajo më e largët, e në veçanti ajo më e afërt, që lidhej me emrin e kryeheroit tonë kombëtar, Gjergj Kastriotin – Skënderbeun, i përmalluar për atdheun e tij të bukur por të robëruar, i ndikuar nga lëvizja e madhe kulturore e shkencore, Rilindja, i ngriti një përmendore të përjetshme kulturore botëkuptimit dhe botëpërjetimit jo vetëm të tij, por edhe të gjithë popullit të tij liridashës rreth ngjarjeve e figurave historike që e karakterizuan historinë shqiptare në shekullin XV, ngjarje e figura që, shekuj me radhë, për popullin shqiptar do të vlerësohen sa tragjike aq edhe krenare. Këto botëkuptime dhe botëpërjetime, të sjella në formën e kujtesës personale e kolektive, kushtëzuan edhe përcaktimin e tij për zgjedhjen e përmbajtjeve të caktuara të veprave të tij, të cilat karakterizohen me shprehjen e ndjenjave, të synimeve, të mendimeve e të idealeve më humane politike e shoqërore të popullit të vet.

Barleti, në Parathënie të *Historisë së Skënderbeut*, duke folur për motivet e shkrimit të kësaj historie dhe për vështirësitë me të cilat u përball gjatë hartimit të saj, ka shprehur mjaft qartë konceptin e tij për historinë si shkencë.

Sipas Barletit, historia, në rend të parë, duhet ta thotë të vërtetën, ndonëse e vërteta historike ndonjëherë duket e pabesueshme, sepse lexuesit janë të prirë që të kaluarën ta vlerësojnë duke u mbështetur në të tashmen. Ai ka frikë se lexuesit e veprës së tij, duke u nisur nga gjendja në të cilën kishte rënë atdheu i tij, heroizmat e shumtë të shqiptarëve, me në krye arkitektin e betejave fitimtare, Skënderbeun, nuk do t'i besojnë.

Qëllim të veprës së vet, Barleti ka të përgjigjet në pyetjet: “Cila ishte pamja e mbretërisë, e cila pamja e burrave, e gjithë punëvet, pak më parë, kur ish

---

<sup>1</sup> Instituti Albanologjik i Prishtinës

gjallë Skënderbeu?”<sup>2</sup> Ai, pra, do të shkruajë vetëm për periudhën e lavdishme të historisë së popullit të vet, për luftërat mbrojtëse e çlirimtare kundër pushtuesve osmanë, për mbretërinë e bashkuar të principatave shqiptare, princërit dhe mbretërit e të cilave ishin pajtuar që më shumë të bindeshin se sa të komandonin derisa ta kishin në krye një prijës si Skënderbeu.

Barleti nuk e konsideronte veten të zotin që do të mund t’ia dilte në krye me sukses trajtimit të ngjarjeve që lidhen me madhështinë e veprave të Skënderbeut. Sipas tij, për Skënderbeun do të duhej të shkruante ndonjë penë që qëndronte në lartësinë e lëndës, do të thotë në lartësinë e veprave të Skënderbeut. Sipas Barletit, historinë duhet ta shkruajnë shkrimtarët, sepse ata dinë të lavdërojnë, ata njohin më mirë rregullat e retorikës dhe ata janë të zotët që ta shtrojnë si duhet lëndën e gjerë, që të tjerëve, atyre që nuk dinë të lavdërojnë, si një barrë e rëndë, vetëm ua rëndon përgjegjësinë.

Gjithnjë duke u mbështetur në Parathënien e veprës së tij, Barleti, përkundër dëshirës dhe pritjes se punës për përjetësimin e veprës së Skënderbeut do t’ia fillonte ndonjë shkrimtar, ndonjë penë më me fat, një gjë e tillë nuk kishte ndodhur. Me këtë rast, Barleti me tone polemizuese qorton shkrimtarë të shumtë të asaj kohe, të cilët me shkrimet e tyre, me fjalimet, me kujtimet për ngjarjet personale, nuk po bënin gjë tjetër, përveç se po shpërdoronin punën e tyre, në vend se të shkruanin për ngjarjet të cilat ishin shumë më të lavdishme dhe shumë më të nevojshme të bëhen të njohura për brezat që do të vijnë.

Kur flet për këto shkrime shpërdoruese, Barleti nuk lë shumë për të nënkuptuar se fjalën nuk e ka për shkrimtarë të huaj, por për autorë shqiptarë, të cilëve, më shumë se të tjerëve, u takonte të shkruanin për të kaluarën e atdheut të tyre dhe për figurën shembullore të Skënderbeut, para se të shkruanin kujtime e gjenealogji për familjet e tyre. *Historia e Skënderbeut* e Marin Barletit ishte përgjigjja më e mirë ndaj shkrimeve panegjirike të autorëve të ndryshëm të historive gjenealogjike e të kronikave familjare që i madhonin veprat e të afërmeve të tyre. Duket se Barleti me veprën e tij monument për Skënderbeun ua kishte ndalur hovin shkrimeve të tilla. Historitë gjenealogjike dhe kronikat familjare të asaj kohe, madje, për ta parë dritën e botimit, do të presin disa dekada, derisa pasardhësit e autorëve të tyre morën guximin që t’i botojnë ato. Me *Historinë e Skënderbeut*, Barleti, pothuaj në çdo aspekt, i tejkaloi shkrimet e bashkatdhetarëve të vet.

Barleti, si historian i epokës humaniste, mbështet parimin tradicional të dobishmërisë së historiografisë. Duke u nisur nga ky parim, varësisht prej qëndrimit që mban ndaj ngjarjeve, situatave e figurave historike, ai di kur ia vlen të heshtë e kur të flasë më shumë, kur të shajë e të qortojë e kur të lavdërojë.

<sup>2</sup> Marin Barleti, *Historia e Skënderbeut*, “Rilindja”, Prishtinë, 1982, f. 46.

Kështu, ai di të heshtë për ndonjë ngjarje a veprim që ia zbeh lavdinë kryetrimt Skënderbe, kurse di të flasë shumë e të zgjatet me përshkrime të ngjarjeve që ia ngrenë lart lavdinë emrit të tij; di të heshtë për politikën dyfytyrëshe të Republikës së Venedikut dhe të shteteve të tjera të krishtera ndaj shtetit të Skënderbeut, kurse të zgjatet së numëruari ndihmat e kohëpaskohshme që këto shtete ia dërgonin Skënderbeut, ndihma këto që ishin pakrahasueshëm modeste me kontributin e luftërave të Skënderbeut në mbrojtje jo vetëm të lirisë së atdheut të vet, por edhe të lirisë dhe të qytetërimit të një pjese të Evropës; di të heshtë dhe t'i fshehë përçarjet e shpeshta mes princërve e feudalëve shqiptarë, kurse të flasë shpesh dhe shumë për përpjekjet e vazhdueshme të Skënderbeut që t'i mbajë të pajtuar e të bashkuar këta princër e feudalë shqiptarë; di t'i qortojë e t'i vlerësojë veprime barbare fushatat ndëshkuese që i ndërmer armiku kundër popullsisë së pambrojtur shqiptare dhe pasurisë së tyre, në njërën anë dhe di t'i arsyetojë, madje edhe t'i lavdërojë po të njëjtat veprime të ushtrisë shqiptare, kohë pas kohe, kundër popullsisë dhe tokave nën sundimin e perandorisë osmane, në anën tjetër; di t'i shajë zakonet e besimit islam, në njërën anë, kurse t'i lavdërojë zakonet e besimit të krishterë, në anën tjetër; di ta rrisë edhe me disa mijëra numrin e ushtarëve të vrarë, të plagosur e të zënë robër të osmanëve, kurse ta zvogëlojë, po ashtu, me mijëra numrin e ushtarëve të vrarë, të plagosur e të zënë robër nga pala shqiptare (nga ushtria shqiptare numri i të plagosurve gjithnjë është më i madh se sa numri i të vrarëve, kurse nga ushtria turke, numri i të vrarëve gjithnjë është më i madh, madje edhe dyfish më i madh, se sa numri i të plagosurve); di t'i shajë e t'i përqeshë prijësit ushtarakë e shpirtërorë të armikut, derisa di t'i lavdërojë deri në himnizim prijësit ushtarakë e shpirtërorë shqiptarë.

Një nga parimet themelore për hartimin e *Historisë së Skënderbeut*, Barleti e çmonte paraqitjen objektive të ngjarjeve dhe të fakteve rreth tyre. Por sa i qëndron besnik këtij parimi? Për ngjarjet që përshkruan, ai sjell të dhëna të shumta që kishte arritur të mbledhë, të cilat, pothuaj të gjitha, i fut në vepër, duke i komentuar për të shprehur në fund përkrahjen, dyshimin apo mosbesimin ndaj tyre. Një qëndrim i tillë i Barletit ndaj fakteve, qofshin ato gojore, apo të shkruara, në kërkim të së vërtetës, veprës i jep karakter hulumtues shkencor. Kështu, ai, shpesh herë, nuk u beson të dhënave të dëshmitarëve, të cilët duke dashur që ta ngrenë sa më lart figurën e Skënderbeut, sjellin të dhëna të pabesueshme, si p.sh.:

- nuk u beson dëshmitarëve që thonë se vetëm brenda një muaji pas kthimit në atdhe, Skënderbeu kishte arritur që t'i kthente nën sundimin e vet të gjitha zotërimet e mëparshme të të atit. Nuk u beson këtyre rrëfimeve, sepse ka parasysh kushtet meteorologjike, që zakonisht mbretërojnë gjatë dimrit në ato treva;

- nuk e mbështet besimin mburrës të drishtëtanëve se ishin me origjinë romake. Edhe më pak e mbështet besimin tjetër se ata ishin kolonë të romakëve;
- nuk i mbështet mendimet e atyre që besonin se shkak i kthimit të ushtrisë osmane në Adrianopojë, pas marrjes së Sfetigradit nga Skënderbeu, ishin turbullirat hungareze, greke e perse, por dëmet që kjo ushtri kishte pasur në Epir;
- nuk e mbështet rrëfimin se Mehmeti II kishte vrarë foshnjën gjashtëmuajshe, me qëllim që të mos linte gjallë asnjë filiz të të atit etj., aq më shumë kur e kujton faktin se Murati II, në atë kohë, ishte më shumë se 80 vjeç.

Për t'i bërë të besueshme, Barleti ngjarjet që përshkruan i krahason me ngjarje të antikitetit. Krahasimi i ngjarjeve, i situatave e i veprimeve të personaliteteve politike e ushtarake të antikitetit me ato të kohës së Skënderbeut, bëhet, pothuaj, parim krijues. Por, jo në pak raste, Barleti e tepron me krahasime të tilla, sepse bëmat e pabesueshme të Skënderbeut i krahason përveç me bëmat e personaliteteve të njohura politike e ushtarake të antikitetit, edhe me bëmat e figurave të veprave letrare të antikitetit, duke i përzier kështu faktet historike me faktet letrare artistike.

Të gjitha ngjarjet që zënë vend në *Historinë e Skënderbeut* të Barletit, paraqiten në pajtim me teorinë antike, e cila historiografinë e konsideron edhe si letërsi artistike dhe trajtohen me metodën tradicionale analiste, sipas së cilës ngjarjet përshkruhen kronologjikisht, duke u kushtuar rëndësi edhe kontekstit politik, shoqëror e kulturor të zhvillimit të tyre, edhe fakteve të ndryshme gjeografike e etnografike, të shprehurit figurativ dhe kompozicionit. Kështu, Barleti, përveç për ngjarjet kryesore të veprës së tij, flet edhe për marrëdhëniet mes princërve e feudalëve shqiptarë, për marrëdhëniet politike e ekonomike të shtetit të Skënderbeut me shtetet fqinjë dhe me ato të zonës ballkanike evropiane, për marrëdhëniet e këtyre shteteve në mes vete, për qëndrimin e tyre politik e ushtarak ndaj luftërave shqiptaro-osmane, për vatrat e tjera të luftës në Evropë e në Azi, të cilat kishin ndikim në zhvillimin e ngjarjeve në Shqipëri, për territoret nën zotërim të Skënderbeut dhe për ato nën zotërim të princërve të tjerë epirotas, për qytetet, për kështjellat, për fshatrat, për burimet e tyre ekonomike, për malet, për tokat pjellore, për kulturat bujqësore, për blegtorinë, për të kaluarën dhe për vlerat kulturore të trashëguara nga paraardhësit, për origjinën e epirotasve, për origjinën e turqve, për traditat e zakonet që i karakterizonin jetën e të krishterëve dhe për ato të turqve, për konfiguracionin gjeografik të vendbetëve, për organizimin dhe edukimin ushtarak të të dyja palëve ndërluftuese, për arsenalin e armëve, për strategjinë e luftërave, për mënyrën e komunikimit në largësi të bashkëluftëtarëve të Skënderbeut, si dhe për çështje të tjera të rëndësishme që e karakterizonin Shqipërinë e shekullit XV. Nga numërimi i ngjarjeve, situatave

e momenteve të tjera, si elemente të strukturës përmbajtjesore të *Historisë së Skënderbeut*, shohim se gama e interesimit tematiko-motivor e Barletit është e pasur dhe larmishme. Ky interesim kaq i gjerë për ngjarje, situata e probleme të kohës së Skënderbeut, veprës i jep karakter më të përgjithshëm. Duke trajtuar njëkohësisht temat historike, politike, ushtarake, ekonomike, kulturore, filozofike, etike e estetike, Barleti sikur deshi të shkruajë jo një vepër me vlera shkencore historiografike, por edhe një vepër që do të kryejë edhe rolin e enciklopedisë kombëtare shkencore dhe artistike.<sup>3</sup>

Me përshkrimin e ngjarjeve kryesore në jetën e Skënderbeut, siç do të mund t'i konsideronim: jetën e Skënderbeut në oborrin e Sulltanit dhe luftërat e tij për zgjerimin e perandorisë osmane, kthimin e tij në atdhe, luftërat kundër pushtuesve osmanë, luftërat kundër Venedikut, luftërat në Itali dhe çastet e fundit të jetës së tij, pa e nënçmuar rëndësinë historike edhe të ngjarjeve të tjera, Barleti ka përmbushur detyrën e historianit, sepse për përshkrimin e tyre është detyruar të mbledhë dëshmi e fakte, në mënyrë që vepra e tij të mos bjerë në kundërshtim me atë që me të madhe e kërkonte historia, me të vërtetën. Mirëpo, përkundër të dhënave të shumta që sjell rreth këtyre ngjarjeve, Barleti si historian, në çdo përshkrim, në çdo pamje, në çdo moment e shpreh anësinë e vet dhe bën gabime, do të thoshim, jo të vogla, të cilat kanë ndikuar tek historianë të shumtë që të dhënat që sjell ai në veprën e vet, t'i marrim me rezervë.<sup>4</sup>

Barleti, përveç që i përshkruan ngjarjet kryesore, ai edhe i komenton dhe shpreh vlerësimin për to. Ai nuk kënaqet vetëm me paraqitjen e njëtrajtshme të betejave të njëpasnjëshme në mes ushtrisë shqiptare që e mbronte atdheun, lirinë dhe fenë e vet dhe asaj të perandorisë osmane, e cila po plaçkiste, po digjte e po shkretonte toka që kurrë nuk kishin qenë të saj, po vriste popullsi të pafajshme deri në shfarosje, vetëm e vetëm pse nuk po pranonin që t'i nënshtroheshin asaj, por paraqet edhe ndonjë ngjarje pak më interesante brenda vetë ngjarjes kryesore, përshkruan ndonjë rrethanë të zhvillimit të saj, e, ndonjëherë, me ndonjë digresion ikën plotësisht nga tema, ikën nga vendbetëja. Përmes këtyre digresioneve, që kryesisht janë të stilit letrar-artistik, shpreh qëndrimin subjektiv ndaj ngjarjeve dhe problemeve për të cilat flet në ato momente. Me ndërhyrje komentuese e vlerësuese për rrethanat dhe për shkaqet e zhvillimit të ngjarjeve, me ikjet e shpeshta nga tema, Barleti në njërën anë ka arritur ta luftojë monotoninë e skenave triviale që përsëriten nëpër të gjitha betejat, duke e bërë veprën më interesante e më të këndshme për lexim dhe, në anën tjetër, ka arritur që t'i mbulojë ndërkohët në mes ngjarjeve kryesore dhe kështu ato të duken më

<sup>3</sup> Rexhep Qosja, *Historia e letërsisë shqipe – Romantizmi I*, "Rilindja", Prishtinë 1984, f. 243.

<sup>4</sup> F. S. Noli, *Gjergj Kastrioti Skënderbeu (1405 – 1468)*, Rilindja, Prishtinë 1988, f. 190.

të lidhura dhe më të kompozuara artistikisht.

Po, cilat janë ngjarjet, rrethanat, ndërhyrjet komentuese e vlerësuese me të cilat Barleti i lidh ngjarjet kryesore dhe cilat janë mjetet që përdor ai për këtë qëllim?

Që në librin e parë, para se të flasë për marrjen peng të djemve të Gjon Kastriotit nga ana e Sulltanit, Barleti, për ta njohur lexuesin e vet me disa rrethana të cilat ndikuan në marrjen e vendimit nga Gjon Kastrioti për dorëzimin peng të djemve të tij të Sulltani, flet për rrugën e forcimit të Perandorisë Osmane, për depërtimet e saj të para në Ballkan, për territoret e epirotasve e për zotërimet e Kastriotëve në veçanti, për prindërit, vëllezërit e motrat e Gjergjit dhe për ëndrrën e nënës së Gjergjit, që e kishte parë para se ta lindte Gjergjin. Kohën prej dorëzimit të Gjergjit në duart e Sulltanit e deri te mosha e rinisë Barleti e mbulon me përshkrimin e zakonit të rrethprerjes, synetit, të cilin turqit e ruajnë të pandryshuar sikurse të hebrenjtë, pastaj me përshkrimin dhe krahasimin e urdhrave e të titujve fetarë të fesë muhamedane me ato të të krishterëve dhe me lavdërimet panegjirike për edukimin dhe formimin e personalitetit të Gjergjit, tashmë të pagëzuar me emrin Skënderbe.

Shpesh, ndërkohët mes ngjarjeve kryesore Barleti i mbulon me përshkrimin e fushatave plaçkitëse, të cilat Skënderbeu i ndërmerre sa herë i jepej rasti kundër viseve fqinje që ishin nën sundimin e otomanëve, gjithnjë duke i arsyetuar ato si stërvitje ushtarake dhe duke i paraqitur si provokime për luftë, ose si hakmarrje për dëme të pësura më herët nga armiku e ndonjëherë edhe si dënim për humbësit e betejave. Fushatat plaçkitëse, Barleti, ndonjëherë i paraqet edhe si shpërblim, të cilin Skënderbeu ua jepte ushtarëve të vet pas fitoreve, duke ua mundësuar atyre që gjithë plaçkën që arrinin ta rrëmbenin ta mbanin për vete.

Sa herë ndien nevojë për të shprehur qëndrimin e vet ndaj situatave e problemeve të caktuara, Barleti, më shumë në rolin e shkrimtarit se sa të historianit, imagjionon letra e fjalime, në të cilat investon gjithë dijen e tij për lashtësinë dhe gjithë rregullat e mjetet e retorikës, duke mos e respektuar të vërtetën historike dhe duke u lëshuar shpesh në diskutime filozofike-morale. Letrat dhe fjalimet në *Historinë e Skënderbeut* janë pjesë të bukura letrare, janë letërsia e veprës. Kështu, p. sh., përmes fjalimit të Davidit, shkrimtarit raguzian, drejtuar Skënderbeut, para se të nisej me anije prej Raguze në Itali, në ndihmë mbretit të Napolit, Barleti ngre lart meritat e Skënderbeut dhe shpreh qëndrimet e veta politike, fetare e kulturore ndaj ngjarjeve të kohës:

“Nuk e di, o princ i ndritur Skënderbe, se ç’yll mund të dilte dhe të dukej sot më i ndritur e më i shkëlqyer për qytetin tonë dhe për popullin e Raguzës, se ç’diell më vezullonjës e ç’hyjni më mirëdashëse dhe më përkrahëse se sa pamja

dhe prania jote plot mirësi (...).”<sup>5</sup>

Në interes të ideve përparimtare të kohës, ideve për bashkimin e shteteve të krishtera kundër armikut të përbashkët, Barleti, i njoftuar për letërkëmbimet që do të ketë pasur Skënderbeu me Alfonsin, me Papa Piun II, madje edhe me sulltanët e Perandorisë Osmane, improvizon shkëmbim letrash me këto personalitete të rëndësishme të kohës.

Përveç letrave e fjalimeve, mjete tjera komentuese e vlerësuese për ngjarjet që përshkruan në veprën e tij kushtuar Skënderbeut, Barleti përdor edhe tregimet fantastike dhe profecitë e ndryshme popullore. Kështu p.sh., ëndrrën e Vojsavës, nënës së Skënderbeut, kur ishte shtatzënë, e tregon dy herë. Herën e parë, në fillim të veprës, ëndrra tregohet si profetizim, si paralajmërim se kush do të linte, se kush do të bëhej ai që do të lindte dhe cila do të jetë vepra e tij, kurse herën e dytë, kah fundi i veprës, ëndrra ritregohet, për ta vërtetuar tregimin e herës së parë, që d.m.th. profecinë. Veprat e Skënderbeut ëndrrën e kishin bërë parandjenjë të besueshme për rrjedhën e shumë ngjarjeve të pastajme. Ëndrra ishte përhapur aq shumë dhe ishte bërë e besueshme jo vetëm për epirotasit dhe aleatët e tyre, por edhe nga armiqtë otomanë. Herën e dytë, Barleti, tregimin dhe interpretimin e ëndrrës na e sjell përmes Ballabanit tradhtar.

Barleti, përveç ëndrrave, në veprën e tij historiografike, si tregime profetizuese ka shfrytëzuar edhe besëtytnitë dhe gojëdhënat popullore që zbulojnë të fshehtat e natyrës. Kështu, p.sh., para betejës së famshme të Skënderbeut kundës Isak pashës e Hamzait, nipit të Skënderbeut, Barleti përmend tri shenja paralajmëruese të ngjarjeve që do të pasonin, shenja këto që i përshtaten atmosferës së zymtë e të trishtueshme në prag të një kërdeie njerëzore që do të ndodhte: 1) “...një flamurtar bashkë me flamurin e vet u përplas përdhe nga kali, i cili ndeshi mbi një mur gërmadhe nga ata që janë të shumtë ndër ne dhe që ndajnë kufitë e pronave”; 2) “...gjatë po atyre ditëve fluturoi nëpër ato vende si paralajmëronjëse e gjakut të ardhshëm një mori aqë e madhe torrlash e shpendësh të tjera të këtij lloji, që lakmojnë ndyrësitë e kufomave, sa që mbuluan qiellin” dhe 3) “Gjatë po këtij viti, më të dalë të pranverës, ra shi prej gjaku...”<sup>6</sup> Këtyre shenjave, këtyre besëtytnive, Barleti u beson dhe u jep rëndësi duke i shfaqur pikëpamjet e tij: “Shumë gjëra rrjedhin pa ditur gjë vdekëtarët, në bazë të disa shkaqeve të shpeshta të tyre, dhe shpesh herë neve na zbulohen të mirat dhe të këqijat me anë të veprimt të yjeve; por, me që përtojmë t’i vërejmë, ne i quajmë të gjitha të rastit dhe nuk e vrasim mëndjen, as nuk e shtiem në punë urtësinë tonë, që të përfitojmë nga përkrahja

<sup>5</sup> Marin Barleti, *Historia e Skënderbeut*, Rilindja, Prishtinë 1982, f. 394.

<sup>6</sup> Marin Barleti, *Vep. e cit.*, f. 369.



mirëdashëse hyjnore dhe të largojmë furinë e qiellit kërcënonjës.”<sup>7</sup>

Besimi në tregime fantastike e profetizuese dhe përdorimi i tyre edhe si fakte historike nga Barleti, autori i veprës monumentale *Historia e Skënderbeut*, është edhe një tregues tjetër i konceptit të tij të dyanshëm për historinë si shkencë dhe për historinë edhe si art.

Përshkrimi i ngjarjeve historike me ndihmën e mjeteve letraro-artistike, siç ngjet në veprën e Barletit *Historia e Skënderbeut*, dhe pothuaj në numrin më të madh të veprave të këtij lloji të autorëve antikë, të atyre mesjetarë dhe në shumë vepra të autorëve të periudhës së lulëzimit të shkencave dhe arteve, Rilindjes, prej të cilave u ndikua shumë historiani dhe shkrimtari ynë, prifti shkodran, Marin Barleti, na e kujton thënien e Arnild Hauzerit, i cili kur flet për raportin e romanit me shkencën, thotë : “Ka periudha në të cilat arti zhvillohet në drejtim të shkencës, ashtu sikurse që ka periudha në të cilat shkenca zhvillohet në drejtim të artit.”<sup>8</sup>

Paraqitja e ngjarjeve dhe situatave të shumta politike, ushtarake, ekonomike, kulturore e fetare të kohës, komentimi dhe vlerësimi i tyre duke u mbështetur në traditën e shkrimit të veprave historiografike antike e mesjetare, sipas së cilës historiografët edhe në epokën e Rilindjes “nuk para mbështeteshin në burimet dokumentare, ose nuk i shfrytëzonin ato në mënyrë të përpiktë e objektivisht,”<sup>9</sup> mbështetja më shumë në intuitë dhe në mjete konvencionale të retorikës romake, përdorimi i mjeteve më shumë letrare artistike, siç janë digresionet, rrëfimet brenda rrëfimeve, fjalimet, letërkëmbimet, gojëdhënat, profecitë, besëtytnitë etj., kanë ndikuar që vepra *Historia e jetës dhe veprave të Skënderbeut, Princit të Epirotëve*, nga një numër i madh i studiuesve të saj të shfrytëzohet e të studiohet jo vetëm si një vepër historiografike, por të studiohet dhe prej saj të frymëzohen edhe shkrimtarë e studiues të shumë letrarë. Mbështetja e Barletit në përvojën historiografike të antikës greke e romake dhe imitimi i stilit panegjirik të veprave kushtuar ngjarjeve e heronjve të caktuar, në të cilat lavdëroheshin të vdekurit që pas vetes kishin lënë vepra të madhërishe, para së gjithash në sajë të përkrahjes edhe prej perëndive, ka bërë që jo vetëm figura e Skënderbeut, por edhe e shumë figura të tjera historike përkrah tij, të idealizohen e të himnizohen, sa të na duken gjysmëperëndi.

Si humanist që ishte, Barleti rolin e individit në rrjedhën e ngjarjeve të përgjithshme politike e shoqërore e konsideronte pothuaj vendimtar. Për ta shquar rolin e individit në rrjedhën dhe përfundimin e ngjarjeve të caktuara,

<sup>7</sup> Po aty, f. 370.

<sup>8</sup> Sipas Milivoj Solar, *Pitanja poetike*, “Školska knjiga”, Zagreb 1971, f. 143.

<sup>9</sup> Frida Idrizi, *Letërsia dhe dokumenti*, Tiranë 1990, f. 15.

ai në titullin e veprës së tij e shënon emrin e personalitetit rreth të cilit do t'i përshkruajë ato ngjarje. *Historia e jetës dhe veprave të Skënderbeut, Princit të Epirotëve* nuk është histori vetëm për një figurë të rëndësishme historike, figurë me të cilën shënohet një epokë, ajo në radhë të parë është histori e luftërave të popullit shqiptar gjatë shekullit XV, me në krye burrështetasin e strategun Gjergj Kastriotin Skënderbeun, kundër ekspeditave të shumta pushtuese të ushtrisë më moderne të kohës, asaj të Perandorisë Osmane. Nisur nga ky fakt, mund të themi se *Historia e Skënderbeut* e Barletit është Historia e popullit shqiptar në shekullin XV e personalizuar në figurën e kryetrimt shqiptar, Gjergj Kastriotit Skënderbeut.

Përshkrimi ngjarjeve historike të popullit të Epirit, të prirë nga Skënderbeu, me panegjirizëm dhe me stil të ngjeshur me figura të shumta letrare, nuk na jep shumë të drejtë që këtë vepër ta konsiderojmë më shumë letrare se sa historiografike. Sipas studiueses Frida Idrizi, "Historia e Skënderbeut" e Barletit nuk është vepër historike, qoftë edhe e shkruar sipas mënyrës së humanistëve evropianë<sup>10</sup>, por më shumë biografi, sepse në qendër të saj është historia e vetëm një heroi, Skënderbeut. Ne mendojmë se, përkundër gabimeve në përcaktimin e të dhënave historike që i bën Barleti, vepra e tij *Historia e jetës dhe veprave të Skënderbeut, Princit të Epirotëve*, është, në radhë të parë, një vepër historiografike në të cilën përshkruhen ngjarje, rrethana, situata e momente të ndryshme dramatike politike, ideologjike, ushtarake, ekonomike e kulturore që e bëjnë të veçantë historinë e popullit shqiptar në shekullin XV, shekullin e luftërave heroike nën udhëheqjen e Skënderbeut kundër pushtuesve osmanë, është Historia e popullit shqiptar në shekullin XV e personalizuar në figurën e kryetrimt shqiptar, Gjergj Kastriotit Skënderbeut, është një histori e shkruar me stil të qartë, transparent e patetik, me plot mjete retorike dhe me plot refleksione moraliste, gjë që veprës ia shton vlerën edhe më shumë, duke e bërë atë shumë më interesante dhe shumë më tërheqëse për lexim.

## Përmbledhje

Në Parathënie të veprës së tij *Historia e jetës dhe e veprave të Skënderbeut, princit të epirotëve*, Marin Barleti, duke folur për motivet e shkrimit dhe për vështirësitë me të cilat u ballafaqua gjatë hartimit të saj, ka shprehur mjaft qartë konceptin e tij për historinë si shkencë.

Barleti, i përgjegjshëm për detyrën e historianit, i cili në rend të parë duhet ta thotë të vërtetën, ka frikë se ngjarjet e lavdishme, për të cilat do të shkruajë, lexuesit e tij, duke u nisur nga gjendja e atëhershme e palavdishme në të cilën

<sup>10</sup> Po aty, f. 24.

ishte katandisur populli i tij, nuk do t'i besojnë.

Barleti nuk e konsideronte veten të zotin që do të mund t'ia dilte në krye me sukses trajtimit të ngjarjeve që lidhen me madhështinë e veprave të Skënderbeut. Sipas tij, historinë duhet ta shkruajnë shkrimtarët, sepse ata dinë të lavdërojnë, ata njohin mirë rregullat e retorikës dhe ata janë të zotët ta shtrojnë si duhet lëndën e gjerë, që të tjerëve, atyre që nuk dinë të lavdërojnë, si një barrë e rëndë, vetëm ua rëndon përgjegjësinë.

Si historian i epokës humaniste, Barleti vazhdon ta mbështesë parimin tradicional të dobishmërisë së veprave për historinë. Duke u nisur nga ky parim, Barleti di edhe të heshtë, edhe të flasë shumë, edhe të shajë e të qortojë, edhe të lavdërojë, varësisht prej qëndrimit që ka ndaj ngjarjeve, situatave e figurave historike për të cilat flet.

Konceptimi i dyanshëm për historinë: 1. Historisë si shkencë që ngjarjet e së kaluarës t'i paraqesë objektivisht dhe 2. Historisë si art, që ngjarjet historike t'i paraqesë përmes thurjes interesante, me përshkrime të skenave të veçanta, me dialogë, me fjalime e me digresione të ndryshme, të cilat i karakterizon stili i llojlojshëm dhe i ngjeshur me figura të shumta, ka bërë që Barleti të shprehë interesim jo vetëm për ngjarjet më kryesore në jetën e Skënderbeut, por edhe për ngjarje të tjera, do të themi, për ngjarje më të vogla që ndodhin brenda ngjarjeve më të mëdha dhe për ngjarje që ndodhin në ndërkohë mes ngjarjeve kryesore. Koncepti i dyanshëm i Barletit për historinë, historisë si shkencë dhe historisë si art, njëkohësisht, ka bërë që, ai, përveç të dhënave të shumta për betejat, për numrin e ushtarëve nga të dyja palët, për numrin e të vrarëve e të plagosurve nga të dyja palët, për numrin e të zënëve robër, për aktivitetin politik e ushtarak të Skënderbeut brenda e jashtë vendit dhe të dhënave të tjera me shumë interes për njohjen sa më mirë të ngjarjeve dramatike në Shqipëri dhe më gjerë, të sjellë edhe pjesë imagjinare, si: ëndrrat, besëtytnitë, shkëmbimin e letrave, edhe ide që kanë të bëjnë me botëkuptime filozofike, etike e estetike.

## **Barlet's mutual concept for history**

### **Summary**

In the Preface of the work "The History of the Life and Deeds of Scanderbeg, the Prince of Epirus" Marin Barleti, talking about the motives of the writing and the difficulties he faced during its drafting, he clearly expressed his concept of the history as a science.

Barleti, responsible for the task of the historian, who must first say the truth, is afraid that the glorious events he will write, starting from the then unfortunate state in which his people had become, his readers will not believe.

Barleti did not consider himself capable who could successfully manage the handling of events related to the greatness of Scanderbeg's deeds. According to him, the history should be written by the writers because they know how to praise, they know well the rules of rhetoric and they are able to adequately spread the subject matter, to others, to those who do not know how to praise, as a heavy burden, it only exacerbates responsibility.

As a historian of the humanist era, Barlet continues to sustain the traditional principle of the usefulness of works of history. Starting from this principle, Barleti knows even how to silence, to speak more, to insult, rebuke and praise, depending on the attitude he has to the events, situations and historical figures he is talking about.

Mutual concept of history: 1. History as a science to present the events of the past objectively and 2. History as art, to present historical events through interesting weaving, with descriptions of particular scenes, dialogues, speeches and various digressions, which are characterized with varied and concise style with numerous figures, has made Barleti express interest not only for the most important events in Skanderbeg's life, but also for other events, say, for smaller events occurring within major events and events occurring in the meantime between key events. Barlet's mutual concept of history, history as science and history as art, at the same time, has made that, in addition to numerous battleships, the number of soldiers on both sides, the number of those killed and injured from both sides, for the number of captives, for the political and military activity of Scanderbeg inside and outside of the country and other data with great interest for the best knowledge of the dramatic events in Albania and beyond, to bring also imaginary pieces, such as: dreams, superstitions, exchange of letters, and ideas that relate to philosophical, ethical and aesthetic worldview.

**Prof. Dr. Lekë SOKOLI<sup>1</sup>**

## **HISTORIOGRAFIA SKËNDERBEJANE NË NJË SHQYRTIM METODOLOGJIK**

### **Përmbledhje**

Për Skënderbeun dhe epokën e tij të përndritur janë shkruar një pafundësi veprash. Aq sa mund të themi se ka fituar të drejtën e qytetarisë “Disiplina e Skënderbeologjisë”. Për t’u theksuar është vazhdimësia, fakti që për të kanë shkruar bashkëkohësit e tij, sikurse vazhdojnë të shkruajnë edhe bashkëkohësit tanë, 5-6 shekuj pas tij. Veprat mbi Skënderbeun dhe epokën e tij janë krijuar varg, njëra pas tjetrës. Thënë figurshëm, autorët kanë ecur mbi supet e paraardhësve të tyre, si për të konfirmuar faktin e njohur se shkenca, edhe shkenca e historisë, është vazhdim i shkencës. Autorët, si rregull, kanë shfrytëzuar veprat e mëparshme. Për të konfirmuar, për të korrektuar apo edhe për të hedhur poshtë analiza, pohime e përfundime. Por, ka patur raste që për të krijuar veprat mbi Skënderbeun janë bërë kapërcime metodologjike, është abstraguuar mbi vepra të dhëna, sidomos mbi veprat e krijuar në epokën kastriotase, apo fill pas saj. Në këtë punim janë analizuar metodologjikisht veprat e Marin Barletit, Fan Nolit dhe Kristo Frashërit, gjithsej në 8-9 vepra të shkruara, në një distancë kohore që shkon në plot pesë shekuj. Qasja metodologjike e këtij punimi ka të bëjë jo aq me vetë lëndën e veprave mbi Skënderbeun, por me burimin e kësaj lënde. Nga ky këndvështrim dalin disa përfundime me interes si për epokën skënderbejane, siç janë konfirmimet gati-gati shterruese për bëmat e tij, parimisht. Përfundime dalin, gjithashtu, edhe për autorët, sidomos mbi Marin Barletin, i cilësuar zyrtarisht “një historian i mirëfilltë”. Por, në fakt, ai është vetëm pararendës i historiografisë. Nga ana tjetër, ai është themelues i mendimit shqiptar, themelues i humanizmit shqiptar, përfaqësues i shquar i humanizmit europian. Ai është një “Skënderbe i mendimit shoqëror”, marrë përgjithësisht, si mendim historik (natyrisht), por edhe si mendim filozofik, sociologjik, politik, etnologjik, juridik, psikologjik, antropologjik, socio-linguistik etj. Ndaj vepra e tij nuk i takon vetëm

---

<sup>1</sup> Universiteti Aleksander Moisiu, Durrës; [lsokoli@sociology.al](mailto:lsokoli@sociology.al); [lsokoli53@gmail.com](mailto:lsokoli53@gmail.com);

disiplinës së historisë, por edhe disiplinave të tjera të shkencave shoqërore.

**Fjalë kyçe:** Historiografi skënderbejane, qasje metodologjike, shqyrtim krahasues, histori tregimtare/dokumentare, mendimi shqiptar

## **Historiografia skënderbejane: Barleti, Noli, Kristo Frashëri**

Tema, objekt i këtij punimi, ka dy gjymtyrë, apo koncepte çelës, që janë: “Historiografia skënderbejane” dhe “shqyrtim metodologjik”. Nga njëra anë, historiografia skënderbejane është aq e pafund saqë mund të themi pa ndonjë mëdyshje se ka fituar qytetarinë e vet “Disiplina e Skënderbeologjisë”, me një numër mjaft të madh studimesh e hulumtimesh për epokën e tij. Në këtë kuptim, duket sikur nuk ka mbetur gjë për t’u thënë. Megjithatë, hulumtimet vazhdojnë dhe nxjerrin të papritura të reja. Nga ana tjetër, qasja metodologjike ka të bëjë me metodën e humumtimit, apo me burimin e lëndës që përmbajnë veprat mbi Skënderbeun. Nga ky këndvështrim dalin disa përfundime jo pa interes.

Në këtë punim janë analizuar kryesisht (por jo vetëm) veprat e autorëve shqiptarë, respektivisht të Marin Barletit, Fan S. Nolit dhe Kristo Frashërit. Kjo për disa arsye. E para, informacionet që merren nga këta autorë për epokën skënderbejane janë mjaft të plota. E dyta, këta autorë plotësojnë njëri-tjetrin. E treta, vepra e tyre është shkruar në një distancë kohore që shkon në mbi pesë shekuj<sup>2</sup>. Kjo mundëson një shqyrtim ‘vertikal’ përgjithësues dhe metodologjik, mbi burimin e lëndës që përmbajnë këto vepra. E katërta, referenca ndaj autorëve shqiptarë mundëson shqyrtimin e disa kontributeve të rëndësishme mbi identitetin kombëtar të shqiptarëve, si dhe mbi mendimin shqiptar marrë përgjithësisht si mendim filozofik, sociologjik, psikologjik, juridik, antropologjik, etnologjik, politologjik, socio-linguistik etj. Le t’i marrim një nga një:

1. Marin Barleti (~ 1450 – 1513), shkroi dy vepra me tematikë shqiptare. Ato janë “Historia e Skënderbeut”(1508/10), një punim tërësor mbi heroin dhe veprën e tij, si dhe “Rrethimi i Shkodrës”, dedikuar posaçërisht aktit të fundit të qëndresës së shqiptarëve, më 1479 pra njëmbëdhjet vjet pas vdekjes së Skënderbeut<sup>3</sup>. Këto vepra, siç nënvizon Kadare, erdhën në botë si dëshmi të mëdha. Flitet për ngjarje që do t’i ndryshonin pamjen jo vetëm Shqipërisë, por edhe Ballkanit e Europës, për më shumë se 500 vjet.

<sup>2</sup> Vepra e parë së cilës i jemi referuar është “Rrethimi i Shkodrës” i Marin Barletit botuar në vitin 1504, ndërsa e fundit është vepra polemizuese “Skënderbeu i shpërfytyruar” i Kristo Frashërit, botim i vitit 2009. Pra, ato janë botuar në një distancë kohore prej 505 vjetësh.

<sup>3</sup> Ismail Kadare shkruan: “në qoftë se do të kërkohej një krijim letrar, që t’i përshtatej plotësisht shprehja ‘vepër monumentale’, vështirë se do të gjendej shembull më i mirë se “Rrethimi i Shkodrës” i Marin Barletit” (Kadare, Parathënie e “Rrethimi i Shkodrës”, 2012, shih).

Pra Barleti, humanisti shqiptar nga Shkodra, është autori i parë që ka përshkruar jetën dhe veprën e Skënderbeut. Vepra e tij ishte dhe mbeti si burimi kryesor i historiografisë dhe i literaturës së pasur skënderbejane. Aq sa është vështirë të gjesh në bibliografinë skënderbejane vepër shkencore apo letrare që të mos jetë mbështetur tërësisht apo pjesërisht në trajtesën e Barletit.<sup>4</sup> Dëshmi për këtë ndikim të jashtëzakonshëm janë ribotimet, përkthimet dhe përshtatjet e shumta, sidomos të veprës “Historia e Skënderbeut” përgjatë pesë shekujve.<sup>5</sup>

Por, njëherësh, Marin Barleti, është i pari ndër pesë mendimtarët më të vjetër të kulturës kombëtare shqiptare, pra mund të konsiderohet si themelues i mendimit shqiptar.<sup>6</sup> Ai është, më tej, përfaqësues i shquar i humanizmit evropian.

2. Fan S. Noli (1882 –1965) është një figurë poliedrike, shumëdimensionale e shkencës, kulturës, jetës fetare dhe politikës shqiptare. Për t’u theksuar është fakti se interesave të tij krijuese Noli do t’u jepte gjithnjë karakter kombëtar.<sup>7</sup> Kjo duket mjaft qartë te Noli si historian. Studiuesit kanë pranuar se “raportet që ai vendosi me historinë si historian – e këtu ai mbeti mbi të gjitha historian i Skënderbeut – qenë një shprehje më vete e atij qëndrimi poliedrik të me të cilin reagoi ndaj detyrave që shtronte koha kur jetoi”.<sup>8</sup>

Noli ka shkruar tre libra mbi historinë e Skënderbeut. I pari është botimi i vitit 1921, si një histori popullore dhe si tekst për shkollat që po hapeshin në Shqipërinë e asaj kohe. Edhe në këtë botim Noli, siç pohon, u përpoq “të shqeppte legendën nga e vërteta”. Pra kemi, gjithësesi, një vepër shkencore.

Ndërsa historia e Skënderbeut e vitit 1947 është vepra më shkencore dhe më e rëndësishme historike e Nolit me të cilën ai pretendoi të jepte një histori sa më reale të heroit, bazuar në burime dokumentare. Ajo u krijua si punim doktorature për Universitetin e Bostonit, pra u krijua në një mjedis me standardet më të larta akademike të kohës.<sup>9</sup>

<sup>4</sup> Kristo Frashëri, “Parathënie e ‘Skënderbeu, Jeta dhe vepra’, 2002.

<sup>5</sup> Originali latinisht i veprës voluminoze “Historia e Skënderbeut” të Barletit pati katër botime. Ajo, gjithashtu, u përkthye në gjermanisht më 1553 dhe pati shtatë botime, u përkthye në italisht më 1554 dhe pati katër botime, u përkthye në anglisht më 1556, në portugalisht më 1557, në spanjisht më 1596 në katër botime etj. Ajo shërbeu si bazë për shumë vepra mbi Skënderbeun të botuar në gjuhë dhe vende të ndryshme. Ajo përbën jo vetëm një thesar të kulturës kombëtare shqiptare, por edhe një kontribut të saj në kulturën botërore (Fjalori Enciklopedik Shqiptar, 1985: 375).

<sup>6</sup> Mund të shihet edhe “Pesë mendimtarët më të vjetër të kulturës kombëtare”, të Zija Xholit, 2003.

<sup>7</sup> Nasho Jorgaqi “Mbi procesin e punës krijuese e studimore të Nolit”, 2018 (shih)

<sup>8</sup> Pranvera Bogdani, “Parathënie e Noli, Vepra 4; Shkrime historike”, 1989.

<sup>9</sup> Për t’u theksuar është fakti që Noli, me këtë vepër mbi Skënderbeun, fitoi gradën “Doktor i shkencave filozofike” në Universitetin e Bostonit (pra i shkencave filozofike, jo historike), mund

Në librin e tretë mbi historinë e Skënderbeut, botuar më 1950, Noli “shartoi” arritjet e versionit të parë të vitit 1921, si vepër popullarizuese, me ato të versionit të dytë të vitit 1947, si vepër shkencore e mirëfilltë. Ky “shartim” është ndikuar nga lidhja e krijimtarisë së tij historike me popullin shqiptar, shprehur qartësisht prej tij si përfundim i botimit të tretë, ku shkruan:

Skënderbeu jetoi në shek. XV. Ne jetojmë në shek. XX. Ç’përfaqëson për ne Skënderbeu, sot mbas pesë shekujsh? Ai ende jeton mes nesh. Problemi i tij pesëqind vjet më parë ishte pikërisht i njëjti problem që kishim edhe ne në Rilindjen Shqiptare: Davidi i rreckosur me një hobe në dorë që luftoi kundër Goliathit të armatosur gjer në dhëmbë. Ai fitoi, edhe ne fituam... Ai ishte frymëzimi ynë. Ai po na frymëzon edhe sot e kësaj dite<sup>10</sup>.

3. Kristo Frashëri (1920-2016) ka dhënë një kontribut sintetik për heroin dhe epokën e tij. Ai është marrë posaçërisht me historinë e Skënderbeut për rreth 60 vjet, nga vitet ‘1950-të e derisa vdiq në vitin 2016. Akademiku K. Frashëri është autor i një vepre të dedikuar, “Skënderbeu, jeta dhe vepra”, si dhe tre botime të mëvonshme në të cilat epoka e Skënderbeut është trajtuar me vëmendje shumë të veçantë<sup>11</sup>.

Personalisht kam patur rastin, por edhe fatin, që të njihesha nga afër me Kristo Frashërin, me arkivin e tij të jashtëzakonshëm (shtëpia e tij ishte një akademi në vete), si dhe me metodologjinë e tij të hulumtimit. Ai bëri përpjekje për të grumbulluar gjithë materialin e mundshëm dokumentar të shekullit XV. Ky material autentik, i sistemuar prej tij në origjinal dhe i përkthyer në shqip, arriti në nëntë vëllime. Pra, përveç monografisë së vitit 2002, K. Frashëri realizoj, por la të pabotuara për mungesë të burimeve financiare, nëntë vëllime me materiale dokumentare të shekullit XV.<sup>12</sup> Këto burime përbëjnë një pasuri të pazëvendësueshme për periudhën skëdnedrbajane. Për publikun është botuar vetëm sinteza e tyre, vepra “Skënderbeu, jeta dhe vepra”.

---

të shihet: Noli, Vepra 4, fq. 209.

<sup>10</sup> Fan Noli, “Vepra 4; Shkrime historike”, botim i vitit 1989, fq. 613.

<sup>11</sup> Ato janë “Historia e qytetërimit shqiptar” botim i Akademisë së Shkencave (2008), vepra polemizuese “Skënderbeu i shpërftyruar” (2009), si dhe “Identiteti kombëtar shqiptar dhe çështje të tjera” (2006).

<sup>12</sup> Ai hartoi dhe përgatiti për botim një seri prej nëntë vëllimesh me titullin e përbashkët: “Lufta shqiptare-turke në shek. XV; Burime dokumentare”. Secili vëllim ka një nëntitull, sipas materialit të vacantë që përmban: I. Burime historike shqiptare (shek. XV); II. Burime kancelareske perëndimore (1407-1442); III. Burime kancelareske perëndimore (1443-1450); IV. Burime kancelareske perëndimore (1451-1456); V. Burime kancelareske perëndimore (1457-1462); VI. Burime kancelareske perëndimore (1463-1468); VII. Burime dokumentare osmane (shek. XV); VIII. Burime tregimtare turke dhe bizantine (shek. XV); IX. Burime tregimtare perëndimore (shek. XV).



## Barleti, Noli e K. Frashërin në një shqyrtim metodologjik

Në këtë paragraf do të bëjmë njëfarë refleksioni metodologjik mbi veprat e Barletit, për të vijuar, më pas, me Nolin e Kristo Frashërin. Në parantezë theksojmë se krijuesit e veprave mbi Skënderbeun dhe epokën e tij janë vlerësuar thjesht dhe vetëm si historianë. Por, nga ana tjetër, qasja ‘vetëm apo kryesisht historike’ e shqyrtimit të epokës skënderbejane (sikurse të periudhave para edhe pas saj), ka ndikuar edhe në mungesën e një kohezioni të gjerë midis vetë studiuesve shqiptarë që, për fat të keq, vazhdojnë të debatojnë për disa çështje thelbësore, të lidhura pikërisht me qenien tonë, për të cilat normalisht nuk duhet të kishim kaq polemika.<sup>13</sup> Pra, shqyrtimi thjesht historik, ka fragmentarizuar disi vetë problematikën e botës shqiptare, ka fragmentarizuar mendimin shqiptar dhe ka ndikuar edhe në (mos)qartësimin deri të tipareve të identitetit tonë kombëtar (kulturor), i cili nuk i përket vetëm fushës së historisë, por së bashku disa disiplinave, duke përfshirë edhe sociologjinë.<sup>14</sup>

Por qasja thjesht apo kryesisht historike nuk përbën një “epidemi” vetëm shqiptare. Shumica e intelektualëve të sotëm janë të brumosur në mënyrë të atillë që i shohin gjërat në aspektin historik.<sup>15</sup> Kjo do të thotë se ata janë të ndjeshëm ndaj karakterit unik të periudhave historike, të shekujve, apo të brezave. Ndërsa leximi nga këndvështrimi i shkencave të tjera sociale, bën të mundur që të identifikojmë tiparet specifike të shqiptarëve, “thelbin e pandryshueshëm”, identitetin e tyre kulturor<sup>16</sup>. Nga ky këndvështrim del se tiparet më të qenësishme të identitetit të shqiptarëve janë nënvizuar me një qartësi të habitshme në historiografinë skënderbejane, para së gjithash në veprën e Marin Barletit, pesë shekuj më parë.

<sup>13</sup> Kujtojmë, për shembull, polemikat për identitetin kombëtar shqiptar të Ismail Kadare dhe Rexhep Qosja, si dhe ndëhyrjet në këtë debat të shumë studiuesve, opinionistëve e polemistëve të botës shqiptare. Kujtojmë, gjithashtu, polemikat e ashpra për figurën e Skënderbeut, pas botimit të veprës së Oliver Schmitt-it, më 2008, etj.

<sup>14</sup> Siç dihet, çështja e identitetit të shqiptarëve u shndërrua, sidomos gjatë vitit 2006, në objekt polemikash, midis dy përfaqësuesve kryesorë të letrave shqipe, dy akademikëve Kadare-Qose (shih, Kadare 2006; Qosja 2006). Por meriton të veçojmë sidomos ndëryrjen, në këtë debat, të një tjetër akademiku, prof. Kristo Frashërit, sipas të cilit,

“tema identitet nuk i përket fushës së letërsisë, rrjedhimisht as të kritikës letrare. Ajo u takon, së bashku, disa disiplinave të ndryshme: historisë, sociologjisë, filozofisë, etnografisë, kulturës, edhe gjuhësisë. Si rrjedhim, identiteti kombëtar shqiptar është një identitet kulturor, që lidhet edhe me trashëgiminë historike, kulturën popullore, mënyrën e jetesës, mentalitetin shoqëror, të drejtën zakonore etj.” (Frashëri, 2006: 4-5).

<sup>15</sup> Glen Tinder, “Mendimi politik; Çështje të përgjithshme”, 1993

<sup>16</sup> Me identitet nënkuptohet tërësia e tipareve fizike, morale dhe qytetare të një kombi të caktuar, të cilat e dallojnë atë nga kombet e tjerë (Frashëri, 2006: 23).

Gjithashtu, mund të theksojmë se midis historianëve dhe sociologëve ka pasur një debat metodologjik mjaft të gjerë dhe, herë pas here edhe të hidhur, mbi kufijtë midis këtyre dy disiplinave.<sup>17</sup> Nga është arritur në përfundimin se sa më sociologjike të bëhet historia dhe sa më historike të bëhet sociologjia, aq më mirë është për të dyja. Por historia priret të jetë individualizuese (ideografike) dhe të përshkruajë fenomene të veçanta e unike, ndërsa sociologjia është përgjithësuese. Sidoqoftë nuk ekzistojnë dallime logjike, konceptuale midis shkencave sociale dhe historisë, ekzistojnë thjesht dallime metodologjike.

Zyrtarisht është pohuar se vepra e Barletit “është fryt i punës shumëvjeçare të një historiani të mirëfilltë”<sup>18</sup>. Ky vlerësim është të paktën i njëjshëm, për të mos thënë i pasaktë. Barleti ishte 18 vjeç kur vdiq Heroi Kombëtar. Ai u referohet, së pari, ngjarjeve të jetuara prej tij. Kjo është një veçori e studiuesve socialë, të cilët gjithnjë kanë synuar të diagnostikojnë shoqëritë dhe ngjarjet e kohës së tyre.

Barleti kishte përjetuar të paktën dy rrethimet e Shkodrës, madje të dytin – njëmbëdhjetë vjet pas vdekjes së heroit, edhe si luftëtar aktiv. Barleti vetë na ndihmon në shqyrtimin e metodologjisë së tij të krijimit, kur pohon se ishte “një spektator jo i huaj” i atyre ngjarjeve. Pra, ai ishte një *spektator* konkret (i pranishëm, vrojtues, vëzhgues, vlerësues), *i brendshëm* (që ndjen e përjeton, lumturohet apo vuan, që emocionohet e reagon), që shpreh atë që ka përjetuar.<sup>19</sup>

Por, Barleti afrohet me studiuesit socialë edhe në tre-katër aspekte të tjera metodologjike. Këtu mund të veçojmë, së pari, nivelin e përgjithësimeve që, si rregull, karakterizon studiuesit socialë që hulumtojnë realitetin e kohës së tyre, ndryshe nga historianët që studiojnë të shkuarën. Së dyti, Barleti mban qëndrim ndaj ngjarjeve dhe personazheve, pra është larg të qenit një historian gjakftohtë dhe indiferent. Së treti, vepra e tij është një vepër humaniste, në kuptimin më të mirëfilltë të fjalës, pra edhe si filozofi, apo si sociologji humaniste.<sup>20</sup>

<sup>17</sup> Rreth kësaj çështje mund të shihen “Ç’është historia?” e Edward H. Carr, “Sociologjia historike” e Philip (1980), Scott & Marshall (2005), Giddens, 1979 etj.

<sup>18</sup> Fjalori Enciklopedik Shqiptar, 1985: 375 (zëri përkatës i enciklopedisë është i Prof. Aleks Buda).

<sup>19</sup> Në shkencat sociale kërkohet, për shembull, që studiuesi të vendosë veten në pozitat e atij që bën objekt studimit. Kujtojmë, për shembull, shprehjen e Maks Veberit “Verstehen” – të kuptosh në mënyrë shprehëse, emocionale.

<sup>20</sup> “Sociologjia humaniste” synon të zhvillojë një analizë shoqërore ‘në shërbim të njerëzimit’, tipari karakteristik i së cilës është një ndërthurja e sociologjisë me filozofinë dhe historinë, disiplina që sipas Robert Nibset – një ndër sociologët humanistë më të shquar – kurrë nuk duhen ndarë (Cit, Marshall, 2009: 393). Karl Pulmer, në “Documents of life, 1993” përvijon kriteret e sociologjisë humaniste: ajo i jep rëndësi subjektivitetit dhe kreativitetit njerëzor; trajton përvojat konkrete njerëzore (të folurit, ndjenjat, vepimet); thekson rolin vendimtar të politikës dhe moralit

Por, kryesore në metodologjinë barletiane është fakti se burimet autentike në të cilat është mbështetur vepra e Barletit nuk janë përgjithësisht burime historike, dokumentare. Madje ai ‘ulërin’ për mungesën e burimeve arkivore. Si burime të veprës së tij kanë qene më shumë shënimet e kujtimet personale, pra njëfarë ditari personal, sikurse dëshmitë individuale. Ai nuk shfrytëzon thëniet e shkruara e të dokumentuara të të tjerëve por dëshmitë e tyre gojore për të marrë informacion të drejtpërdrejtë apo të tërthortë mbi ngjarjet. Barleti zhvillon, kështu, një histori gojore<sup>21</sup>, e cila në kohën tonë konsiderohet si një zhvendosje e metodës së vëzhgimit, anketimit apo intervistimit nga sociologjia e shkencat e tjera sociale, në historinë sociale.

Por, veç këtyre, Barleti operon me disa koncepte të kundërta mirëfilltazi filozofiko-sociologjike, siç janë: liria dhe robëria, dituria dhe padituria, nderi dhe turpi, e mira dhe e keqja, mendimi dhe ndjenjat, perëndia dhe njerëzia, lufta dhe paqja etj. Ai nuk është një kronikan lufte, nuk ka renditur fakte dhe ngjarje në mënyrë kronologjike.

Një ndër idetë e rëndësishme të Barletit lidhet me raportin midis faktorëve “të padukshëm” (fatit), dhe atyre “të dukshëm” (veprimtarisë së njerëzve). Ai i drejtohet, mbi të gjitha, mendimit humanist. Vendin kryesor në shpjegimin e ngjarjeve ai ua jep njerëzve. Barleti u drejtohet shqiptarëve, madje pa ekuivoqe, se “është turp të pranoni ndonjë fat që s’është në dorën dhe shpatën tuaj<sup>22</sup>; shpëtimi ynë është vetëm në duart tona, tjetër shpëtim s’ka<sup>23</sup>”.

Barleti, për shembull, nuk është kundër çdo lloj lufte. Madje qëllimi kryesor i veprës së tij është frymëzimi për luftë çlirimtare. Në gojën e Skënderbeut ai vë këtë shprehje: “Unë nuk flas, o princër me njerëz që mohojnë luftërat e drejta”.<sup>24</sup> Pra, si kriter diferencimi ai konsideron qëllimin e luftës. Madje, sipas tij, karakteri i luftës përcakton edhe gjendjen shpirtërore të luftëtarëve. Qëllimet e mëdha, thotë ai, çlirojnë energji të mëdha. Shqiptarët luftonin për liri, pra ishin në të drejtën e tyre. Por, ai ishte i bindur se liria vetëm fitohet.

Konceptin e “së drejtës” Barleti e lidh me kategori të tilla morale, si besa, nderi etj. “Vdekja me nder është kapak floriri”, shkruan ai<sup>25</sup>. Te Barleti gjejmë

---

në zhvillimin historik etj. (Cit, Marshall, 2009: 393).

<sup>21</sup> Historia gojore (oral history) – qasje ndaj të shkruarit të historisë, mbështetur në një pjesë të madhe në anketimet me njerëz të moshuar që japin të dhëna retrospektive mbi ngjarjet, qëndrimet, personazhet. Kjo është një zhvendosje e metodës së vëzhgimit me anketim, nga sociologjia në historinë sociale (Marshall, 2009: 138-139).

<sup>22</sup> Histori e Skënderbeut, fq. 138

<sup>23</sup> Po aty, fq. 135

<sup>24</sup> Po aty, fq. 93.

<sup>25</sup> ”Rrethimi i Shkodrës, fq. 99

teza edhe për çështje të tilla si individualizmi, e mira e përbashkët etj. “Çdo gjë do ta çmoni më poshtë se të mirën e përbashkët”, shkruan ai.<sup>26</sup>

Barleti i lidh ngjarjet e epokës së tij me jetën e shqiptarëve, me historinë e tyre të lashtë sa legjendat, me tiparet e tyre identifikuese, pra me identitetin e tyre të veçantë. Ai vë në gojën e një mbrojtësi të Shkodrës këto fjalë: “ne kemi gjak tjetër, kemi të tjera zakone, të tjera kanune e ligje”.

Barleti trajton nëpër veprat e tij një sërë çështjesh që, në ditët tona, do t’i përfshinim në shkencat politike e në sociologjinë politike. Madje ai i referohet, i pari, gjeografit grek Strabon, për mënyrën e qeverisjes tradicionale të shqiptarëve (siç do të bënte Sami Frashëri, tre-katër shekuj më vonë). Në figurën e Skënderbeut, Barleti gjen jo vetëm modelin e njeriut ideal (tek i cili bukuria e trupit dhe bukuria e virtytit ishin në harmoni), por edhe modelin e liderit politik ideal, të një burri shteti të një tipi të veçantë, të një “kapedani popullor”, një model lideri që nuk urdhëron, por prin<sup>27</sup>. Ose që urdhëron së pari vetëveten, si në thënien: “Unë nuk u jap asnjë urdhër të tjerëve, para se t’i jap vetes”<sup>28</sup>.

Barleti ballafaqon, në fakt, dy tipe regjimesh politike, dy tipe pushtetesh: ai i shqiptarëve - nga njëra anë, dhe pushteti i sulltanëve - nga ana tjetër. Ata që kanë proceduar në këtë mënyrë janë quajtur studiues të metodës krahasuese. Në këtë linjë krahasuese Barleti operon filozofikisht me të kundërtat, siç operon për shembull, me termat “këndeje-andej”.<sup>29</sup>

Barleti, në forma të ndryshme, trajton edhe problemin e pushtetit, të marrjes dhe mënyrës së ushtrimit të tij. Ai, duke sjellë shembullin e pushtetit të sulltanëve, shprehet qartazi kundër pushtetit absolut (tiranisë) dhe lakmisë së çmendur për të qeverisur (mbretëruar). Interesant është fakti që, veç ‘natyrës së shtetit’ (e lidhur me strukturën, me qënien në krye), ai shprehet edhe për ndjesitë bazë të të qeverisurve (pra për mekanizmin që e vë pushtetin në lëvizje). Ai nëraport me nderimin (karakteristikë e regjimeve monarkike) apo frikën (karakteristikë e regjimeve despotike), veçon virtytin, që është karakteristikë për sistemin republikan.<sup>30</sup> Aksiomat politike të Barletit janë dhënë sidomos si

---

<sup>26</sup> Histori e Skënderbeut, fq. 650.

<sup>27</sup> Dhimitër Frangu jep një hillësi domethënëse: “Në fillimet e betejave ai nuk u thoshte ushtarëve “nisuni”, por “më ndiqni” (Frangu, 2000)

<sup>28</sup> Po aty, fq. 483

<sup>29</sup> Në librin e nëntë, për shembull, ai shkruan: “Ndërsa *këndeje* (nga ana jonë = e Barletit, në Shqipëri), atdheu duke ndjekur shembullin e prijësit të vet..., *andej* (nga ana e tyre = e turqve) Tirani ishte fort i mërzhitur...” Histori e Skënderbeut, 2005, fq. 335.

<sup>30</sup> Kjo përfaqëson një tip analize që u përket shkencave politike dhe sociologjisë politike, e trajtuar në mënyrë më të plotë nga Monteskjé ([1748], 2000) në veprën e njohur “Mbi frymën e ligjeve” dy shekuj e gjysmë pas botimit të veprës së Barletit.

porosi të Skënderbeut, si për shembull: "... respekto para së gjithash drejtësinë, e cila është më e shkëlqyera nga gjithë virtytet, ruaj paanësinë duke mos bërë asnjë dallim midis fytyrës së të varfrit dhe asaj të të pasurit e të fuqishmit, në çdo gjë përdor urtësinë e maturinë."<sup>31</sup>

Është interesante, gjithashtu, që të vihet në dukje fakti që vetëm tre vjet pas botimit të veprës së Barletit (1510), është botuar vepra e Makiavelit "Princi" (1513). Ndoshta jo rastësisht Noli ka lëvruar, krahas historisë së Skënderbeut dhe mendimit politiko-sociologjik shqiptar të lidhur me të, edhe mendimin politik të Makiavelit. Noli e vlerëson atë si "një nga mendimtarët më të mëdhenj në historinë e shkencave politike". Madje, Noli mendonte se për të studiuar Makiavelin duhet të studiojmëpara së gjithash mjedisin, produkt i të cilit ai ishte.<sup>32</sup> Në këtë punim mjaftohemi me veçimin e faktit se veprat e Barletit dhe ato të Makiavelit jenë krijuar jo vetëm në të njëjtën kohë, por edhe në të njëjtin mjedis dhe klimë intelektuale. Kjo përfaqëson, gjithsesi, një arenë studimesh krahasuese.<sup>33</sup>

Së fundi, vetë Barleti na jep qëllimin e veprës së tij. Ai synon, po veçojmë, "të japë dije krejt të besueshme, mbështetur në dëshmitë e atyre që thonë të vërtetën..."<sup>34</sup>

<sup>31</sup> Po aty, faqe 653-654

<sup>32</sup> Fan Noli, "'Princi' i Makiavelit", në "Vepra 4", fq. 621-640.

<sup>33</sup> Le të krahasojmë, sado shkurt: Sipas Barletit, ushtrimi i pushtetit duhet të bazohet para së gjithash në virtytin. Ndërsa, sipas Makiavelit, ushtruesi i pushtetit duhet të kujdeset për virtytin më pak se për gjithçka tjetër. Makiaveli theksonte se konsideratat morale si drejtësia, mirësia etj., nuk duhej të bënin pjesë në botën shpirtërore të pushtetmbajtësit. Për Barletin politika dhe pushteti janë mjete për të mirën e përgjithshme. Ndërsa, sipas Makiavelit politika, pushteti ishin qëllim, madje një qëllim që justifikon çdo mjet. Barleti mbeti një humanist i madh, Makiaveli mbahet si ati shpirtëror i sundimtarëve, sikurse edhe si "babai" i politikës, i një politike më realiste, kundrejt Barletit. Makiaveli, me veprën "Princi" (shih, 2003: Uegen), ka studiuar sjelljen politike (të "luanëve" dhe "dhelprave" politike) dhe ka dhënë përgjigje për dy pyetje bazë: "Si mund të merret pushteti?" (1) dhe "Si mund të mbahet pushteti?" (2). Pra, ai ka synuar të zbulojë rregullat e lojës politike dhe jo të përcaktojë një ideal politik. Për të politika është arti që bazohet në shkencën e reales. Ndërsa Barleti, sidomos në "Histori e Skënderbeut", i jep përgjigje pyetjes: "Si mund të ushtrohet pushteti, jo në interes të pushtetit vetë, por në interes të publikes, të së përgjithshmes?". Ai ka përcaktuar një ideal politik, ka dhënë tipin e liderit ideal e të pushtetit të bazuar mbi moralin politik. Për Makiavelin, libri i të cilit titullohet "Princi - Politika dhe kodi moral", politika nuk është edhe një kategori morale. Për Barletin, përkundrazi, politika është e tillë. Nëse i referohemi demokracisë, mund të themi si Makiaveli është i rëndësishëm për të kuptuar abuzimin, ose deformimin e saj. Ndërsa Barleti për të kuptuar funksionimin normal të saj, përdorimin korrekt të pushtetit. Pra, Makiaveli frymëzoi pushtetmbajtësit, Barleti frymëzoi popujt, popullin e tij dhe jo vetëm. Ai frymëzoi edhe lëvrimin e mendimit shqiptar, siç do të shohim të rilindësit dhe pasuesit e tyre, të brezi i artë i viteve '20-'30-të të shekullit XX.

<sup>34</sup> Parathënie e "Rrethimi i Shkodrës", fq. 61.

Pra, çështja më e debatueshme e historiografisë së Barletit është pikërisht besueshmëria, shkalla e vërtetësisë së ngjarjeve të përshkruara prej tij. Debatet rreth kësaj çështjeje kanë vazhduar ndër shekuj. Ato vazhdojnë edhe në ditët tona të nxitura, veç interesave akademike të mirëfillta, të lidhura me të vërtetën si synimi i çdo hulumtimi shkencor, edhe nga interesa jashtë akademike.

Dyshimi ndaj vërtetësisë së veprës së Barletit lidhet me disa faktorë.

Së pari, historia e Skënderbeut (historia reale) është në vetvete në kufjtë e të pabesueshmes. Barleti, sikurse Noli e të tjerë pas tij, kanë bërë krahasimin biblik “Davidi kundër Goliadit”. Perandoria Osmane kishte shembur të gjitha perandoritë që i dolën përpara (Bizantine, apo ballkanike) dhe po marshonte drejt Europës. Shqipëtarët e frenuan marshimin e saj për plot 36 vjet (1443-1479), nga të cilat njëzetepesë vjet nën udhëheqjen e Skënderbeut (1443-1468) dhe për njëmbëdhjetë vjet pas vdekjes së tij (1468-1479). Pra frenuan perandorinë më të fuqishme të historisë, madje në kulmin e fuqisë së saj.

Së dyti, në kohën kur shkroi Barleti, kishte filluar legjendarizimi i figurës së Skënderbeut. Shqipëria ishte pushtuar dhe njerëzve u duhej legjenda, u duhej miti. Për t’i frymëzuar në luftën e gjatë për mbijetesë. Barleti u dha shqiptarëve pikërisht atë që u duhej, ndaj vepra e tij është cilësuar si një “bibël patriotizmi” (jo vetëm shqiptar).

Së treti, dyshimi ndaj vërtetësisë së veprës së Barletit lidhet me kufizimet e humanizmit (duke përfshirë edhe historiografinë humaniste) në raport me shkencën (edhe shkencën e historisë). Tek Barleti gjejmë edhe tejkalime të realitetit të studiuar. Ka raste kur ai nuk i mbetet besnik as fakteve të vëzhguara dhe dëshmimeve. Ai, shpesh, i tejkalon ato, ua nënshton ato vullnetit dhe dëshirave të tij. Kjo konstatohet si në përshkrimin e figurës së Skënderbeut i cili sipas Barletit ishte “një njeri gati hyjnor”<sup>35</sup>, në ekzagjerimin e shifrave të tipit “7 mijë të vrarë *andej, 30 këtej*” etj. Pra, Barleti u përmbahet jo vetëm fakteve, por edhe besimit. Madje ai vetë nxjerr konkluzionin se “ne besojmë atë që dëshirojmë”<sup>36</sup>. Materialin ai e paraqet në mënyrë artistike, duke i dhënë liri edhe fantazisë së tij.

Por kryesorja në dyshimin ndaj veprës së Barletit mbetet mugesia e burimeve dokumentare, fakti që historia e Barletit është një histori tregimtare dhe jo dokumentare.

Këtu nis hipoteza noliiane: nëse konfirmohet apo nuk konfirmohet Barleti përmes një historie të dokumentuar? Pra, sipas Nolit, historia e Skënderbeut (e Barletit, por jo vetëm) është një tregim i pabesueshëm, si çdo legjendë.<sup>37</sup>

<sup>35</sup> Histori e Skenderbeut, fq. 495

<sup>36</sup> Po aty, fq. 336.

<sup>37</sup> Noli, Vepra 4, fq. 213.

Çfarë mbetet prej saj nëse bazohemi vetëm në burime dokumentare? Vepra e tij shkencore e vitit 1947 është përpjekje për një histori të Skënderbeut, pa Barletin.

Në të njëjtën linjë metodologjike vijon edhe akademiku Kristo Frashëri. Pra, dy përfaqësues të historiografisë moderne (dokumentare), gjykojnë dhe vlerësojnë vërtetësinë e trajtesave historike (tregimtare) të Barletit i cili në metodologjinë e vet, bën pjesë të pararendësit e historiografisë moderne<sup>38</sup>. Por, nëse Noli krijoi një histori të kufizuar të Skënderbeut pa Barletin (vetëm për disa beteja të tij), Kristo Frashëri krijoi pa Barletin një histori të pa kufizuar të Skënderbeut.

Por hipoteza është e njëjta: nëse mund të trajtohej një histori e Skënderbeut dhe e epopesë së shekullit XV duke u mbështetur vetëm në burime dokumentare bashkëkohore, pa shfrytëzuar biografin e diskutueshëm Barleti (sikurse edhe Biemmi etj.). Noli arriti në një përfundim konfirmues për tre betejat e famshme, rrethimin e Krujës së vitit 1450, 1466, 1467. Ndërsa akademiku Kristo Frashëri shkon më tej. Pas një udhëtimit që vazhdoi për 5-6 dekada, nëpër një mori burimesh dokumentare, të mjafta që një historian të ndriçojë, nëpërmjet ballafaqimit të tyre të ponderuar, të vërtetën e ngjarjeve, motiveve dhe proceseve të epopesë shqiptare të shekullit XV, arrin në përfundimin se e vërteta barletiane është, në thelb, një e vërtetë shkencore. Ai shkruan<sup>39</sup>:

Por, rezultati më i rëndësishëm qëndron në faktin se burimet dokumentare të shekullit XV nuk e pakësojnë, përkundrazi e forcojnë si madhështinë e luftës çlirimtare të shqiptarëve, ashtu dhe personalitetin historik të Skënderbeut, gati njësoj siç i ka përshkruar në vija të përgjithshme Marin Barleti.

Mbështetja vetëm në burimet dokumentare, pra zbatimi i një metodologjie përpikmërisht historike, ishte pikërisht ajo që e nxiti Kristo Frashërin që të dilte nga korniza e mëparshme e historiografisë skënderbejane, e cila e ka trajtuar Heroin kryesisht si udhëheqës i luftës çlirimtare. Ato i dhanë K. Frashërit mundësi që ta zgjeronte gamën e tematikës studimore dhe ta trajtonte Skënderbeun si nismëtarin e shtetit shqiptar, pikërisht në kohën kur në kontinentin evropian kishte filluar procesi i formimit të shteteve kombëtare.<sup>40</sup>

Nga ky këndvështrim del më e plotë vetë figura e Skënderbeut si strateg, si shtetar, si faktor ndërkombëtar, si ligjvënës, si administrator, por edhe si njeri. Në përfundim të veprës kryesore mbi Skënderbeun, akademiku Kristo Frashëri shkruan:

Nëse leximi i këtij punimi do të krijojë te lexuesi vizionin se Skënderbeu nuk ishte vetëm një strateg gjenial i luftës – siç e kanë trajtuar biografite e hartuara deri më

<sup>38</sup> Kristo Frashëri, “Skënderbeu, jeta dhe vepra”, fq. 7.

<sup>39</sup> Frashëri, 2002, fq. 17-18.

<sup>40</sup> Theksojmë faktin se nga 30 kapitujt që përmban monografia e tij mbi Skënderbeun, vetëm shtatë prej tyre trajtojnë luftërat e armatosura që udhëhoqi Heroi.

sot për Heroin, por një Burrë shteti me integritet politik shumëdimensional, mendoj se kam arritur të realizoj njoftimet që përmbajnë burimet dokumentare historike.

Në mesin e shekullit të kaluar, Darriel Huff botoi librin metodologjik “Si të gënjejmë me statistika?”. Të tjerë kanë shkruar dhe folur rreth çështjes: “Si të gënjejmë me dokumente?”. Në rastin e parë ‘gabimi’ metodologjik lidhet me përgjithësimin e asaj që rezulton nga një kampion jopërfaqësues; në të dytin përgjithësimin i bazuar në dokumentin e veçantë. Ndaj, procedura metodologjike shpesh çon në përfundime joshkencore. Kristo Frashëri, siç kam patur rastin ta ndjek së afërmi, bazohej në burime dokumentare, por në burime të marra nga shumë drejtime për të njëjtën çështje. Ai për të arritur në përfundime grumbullonte, seleksiononte, ballafaqonte, verifikonte, intepronte. Për të shkruar veprën “Skënderbau, jeta dhe vepra”, ai grumbulloi aq shumë material saqë hartoi dhe përgatiti për botim një seri prej nëntë vëllimesh, me burime dokumentare të vjelura nga arkivat e Venedikut, Raguzës, Romës, Romës, Napolit, Milanos, Barcelonës, Parisit, Ankarasë e Stambollit.

## **Disa përfundime**

Për Skënderbeun dhe epokën e tij janë shkruar një pafundësi veprash, aq sa ka fituar të drejtën e qytetarisë “Disiplina e Skënderbeologjisë”. Për t’u theksuar është vazhdimësia: për të kanë shkruar bashkëkohësit e tij, sikurse vazhdojnë të shkruajnë edhe bashkëkohësit tanë, 5-6 shekuj pas tij.

Në këtë punim janë analizuar kryesisht (por jo vetëm) 8-9 vepra të autorëve shqiptarë Marin Barletit, Fan S. Nolit dhe Kristo Frashërit, të botuara në një diferencë kohore që shkon në mbi 500 vjet.

Marin Barleti është autori i parë dhe burimi kryesor i historiografisë skënderbejane. Por, një çështje e debatueshme e historiografisë së Barletit është shkalla e vërtetësisë së ngjarjeve të përshkruara prej tij. Kjo lidhet me disa faktorë, si: (1) vetë historia reale e Skënderbeut është në kufjtë e të pabesueshmes; (2) në kohën kur shkroi Barleti legjendarizimi i figurës së Skënderbeut kishte filluar; (3) kjo lidhet me kufizimet e humanizmit, në raport me shkencën; (4) në dyshimin ndaj veprës së Barletit kryesore mbetet mugesja e burimeve dokumentare, fakti që historia e Barletit është një histori tregimtare dhe jo dokumentare.

Këtu nis hipoteza noliiane: nëse (nuk)konfirmohet Barleti përmes një historie të dokumentuar? Vepra shkencore e Nolit (1947) është përpjekja e parë për një histori të Skënderbeut, pa Barletin.

Në të njëjtën linjë metodologjike vijoi edhe akademiku Kristo Frashëri. Pra, dy përfaqësues të historiografisë moderne (dokumentare), gjykojnë dhe vlerësojnë vërtetësinë e trajtesave historike (tregimtare) të Barletit, një



pararendësi të historiografisë moderne.

Çfarë rezultoi? Noli arriti në një përfundime konfirmuese për tre betejat e famshme, rrethimin e Krujës së vitit 1450, 1466, 1467. Ndërsa akademiku Kristo Frashëri shkon më tej: pas një udhëtimit që vazhdoi për 5-6 dekada nëpër një mori burimesh dokumentare dhe përmes ballafaqimit të tyre të ponderuar, arrin në përfundimin se e vërteta barletiane është, në thelb, një e vërtetë shkencore. Mbështetur në burime dokumentare që shkojnë në nëntë vëllime, ai doli nga korniza e mëparshme e historiografisë skënderbejane. Kristo Frashëri nuk (ri) zbuloi vetëm Skënderbeun - udhëheqës të luftës çlirimtare, por edhe Skënderbeun strateg, shtetar, faktor ndërkombëtar, ligjvënës, administrator, por edhe njeri.

Disa përfundime dalin edhe për autorët e Skënderbeut, sidomos për Marin Barletin. Ai nuk është “një historian mirëfilltë”, siç është vlerësuar. Ai është i studiues social në kuptimin më të gjerë të fjalë, është themelues i mendimit shqiptar, sikurse edhe përfaqësues i shquar i humanizmit evropian. Barleti është një “Skënderbe i mendimit shoqëror”, marrë përgjithësisht, si mendim historik (natyrisht), por edhe si mendim filozofik, sociologjik, politik, etnologjik, juridik, psikologjik, antropologjik, socio-linguistik etj. Ndaj vepra e tij nuk i takon vetëm disiplinës së historisë, por edhe disiplinave të tjera të shkencave shoqërore. Ato duhen përfshirë edhe në programet e studimit të këtyre disiplinave.

Rezultojnë disa përfundime që kanë të bëjnë me disa mite (apo stereotipe). Miti i parë: Shqiptarët kanë qenë dhe janë të paaftë për t’u (vetë)qeverisur. Por, asnjë popull nuk mund të mbijetojë pa u (vetë)qeverisur (Monteskjè [1748] 2003). Pra, fundi i epokës skënderbejane, pushtimi turk, ishte vetëm një ndërprerje tragjike e traditës qeverisëse të shqiptarëve, të cilët mbijetuan tanimë falë vetëqeverisjes lokale, mbështetur në ligjet e të drejtës së pashkruar zakonore.

Me luftën legjendare që zhvilluan shqiptarët nën udhëheqjen heroike të Skënderbeut, me karakterin çlirimtar që ajo pati nga fillimi në fundin e saj, me formimin gjatë kësaj lufte të Shtetit Kombëtar Shqiptar, me pjesëmarrjen në të të mbarë shqiptarëve pa dallime krahinore, fetare dhe shoqërore – epepeja skënderbegiane u shndërrua në një kudhër ku u kalit kombi shqiptar, me një identitet kombëtar të konsoliduar. Lufta, shteti dhe identiteti nuk patën, sikurse ndodhi me kombet e tjera ballkanike, ngjyrim fetar. Me këtë identitet pa asnjë ngjyrim fetar, shqiptarët hynë në zgjedhën osmane pas vdekjes së Skënderbeut dhe arritën të mbijetonin.

Skënderbeu është mbivlera kryesore e historisë kombëtare të shqiptarëve. Ai nuk është thjesht një “Athlet i Krishtit”, siç është quajtur (athlet, në kuptimin e luftëtarit të madh që mbron një çështje fisnike), por një “Athlet i Lirisë”.

Historiografia skënderbejane e ka provuar vërtetësinë e veprës barletiane, në tërësinë e saj. Por, në kozmosin demokratik ‘të të gjitha pikëpamjeve’, kanë

lulëzuar edhe pikëpamje të ndryshme lidhur me Skënderbeun, epokën dhe veprën e tij. Qartësimi i tyre përbën një sfidë të historiografisë së sotme. Sidoqoftë, hulumtimet vazhdojnë dhe nxjerrin të papritura të reja.

Skënderbeu, siç shkruante Noli më se 70 vjet më parë, ende jeton mes nesh. Problemi i tij ishte i njëjti problem që kishin shqiptarët në Rilindjen Shqiptare, e pas saj. Sfidat vazhdojnë. Skënderbeu ishte shembulli, ishte frymëzimi i shqiptarëve. Ai vazhdon të frymëzojë...

## **Scanderbeg Historiography in a Methodological Approach; Some conclusions**

For Scanderbeg and his epoch are written an infinite number of works, in so far as he has acquired the right of citizenship “Discipline of Scanderbeology”. To emphasize is the continuity: for him have written his contemporaries, as our contemporaries continue to write, 5-6 centuries after him. In this paper they are analyzed mainly (but not only) 8-9 works of the Albanian authors Marin Barletit, Fan S. Noli and Kristo Frasheri, published on a timing difference amounting to more than 500 years.

Marin Barleti is the first author and principal source of Scanderbeg historiography. But a controversial issue of Barlet’s historiography is the degree of truthfulness of the events described by him. This is related to several factors, such as: (1) Scanderbeg’s real story itself is unbelievable; (2) at the time when Barleti wrote the legendary depiction of Skanderbeg’s image had begun; (3) this is related to the limitations of humanism, in relation with science; (4) in suspicion of the work of Barleti remains the lack of documentary sources, the fact that Barlet’s story is a narrative, and non-documentary story.

Just here the Noli’s hypothesis begins: if Barleti is confirmed or not, through a documented history? Noli’s real scientific work (of 1947) is the first attempt for a Skanderbeg story without Barletin. In the same methodological line, Kristo Frashëri continued. Thus, two representatives of modern historiography (documentary) judge and evaluate the authenticity of Barleti’s historical narratives, a precursor of the modern historiography.

What was the result? Noli reached a confirming conclusion for the three famous battles, Kruja’s siege of 1450, 1466, 1467. While Kristo Frasheri goes further: after a ‘journey’ that lasted for 5-6 decades through a great number of documentary sources, and through the ponderated confrontation, concludes that the Barletan truth is, in essence, a scientific truth. Based on documentary sources that go into nine volumes, he emerged from the previous frame of Scanderbeg historiography. Kristo Frasheri (re)find not only Skënderbeu, as leader of the

liberation war, but also Skanderbeg as strategist, statesman, international factor, lawmaker, administrator, and also human.

Some conclusions also arise for the authors of Skanderbeg, especially for Marin Barleti. He is not “a pure historian” as estimated. He is a social scholar in the wide sense of the word, a founder of Albanian thought, as well as a prominent representative of European humanism. Barleti is a “Skanderbeg of Social Thinking” taken generally as a historical thought (of course), but also as a philosophical, sociological, political, ethnological, juridical, psychological, anthropological, and socio-linguistic thought. His work is not just about the discipline of history, but also the other disciplines of social sciences. They should also be included in the study programs of these disciplines.

Some conclusions come about some myths (or stereotypes). The first myth: Albanians have been and are incapable of being (self) governed. But no people can survive without being (self) governed (Monteskjè [1748] 2003). So, the end of the Skanderbeg era, the Turkish invasion, was only a tragic interruption of the governing tradition of the Albanians, who survived later thanks to local self-government, based on customary unwritten laws.

With the legendary war of the Albanians under the heroic leadership of Skanderbeg, with the liberating character that it had, from the beginning to its end, with the formation during this war of the Albanian National State, with the participation of all Albanians without provincial, religious and social differences - the Scanderbeg epopee was turned into an anchor where the Albanian nation is tempered, with a consolidated national identity. War, state and identity did not, like the other Balkan nations, become a religious hue. With this identity without any religious hue, Albanians entered the Ottoman yoke after Skanderbeg's death and managed to survive.

Skanderbeg is the mainstay of Albanian national history. He is not simply an “Athlete of Christ”, as it is called (athlete, in the sense of the great fighter who protects a noble issue), but an “Athlete of Freedom”.

Scanderbeg historiography have proved the truthfulness of the Barleti's work, in its entirety. But in the democratic cosmos of ‘all views’, there have also flourished different views about Skanderbeg, his epoch and his work. Their clarity poses a challenge to today's historiography. However, research continues and results in new surprises.

Skanderbeg, as Noli wrote more than 70 years ago, still lives among us. His problem was the same problem that Albanians had in the Albanian Renaissance, and behind. Challenges continue. Skanderbeg was the very example, the very inspiration of the Albanians. He continues to inspiring ...

## Bibliografia

- Akademisë së Shkencave të Shqipërisë. 1985. *Fjalori Enciklopedik Shqiptar*; Tiranë: Botimet ASH.
- Barleti, Marin. [1505] 2012. *Rrethimi i Shkodrës*, Tiranë: Onufri.
- Barleti, Marin. [1508/10] 2005. *Historia e Skënderbeut*, Tiranë: Infbotues.
- Bogdani, Pranvera. 1989. “Parathënie”, në Fan Noli, *Vepra 4; Shkrime historike*, Tiranë: Akademia e Shkencave, fq. 5-31.
- Buda, Aleks. 1951. “Fytyra e Skënderbeut në dritën e studimeve të reja”, në *Buletini i Institutit të Shkencave*, Nr. 3-4, Tiranë
- Frangu, Dhimitër. 2000. *Komentari i luftimeve të turqëve kundër Skënderbeut*, Tiranë: Globu.
- Frashëri, Kristo. 2002. *Skënderbeu, jeta dhe vepra*, Tiranë: Toena.
- Frashëri, Kristo. 2006. *Identiteti kombëtar shqiptar dhe çështje të tjera*, Tiranë: Edisud.
- Frashëri, Kristo. 2008. *Historia e qytetërimit shqiptar*, Tiranë: Akademia e Shkencave.
- Frashëri, Kristo. 2009. *Skënderbeu i shpërfytyruar*, Tiranë: Dudaj.
- Frashëri, Sami. (1978/3), *Vepra*, (vëllimi 3), Prishtinë: Rilindja.
- Huff, Darrell. [1954], 1985. *How to lie with statistics?*, London [etc.]: Penguin Books.
- Jorgaqi, Nasho. 2018. “Mbi procesin e punës krijuese e studimore të Fan Nolit”, *Dita*, 10 mars.
- Kadare, Ismail. 2006. *Identiteti evropian i shqiptarëve*. Tiranë: Onufri.
- Kadare, Ismail. 2012. “Parathënie”, në Marin Barleti, *Rrethimi i Shkodrës*, Tiranë: Onufri.
- Marshall, Gordon. 2009. *Fjalor sociologjik i Oksfordit*, Tiranë: Instituti i Dialogut dhe Komunikimit.
- Monteskje, Charl. [1748] 2000. *Mbi frymën e ligjeve*, Tiranë: Luarasi & Fondacioni Soros.
- Noli, Fan S. [1921] 1989. “Historia e Skënderbeut (Gjergj Kastriotit), Mbretit të Shqipërisë”, në Fan Noli, *Vepra 4; Shkrime historike*, Tiranë: Akademia e Shkencave, fq. 33-207.
- Noli, Fan S. [1939] 1989. “Princi i Makiavelit”, në Fan Noli, *Vepra 4; Shkrime historike*, Tiranë: Akademia e Shkencave, fq. 483-606.
- Noli, Fan S. [1947] 1989. “Gjergj Kastrioti, Skënderbeu (1405-1468)”, në Fan Noli, *Vepra 4; Shkrime historike*, Tiranë: Akademia e Shkencave, fq. 209-482.
- Noli, Fan S. [1950] 1989. “Historia e Skënderbeut, Kryezotit të Arbërisë

(1405-1468)”, në Fan Noli, *Vepra 4; Shkrime historike*, Tiranë: Akademia e Shkencave, fq. 483-606.

- Prifti, Stefan. [1967] 2005. “Parathënie”, në Marin Barleti, *Historia e Skënderbeut*, Tiranë: Infbotues, fq. III-XLV.
- Qose, Rexhep. 2006. *Realitet i shpërfillur; Vështrim kritik mbi pikëpamjet e I. Kadaresë për identitetin shqiptar*, Tiranë: Toena.
- Stipçeviq, Aleksandër. 2002. *Ilirët - Historia, jeta, kultura, simbolet e kultet*. Tiranë: Toena.
- Tinder, Glen. 1993. *Mendimi politik; Çështje të përgjithshme*, Tiranë: SHB Enciklopedike.
- Xholi, Zija. 2003. *Pesë mendimtarët më të vjetër të kulturës kombëtare*, Tiranë: Gjergj Fishta.





